



# **FLETORJA ZYRTARE**

## **E**

# **REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

**Nr.63**

**2004**

**6 shtator**

### **P Ë R M B A J T J A**

Faqe

|                                       |                                                                                                                  |      |
|---------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Vendim i ERE<br>nr.26, datë 13.5.2004 | Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.....                                            | 3963 |
| Vendim i ERE<br>nr.27, datë 30.5.2004 | Për miratimin e rregullores për procedurat e licencimit.....                                                     | 3975 |
| Vendim i ERE<br>nr.34, datë 9.7.2004  | Për miratimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike.....                                                | 3985 |
| Vendim i ERE<br>nr.35, datë 9.7.2004  | Për miratimin e licencës së veprimtarisë së transmetimit.....                                                    | 3994 |
| Vendim i ERE<br>nr.36, datë 9.7.2004  | Për miratimin e licencës për shpërndarjen e energjisë elektrike.                                                 | 4003 |
| Vendim i ERE<br>nr.37, datë 9.7.2004  | Për miratimin e licencës për ndërtimin, instalimin e centralit elektrik dhe prodhimin e energjisë elektrike..... | 4014 |

**VENDIM**  
**Nr.26, datë 13.5.2004**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PRAKTIKËS DHE PROCEDURAVE TË ERE-S**

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 8 pika 2 germa (k), Bordi i Komisionerëve të ERE-s, pasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Departamenti i Licencave dhe Monitorimit dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Pjetër Dema**

**RREGULLAT E PRAKTIKËS DHE PROCEDURAVE TË ERE-S**

**PJESA I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi i rregullave**

Këto rregulla janë hartuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe ligjit nr.9135, datë 11.9.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” dhe synojnë të krijojnë një mekanizëm të përshtatshëm për të mbrojtur interesat e konsumatorëve, për të zgjidhur ankesat e paraqitura nga konsumatorët lidhur me aktivitetet e zhvilluara nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, si dhe për të zgjidhur mosmarrëveshjet ndërmjet të licencuarve të këtij sektori.

**Neni 2**  
**Zbatimi**

1. Këto rregulla aplikohen për të gjithë konsumatorët e energjisë elektrike (persona juridikë dhe fizikë), si dhe për të gjithë të licencuarit që veprojnë në sektorin e energjisë elektrike.
2. Këto rregulla udhëheqin në të gjithë praktikën dhe procedurat e punës së ERE-s, gjithmonë në përputhje me legjislacionin në fuqi, përveçse kur urdhërohet ndryshe nga ERE. Procedurat që nuk rregullohen në mënyrë specifike nga këto rregulla, do të rregullohen nga ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.

**Neni 3**  
**Përkufizime**

Në këto rregulla termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

1. “ERE” do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike” ose enti rregullues pasardhës. Në këto rregulla ky term mund të përfshijë anëtarët e personelit teknik të ERE-s, të cilëve ju është deleguar ligjërisht autoriteti nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s për raste të veçanta që përfshijnë këtë autoritet të deleguar.

2. “Bordi i Komisionerëve”, këtej e tutje “Bordi”, do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s që përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara në ligj.

3. “Kryetari i Bordit të Komisionerëve” është një nga anëtarët e Bordit i emëruar, sipas procedurave të parashikuara në ligj, që drejton edhe aktivitetin ekzekutiv të ERE-s.

4. “Personeli teknik” do të thotë punonjësit profesionalë të ERE-s dhe çdo këshilltar ose kontraktorë të tjerë të mbajtur nga ERE, me qëllim që të ndihmojnë Bordin e Komisionerëve nëpërmjet dhënies së këshillave ose informacionit, si dhe kryerjen e punëve dhe detyrave të ndryshme të ERE-s.

5. “Person drejtues” ose “Relatues” do të thotë personi i caktuar të drejtojë një procedim të ERE-s, me detyrat dhe kompetencat e parashtruara në nenin 29. Drejtuesi i një procedimi mund të jetë një anëtar i Bordit ose një anëtar i kualifikuar i personelit teknik të ERE-s siç është vendosur nga kryetari i Bordit.

6. “Sekretar/e” do të thotë sekretari/ja e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

7. “Rregulla” do të thotë rregullat e praktikës dhe e procedurave të ERE-s.

8. “Person” do të thotë çdo person fizik ose juridik, qeveri ose çdo agjenci shtetërore, çdo autoritet lokal ose ente të tjera juridike të njohura nga ligji, përveç ERE-s.

9. “Licencë” do të thotë dhënia e së drejtës nga ERE, një personi për të operuar në sektorin e energjisë elektrike, duke përfshirë ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike, prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin ose eksportin dhe importin e energjisë elektrike.

10. “I licencuar” do të thotë një person që mban një licencë të dhënë nga ERE për të operuar në sektorin e energjisë elektrike.

11. “Furnizues i energjisë elektrike” do të thotë një person që siguron furnizimin e energjisë elektrike për një ose disa konsumatorë.

12. “Shoqëri shpërndarëse” do të thotë një person i licencuar për të kryer veprimtarinë e shpërndarjes në një zonë të caktuar.

13. “Konsumator” do të thotë një person që merr energji elektrike nga një furnizues i energjisë elektrike, i cili mund të jetë edhe një konsumator i vetëm, pavarësisht se ai mund të marrë energji elektrike në më shumë se një vendndodhje.

14. “Petition” do të thotë një kërkesë me shkrim e paraqitur në ERE, nga një person për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 15(A) të kësaj rregulloreje.

15. “Aplikuesi” ose “personi që paraqet një petition” do të thotë çdo person, i ndryshëm nga ankuesi, i cili kërkon të fillojë një veprim që kërkohet të institucionalizohet nga aplikimi ose peticioni. Për qëllim të këtyre rregullave, “aplikues” dhe “personi që bën një petition” do të kenë të njëjtin kuptim.

16. “Ankues” do të thotë një person që depoziton një ankesë në ERE, për çdo veprim ose mosveprim të një personi, që është në juridiksionin e ERE-s për aktivitetin që kryen.

17. “I ankimuar” do të thotë një person kundër të cilit është paraqitur një ankesë ose ka filluar një hetim.

18. “Palë ndërhyrëse” do të thotë një person i cili është lejuar të marrë pjesë në një procedim siç parashikohet nga këto rregulla.

19. “Palë e interesuar” do të thotë një person që merr pjesë në një procedim të caktuar përpara Bordit të ERE-s.

20. “Paraqitje e mangët” do të thotë një paraqitje, e cila nuk plotëson kërkesat formale dhe procedurale të këtyre rregullave apo të rregullave të tjera të zbatueshme të miratuara nga Bordi i ERE-s.

21. “Paraqitja e tarifave” konsiston në tarifat e propozuara dhe materialet e tjera që shoqërojnë një propozim tarifash të paraqitur në ERE për miratim, në përputhje me nenin 22 të këtyre rregullave.

22. “Tarifë” do të thotë një vlerë e përlllogaritur nga një i licencuar, sipas parimeve të parashikuara në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe metodave e procedurave të miratuara nga ERE, për një shërbim të caktuar të ofruar prej tij, vlerë e cila miratohet nga ERE, sipas dispozitave të këtyre rregullave.

23. “Norma të tarifave” janë detyrime të konsumatorëve për shërbimet e energjisë elektrike, sipas tarifave të propozuara nga i licencuari dhe të miratuara nga ERE.

24. “Ndryshim i konsiderueshëm në vendosjen e normave të tarifave” do të thotë çdo ndryshim në vendosjen e tarifave, që e shpërndan ndryshimin total të normave tarifore ndër nivelet e veçanta të tarifave, në mënyrë të ndjeshme në përqindje të ndryshme krahasuar me tarifat ekzistuese.

25. “Terma dhe kushte” do të thotë dispozita të depozituara në ERE nga një i licencuar, që siguron një ose disa shërbime në sektorin e energjisë elektrike, sipas të cilave do t’i sigurohet shërbimi ose shërbimet e energjisë elektrike klientëve ose të cilat në një mënyrë ose një tjetër kanë lidhje me nivelet e tarifave të vendosura për çdo shërbim.

26. “Vit testimi” është një periudhë 12-mujore e përdorur nga një i licencuar që siguron një shërbim ose disa shërbime të energjisë elektrike si bazë për krahasimin e të ardhurave, shpenzimeve dhe investimeve, i cili do të ndihmojë ERE-n në llogaritjen e të ardhurave në një procedim miratimi tarifash. Një vit testimi mund të jetë një vit kalendarik ose çdo periudhë tjetër prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm.

27. “Ditë e rregullt pune” do të thotë një ditë që nuk është e shtunë, e djelë ose festë zyrtare e parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

#### Neni 4

#### **Devijimi nga rregullat**

Për aq sa lejohej nga ligji, aty ku ka një shkak të arsyeshëm, ERE mund të lejojë devijim nga këto rregulla lidhur me kërkesat procedurale ose afatet e zbatimit të tyre. ERE mund të lejojë devijimin nga kërkesat procedurale, kur i sheh ato të papraktikueshme, të papërshtatshme ose të panevojshme. Çdo kërkesë për devijim procedural duhet bërë me shkrim.

#### Neni 5

#### **Konflikti me funksionet statutores ose institucionale**

Këto rregulla janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, autoritetin dhe funksionet ligjore të ERE-s. Në rast konflikti, legjislacioni në fuqi, autoriteti dhe funksionet ligjore të ERE-s do të mbizotërojnë mbi këto rregulla.

#### Neni 6

#### **Parimet e përgjithshme**

Këto rregulla zbatohen duke pasur parasysh parimet e:

1. pajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi;
2. mundësisë për seanca dëgjimi të plota dhe të drejta për të gjitha palët e interesuara;
3. procesit transparent dhe të hapur.

### **PJESA II**

### **ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

#### Neni 7

#### **Adresa e ERE-s**

Zyrat e ERE-s ndodhen në rr.Marsel Kashen, nr.10, Tiranë ose në ndonjë adresë tjetër siç mund të caktohet herë pas herë. Zyrat e ERE-s janë të hapura nga ora 8:00 deri në 16:00 të çdo dite të rregullt pune.

## Neni 8 Mbledhjet

A. Përveç problemeve që janë objekt i çështjeve të brendshme të ERE-s, të gjitha mbledhjet, procedimet publike dhe sesionet vendimmarrëse të Bordit do të jenë të hapura për publikun. Si rregull mbledhjet mbahen në zyrat e ERE-s. Në rast se mbledhjet mbahen në vend tjetër, ky tregohet në njoftimin e mbledhjes.

B. Bordi mblidhet jo më pak se një herë në muaj me thirrjen e kryetarit të tij. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji, numri i nevojshëm i pjesëmarrësve për vendime dhe veprime të tjera të Bordit është 3 (tre) anëtarë.

C. Përpara çdo mbledhje të Bordit, kryetari përgatit një axhendë të çështjeve për t'u shqyrtuar në Bord. Sekretari/ja ua shpërndan këtë axhendë personave që janë palë dhe atyre që janë përfshirë në listën e personave, të cilëve duhet t'u sigurohet njoftimi i sesionit të dëgjimit. Kjo axhendë është e disponueshme për inspektim publik në zyrat e ERE-s.

D. Deri një ditë përpara mbledhjes, me kërkesën e një prej anëtarëve të tij, Bordi mund të vendosë të heqë çështje të veçanta nga axhenda e përgatitur. Brenda mundësive, ERE njofton palët dhe të interesuarit për çdo heqje nga axhenda.

## Neni 9 Mbledhjet jashtë radhe

Përveç mbledhjeve të zakonshme që i referohen nenit 8, çdo anëtar i Bordit mund të marrë iniciativën për të organizuar një mbledhje të Bordit. Të paktën tre ditë para duhet t'i dorëzojë Kryetarit një kërkesë me shkrim që përfshin axhendën dhe çështjet që do të jenë objekt i mbledhjes. Kryetari do të njoftojë më pas anëtarët e tjerë të Bordit dhe sekretarin/en për këtë takim.

## Neni 10 Regjistrimi dhe dokumentacioni

A. Sekretari/ja hap një dosje për çdo procedim për të cilin këto rregulla janë të aplikueshme, përfshirë ankesat, peticionet, procedimet e tarifave, licencat dhe relacionet argumentuese në lidhje me një amendament, shtojcë, përfundim, rinovim dhe heqje të licencës. Çdo procedim do të ketë dosjen e tij me një numër të caktuar. Dosja do të përmbajë të gjithë dokumentacionin e paraqitur, urdhrat, vendimet, si dhe çdo akt tjetër që i takon procedimit, duke u reflektuar në një indeks ku tregohet shkurtimisht edhe natyra e çdo dokumenti të regjistruar.

B. Me fillimin e procedimit, sekretari/ja, në bashkëpunim me departamentet do të përgatisë një listë për atë procedim, e cila do të përmbajë:

1. emrin, adresën dhe numrin e telefonit të personit që paraqet peticion, aplikantit ose ankuesit;
2. emrin, adresën dhe numrin e telefonit të çdo pale, përfshirë çdo konsulent të caktuar nga një palë;
3. emrat dhe adresat e personave që nuk janë palë, por që kanë shprehur interes dhe do t'u jepet njoftim për seancat dëgjimore, relacionet argumentuese, vendimet apo urdhrat.

Sekretari/ja do të mbajë një listë për të gjitha procedimet e futura në dosje dhe do të sigurojë një kopje të kësaj liste falas për të gjitha palët, si dhe personat e interesuar që do t'i kërkojnë atë.

C. Çdo palë e interesuar që paraqet në ERE ndonjë dokument ose material me shkrim, do t'i dërgojë një kopje të tij, të gjitha palëve të përfshira në listën e shërbimit.

D. Sekretari/ja do mbajë procesverbalin e sesioneve vendimmarrëse, të organizuara nga Bordi.

E. Sekretari/ja do të mbajë regjistra ose shënime të tjera siç mund të kërkohet herë pas here nga Bordi.

F. Sekretari/ja do mbajë në ERE një regjistër të përgjithshëm ku mbahen të gjitha vendimet e marra dhe licencat e lëshuara nga ERE dhe do t'ia kalojë këto vendime e licenca Departamentit të Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, për publikim në Fletoren Zyrtare.

G. Të gjitha regjistrat, shënimet dhe materialet e tjera të përshkruara në këtë nen, janë të hapura për publikun.

#### Neni 11

##### **Fillimi i procedimit**

A. Përveç kur jepet ndryshe nga këto rregulla ose rregulla të tjera të ERE-s, ose nga ligji, një procedim fillon në kohën kur sekretari/ja në bashkëpunim me departamentet, konstaton se peticioni, aplikimi, ankesa ose kërkesa të tjera që kërkojnë veprimin e ERE-s, përfshijnë të gjithë informacionin e kërkuar nga rregullat e ERE-s ose legjislacionin në fuqi. Nëse sekretari/ja konstaton se kërkesat janë plotësuar gjerësisht, por mungojnë disa informacione të kërkuara, ai/ajo mund të vendosë, pas konsultimit me kryetarin e Bordit, se mungesa e përkohshme e informacionit nuk do të shkaktojë paragjykimet për palët e tjera. Në këtë rast procedimi do të konsiderohet se ka filluar në kohën e kërkesës fillestare, me kusht që pala kërkuuese të sigurojë informacionin që mungon brenda kohës së caktuar nga sekretari/ja.

B. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi, nëse sekretari/ja nuk informon palën se kërkesa është e paplotë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve të rregullta pune pas marrjes së kërkesës, ajo do të konsiderohet e plotë në ditën e marrjes së kërkesës.

C. Asgjë në këtë nen nuk kufizon të drejtën e ERE-s apo të ndonjë pale tjetër, për të kërkuar informacion shtesë nga personat që paraqesin aplikime, ankime, peticione ose nga palët e tjera që kërkojnë aktivizimin e ERE-s.

#### PJESA III KËRKESAT

##### SEKSIONI I TIPET E KËRKESAVE

#### Neni 12

##### **Aplikimet**

Çdo person që kërkon një licencë, certifikatë ose autorizim të ngjashëm duhet të paraqesë një aplikim, duke përdorur formularë standardë të miratuar nga ERE për aplikime të tilla.

#### Neni 13

##### **Rregulla të veçanta për paraqitjen e tarifave**

Çdo person që kërkon të paraqesë në ERE propozime të tarifave, termave dhe kushteve do ta bëjë atë në përputhje me pjesën III, seksioni II të këtyre rregullave.

#### Neni 14

##### **Ankesat**

A. Ankesa duhet:

1. Të paraqitet duke përdorur një formë standarde që i bashkëlidhet këtyre rregullave.
2. Të përcaktojë qartë palën ose palët që besohet se janë përgjegjëse për çështjen e trajtuar në ankesë.
3. Të përcaktojë qartë veprimin ose mosveprimin që mendohet se është në kundërshtim me ligjet e aplikueshme ose kërkesat e rregullimit dhe të shpjegojë pse veprimi ose mosveprimi është i tillë.

4. Të paraqesë një përlogaritje të ndikimit ose barrës financiare, nëse ka, të krijuar për ankuesin, si dhe të tregojë ndikimet praktike, operative ose ndikime të tjera jofinanciare të shkaktuara si rezultat i veprimit ose mosveprimit, përfshirë aty ku është e aplikueshme, ndikimet mbi mjedisin, mbi sigurinë ose qëndrueshmërinë e furnizimit.

5. Të përcaktojë veprimin korrigjues, ndihmën apo dëmshpërblimin e kërkuar, për padrejtësinë ose dëmin që i është shkaktuar.

6. Të përmbajë gjithë dokumentet dhe faktet që posedohen ose që mund të sigurohen nga ankuesi, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar vetëm me kontratat dhe deklaratat zyrtare, të cilat mbështesin ankesën.

B. Çdo person, përpara se të paraqesë një ankesë në lidhje me një shoqëri shpërndarjeje, duhet të tentojë fillimisht ta zgjidhë mosmarrëveshjen nëpërmjet diskutimit të çështjes me departamentin e ankesave të konsumatorëve të shoqërisë së shpërndarjes.

C. Çdo person mund të paraqesë një ankesë për të kërkuar veprimin e ERE-s, kundër personave që mendohet se janë në kundërvajtje ose dhunim të çdo ligji, rregulli, urdhri apo akteve të tjera ligjore të administruara nga ERE ose për çdo gabim tjetër të menduar, mbi të cilat ERE mund të ketë juridiksion.

D. Ankesa në ERE duhet të paraqitet nëpërmjet postës ose dorazi. Ajo regjistrohet dhe protokollohet në datën që mbërrin në ERE.

E. Ankesat që përmbajnë materiale fyese ose denigruese përjashtohen nga ERE, pa paragjykuar nëse ai ankues mund të ketë paraqitur një ankesë që qëndron.

F. Ankesat e përgjithshme të konsumatorëve lidhur me normat e tarifave nuk do të trajtohen nga ERE sipas këtij neni, por do të trajtohen nga një proces dëgjimi në përputhje me nenin 24.

G. ERE do t'i dërgojë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve të rregullta pune nga marrja e një anese të rregullt, një kopje të ankesës, palës ose palëve të konsideruara si përgjegjëse për çështjen që trajtohet në ankesë (i ankimuari).

H. I ankimuari do t'i përgjigjet ankesës brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike pas njoftimit të ankesës. I ankimuari do t'i dërgojë një kopje të përgjigjes ERE-s dhe një kopje tjetër ankuesit.

I. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e përgjigjes nga i ankimuari, ERE do të planifikojë një seancë dëgjimi jozyrtare sipas neneve 26 dhe 27. Në rast se i ankimuari nuk përgjigjet, afati 15-ditor fillon me mbarimin e afatit 30-ditor të parashikuar në germën H të këtij neni.

J. Në qoftë se një ankesë prek një çështje të një interesi të gjerë publik, Bordi mund të sigurojë njoftim publik të ankesës dhe ta vendosë çështjen për seancë zyrtare dëgjimi sipas neneve 26 dhe 28.

## Neni 15 Peticionet

A. Një person duhet të paraqesë një petition kur kërkon:

- a) të ndërhyhet në përputhje me nenin 16 ose nenin 17 të kësaj rregulloreje;
- b) një urdhër për të zgjidhur një kontradiktë ose për të sqaruar një paqartësi;
- c) ndërhyrje ose veprim të personelit teknik;
- d) një rregull për aplikim të përgjithshëm;
- e) çdo veprim tjetër që është nën juridiksionin e ERE-s dhe për të cilin këto rregulla nuk parashikojnë formë tjetër kerkese.

B. Çdo person që paraqet një petition duhet t'i dërgojë një kopje të tij ERE-s nëpërmjet postës.

C. Një petition duhet të bëhet me shkrim brenda kohës së lejuar nga ERE dhe duhet të përmbajë emrin, adresën dhe numrin e telefonit të personit që paraqet petitionin dhe një deklaram të shkurtër dhe të thjeshtë të natyrës së argumentave të tij.

D. ERE do t'u dërgojë të gjitha palëve të interesuara, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve të rregullta pune nga marrja e petitionit, një kopje të petitionit.

E. Palët e interesuara mund t'i përgjigjen petitionit brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike që nga marrja e petitionit. Palët e interesuara që i përgjigjen një petitioni duhet t'i dërgojnë një kopje të përgjigjes ERE-s dhe një kopje personit që ka paraqitur petitionin.

#### Neni 16

##### **Ndërhyrja e detyruar**

A. Mbas paraqitjes së një petitioni për të ndërhyrë sipas nenit 15, do të lejohen të ndërhynë si palë në procedim: (a) çdo person që është apo mund të jetë anëtar i një grupi që është ose mund të jetë i prekur direkt dhe në mënyrë të konsiderueshme nga procedimi, si dhe (b) çdo institucion shtetëror.

B. Bordi mund t'i mohojë ndërhyrjen çdo personi që ka paraqitur një petition për ndërhyrje në kohë sipas paragrafit A të këtij neni, mbi bazën se personi që paraqet petitionin nuk ka një interes direkt dhe thelbësor në procedim.

C. Bordi mund të kufizojë pjesëmarrjen e çdo personi që paraqet petition për të ndërhyrë sipas këtij neni, kur ky person gjykohet nga Bordi se ka të drejtë të ndërhijë vetëm në lidhje me një pjesë të çështjes në procedim.

D. Kur pjesëmarrja e çdo personi është e kufizuar ose e mohuar sipas këtij neni, ERE do të përfshijë në regjistrimet një shënim në lidhje me këtë fakt dhe arsyet e tij.

#### Neni 17

##### **Ndërhyrja diskrete**

A. Çdo person i interesuar, i paaautorizuar për të ndërhyrë sipas nenit 16, mund të lejohet me miratimin e Bordit, të ndërhijë dhe të marrë pjesë si palë me autoritet të plotë ose të kufizuar në procedim.

B. Bordi mund t'i mohojë ose kufizojë çdo personi që paraqet petition sipas këtij neni për çdo lloj arsyeje, përfshirë pamundësinë e personit që paraqet petitionin për të kontribuar në zgjidhjen e çështjes në fjalë dhe mosparaqitjen në kohë të petitionit.

C. Kur pjesëmarrja e çdo personi është e kufizuar ose e mohuar sipas këtij neni, Bordi do të përfshijë në regjistrimet një shënim në lidhje me këtë fakt dhe arsyet e tij.

#### Neni 18

##### **Bashkimi i procedimeve**

Bordi ose personi drejtues mund të kërkojnë bashkimin e dy ose më shumë procedimeve. Gjatë përcaktimit nëse dy ose më shumë procedime të ndara duhet të bashkohen, Bordi ose personi drejtues do të marrin parasysh numrin e palëve, interesin e çdo pale, faktin nëse ato propozojnë të ofrojnë dëshmi apo të marrin pjesë vetëm gjatë shqyrtimeve, natyrën dhe masën e dëshmive të tyre dhe, rastet e zbatueshme, nëse ato janë në të njëjtin apo në nivele të ndara të klasifikimit, qofshin ato ekzistuese apo të propozuara. Asnjë pale nuk do t'i kërkohet të bashkojë procedimet e saj kur është e qartë se për shkak të këtij bashkimi, pala do të jetë e pamundur të bëjë një prezantim të përshtatshëm të pozicionit të saj.

#### SEKSIONI II

##### **PROCEDIMET PËR HARTIMIN E RREGULLAVE, RREGULLOREVE OSE AKTEVE NËNLIGJORE**

#### Neni 19

Përpara miratimit të një rregulli, rregulloreje ose çdo akti tjetër nënligjor, përveç rasteve kur rregulli ose rregullorja ka të bëjë me çështje të brendshme të ERE-s, ERE publikon një njoftim në një nga gazetatat me qarkullim kombëtar, duke ftuar palët e prekura ose persona të tjerë të dërgojnë komente me shkrim.



Mbas një kërkesë, ERE do t'ia sigurojë një kopje të projektit të rregullit ose rregullores çdo pale të prekur ose personi të interesuar.

Të gjitha palët e prekura ose personat e tjerë do të dërgojnë komentet e tyre me shkrim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit të njoftimit.

Pas shqyrtimit të plotë të të gjitha komenteve të marra, ERE do të njoftojë të gjitha palët e prekura, të cilat kanë dërguar komente, nëse komentet e tyre janë pranuar ose kundërshtuar.

Çdo palë e prekur mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit sipas pikës 4 të këtij neni, të fillojë një seancë dëgjimi në përputhje me dispozitat e pjesës IV të këtyre rregullave, kur ajo gjykon se kundërshtimi i komenteve të saj nuk është i mbështetur.

### SEKSIONI III RREGULLA SHITESË PËR PROCEDIMET E TARIFAVE

#### Neni 20 Qëllimi

Ky seksion përcakton kërkesat për formën, përmbajtjen dhe organizimin e të gjitha paraqitjeve në ERE nga aplikuesit, të normave të tarifave, termave dhe kushteve.

#### Neni 21 Fillimi i procedimeve të tarifave

Paraqitja e normave të tarifave do të fillojë nga:

1. Një paraqitje formale e kërkesës për miratimin e tarifave të reja në ERE nga një i licencuar;

2. Një shqyrtim paraprak nga ana e ERE-s i kërkesës formale të paraqitur sipas paragrafit (1) dhe njoftimi i të licencuarit brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike, për marrjen ose jo në shqyrtim nga ana e ERE-s, të aplikimit për tarifën e propozuar.

Të gjitha paraqitjet e normave të tarifave do të bëhen në përputhje me nenin 22.

#### Neni 22 Forma dhe përmbajtja e paraqitjes së tarifave

A. Të gjitha propozimet në ERE sipas nenit 21 duhet të shoqërohen nga një letër përcjellëse e cila do të përmbajë:

1. një deklaratë që përshkruan qëllimin dhe efektin e propozimit;
2. efektet e pritshme në rritjen e të ardhurave nga tarifën e propozuar, nëse ka;
3. çdo ndryshim të konsiderueshëm në strukturën e normave tarifore që pritet të rezultojë nga propozimi.

B. Të gjitha tarifën e propozuar, ku është e aplikueshme, duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

1. Normat e aplikuara nga aplikuesi ndaj klientëve të tij për çdo shërbim të energjisë elektrike, duke përfshirë:

a) çdo tarifë minimale ndaj klientëve për shërbimin, si dhe çdo tarifë shtesë për shërbime të veçanta;

b) çdo normë tarife të lidhur me çfarëdo programi të veçantë, përfshirë përshkrimin e programit;

c) çdo ngarkesë tjetër ndaj klientëve për të cilën aplikuesit i kërkohej të paraqesë propozimet;

d) çdo informacion tjetër të nevojshëm për të përcaktuar normat tarifore të aplikuesit.

2. Termat dhe kushtet në të cilat do t'u sigurohet shërbimi i energjisë elektrike klientëve, përfshirë:

a) mundësinë e shërbimit për klasa të ndryshme klientësh;

b) llojin e shërbimit që siguron, përfshirë çdo informacion teknik të nevojshëm për të diferencuar këto shërbime nga shërbimet e tjera;

c) zonat e ndryshme të shërbimit dhe të normave tarifore për aplikuesit, nëse kanë;

d) çdo informacion shtesë të nevojshëm për të përcaktuar termat dhe kushtet e shërbimit.

C. Brenda mundësive praktike, por jo më vonë se 30 maj 2004, propozimet e tarifave duhet të përmbajnë, ku është e aplikueshme, deklarime të ndara të llogarive për çdo aktivitet individual të licencuar që kryhet nga një i licencuar.

D. Propozimet e normave të tarifave duhet të përmbajnë, ku është e aplikueshme, një deklaratë të vitit të testimit që do të përdoret, përfshirë një raport vjetor për vitin e testimit, shpenzimet, të ardhurat dhe normat bazë të tarifave gjatë vitit të testimit, si dhe axhustimet e propozuara të shpenzimeve, të ardhurave dhe normave bazë të tarifave për vitin e testimit, duke përfshirë deklaratimet, prezantimet ose dokumentet e punës që justifikojnë çdo axhustim, sipas metodologjisë së miratuar nga ERE.

E. Propozimet e normave të tarifave duhet të përmbajnë, ku është e aplikueshme, një përshkrim të çdo ndryshimi të konsiderueshëm në kompozimin e normave të tarifave, duke përfshirë arsyet për këto ndryshime, efektet e ndryshimeve të propozuara ndaj klasave të ndryshme të klienteve, dhe ndaj kategorive të shërbimit, si dhe ndryshimet në faturat tipike për çdo klasë dhe kategori.

F. Në qoftë se aplikuesi pretendon se ndonjë nga informacionet e kërkuara sipas këtij neni nuk është i mundshëm, ai duhet të paraqesë arsyet e pretendimit. Paaftësia për të dhënë arsye të përshtatshme për çdo përjashtim do të shkaktojë që propozimi të trajtohet si një propozim i parregullt.

G. ERE do të shpallë vendimet mbi normat e tarifave në përputhje me nenet 32 dhe 33 të këtyre rregullave brenda afatit kohor të parashikuar në metodologji.

#### Neni 23

##### **Paraqitja e mangët**

Çdo paraqitje e tarifave, e cila nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 22 është një paraqitje e mangët. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e propozimit të mangët, ERE duhet të njoftojë aplikuesin për mangësitë dhe nëse propozimi është në përgjithësi në përputhje me kërkesat e nenit 22, pavarësisht mangësive, ERE mund të lejojë aplikuesin të ndreqë mangësitë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga dita e njoftimit.

#### Neni 24

##### **Seancat publike të dëgjimit**

A. Bordi do të planifikojë dhe mbikëqyrë një seancë publike dëgjimi në një zonë të vendosur në mënyrë të përshtatshme për publikun, që në përgjithësi është zona ku shërben aplikuesi, që do të zhvillohet në një kohë ndërmjet 30 (tridhjetë) dhe 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike nga dita e marrjes së rregullt të propozimit të normave të tarifave sipas nenit 22. Në seancat publike të dëgjimit, pjesëtarë të publikut mund të paraqesin dëshmi dhe të bëjnë pyetje për aplikuesin ose ERE-n, në lidhje me propozimet e normave të tarifave.

B. Brenda juridiksionit të tij, Bordi mund t'i kërkojë personit drejtues të planifikojë ditë për seanca publike në zona të tjera nga ajo ku mbahen seancat e dëgjimit, në mënyrë që pjesëtarët e publikut të gjerë në atë zonë të mund të paraqesin dëshmi dhe të bëjnë pyetje për aplikuesin ose Bordin në lidhje me propozimet e normave të tarifave. Në këto ditë të seancave publike, të paktën një anëtar i Bordit dhe një përfaqësues i aplikuesit do të jenë prezent. ERE do të publikojë njoftimin për këtë ditë të seancës publike, në një gazetë që shpërndahet edhe në atë zonë ku është planifikuar seanca publike e dëgjimit.

Neni 25  
**Njoftimet**

A. Një aplikues që depoziton propozimin për normat e tarifave sipas nenit 22, duhet të njoftojë:

1. Publikun e zakonshëm, nëpërmjet publikimit jo më pak se dy herë në disa gazeta që qarkullojnë në nivel vendi apo në zonën që shërben aplikuesi, në lidhje me masën e propozuar për ndryshimin e normës së tarifave, si dhe përqindjen e ndryshimit të normës së tarifave për çdo klasë klientësh, duke shprehur qartë emërtimin e tyre.

2. Klientët individualë të paktën 10 (dhjetë) ditë kalendarike përpara seancës së dëgjimit. Mënyra e njoftimit në lidhje me masën e propozuar për ndryshimin e normës së tarifave, do të jetë e njëjtë me mënyrën e shpërndarjes së faturave të konsumit të energjisë elektrike.

B. ERE do të organizojë seancën dëgjimore dhe do të bëjë njoftimin që do të publikohet ndërmjet 10 (dhjetë) dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike përpara ditës së seancës dëgjimore. Njoftimi duhet të përmbajë datën, kohën, vendin dhe qëllimin e seancës.

C. Mbas aprovimit të propozimit për një ndryshim të normave të tarifave, aplikuesi duhet të sigurojë një njoftim që përmban masën e ndryshimit të normës, përqindjen e ndryshimit të normës për secilën klasë klientësh dhe datën e hyrjes në fuqi për publikun në përgjithësi dhe klientët individualë, nëpërmjet publikimit jo më pak se dy herë në disa gazeta me qarkullim në zonën ku shërben aplikuesi. Njoftimi i parë duhet të publikohet jo më vonë se 5 (pesë) ditë kalendarike mbas marrjes së aprovimit të ndryshimit të normave. Njoftimi i dytë do të publikohet jo më pak se 5 (pesë) ditë dhe jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike mbas marrjes së aprovimit të ndryshimit të normave të tarifave.

PJESA IV  
**SEANCAT E DËGJIMIT**

Neni 26  
**Fillimi i seancave të dëgjimit**

A. Një seancë dëgjimi sipas kësaj pjese do të fillojë nga një urdhër i kryetarit të ERE-s.

B. Çdo urdhër apo njoftim sipas paragrafit (A) të këtij neni do të parashtrijë:

1. autoritetin dhe juridiksionin nën të cilin do të mbahet seanca e dëgjimit;
2. natyrën e procedimit;
3. personin drejtues;
4. datën, orën dhe vendin e seancës së dëgjimit;
5. çdo çështje tjetër të përshtatshme.

C. Pasi procedimi t'i jetë ngarkuar një personi drejtues, ai mund të përcaktojë informacionin që duhet paraqitur. Personi drejtues do të përcaktojë një mënyrë të analizimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, që nuk do të jetë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 27  
**Seancat jozyrtare të dëgjimit**

Në rastet kur ka mosmarrëveshje ndërmjet palëve të ndryshme, personi drejtues do të thërrasë një seancë jozyrtare dëgjimi. Gjatë seancës jozyrtare të dëgjimit palët së bashku me personin drejtues do të mundohen të përcaktojnë shkakun e mosmarrëveshjes dhe të përpiqen ta zgjidhin atë. Nëse pas seancës jozyrtare të dëgjimit nuk ka mirëkuptim ndërmjet palëve, personi drejtues do të organizojë një seancë zyrtare dëgjimi në përputhje me nenet 26 dhe 28.

Neni 28  
**Seancat zyrtare të dëgjimit**

A. Përveç kur parashikohet ndryshe nga këto rregulla, sekretaria e caktuar për seancën dëgjimore, do të sigurojë njoftime me shkrim për datën e seancës zyrtare të dëgjimit për gjithë palët pjesëmarrëse, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike përpara datës së caktuar për seancën e dëgjimit.

B. Të gjitha seancat zyrtare të dëgjimit do të jenë të hapura për publikun dhe do të regjistrohen.

C. Dosjet e seancave zyrtare të dëgjimit do të jenë të hapura për inspektim publik dhe do të ruhen sipas rregullave që përcakton legjislacioni në fuqi.

D. Gjatë seancave zyrtare të dëgjimit, të gjitha palëve të interesuara do t'u jepet mundësia të paraqesin çështjen e tyre, arsyetimet e tyre lidhur me padrejtësinë ose pakorrektësinë e veprimeve apo mosveprimeve, që janë objekt i mosmarrëveshjes, si dhe zgjidhjet e mundshme.

E. Regjistrimet në magnetofon dhe pajisje të tjera mekanike ose elektronike, përveç atyre të përdorura siç duhet nga sekretari/ja në përputhje me nenin 10, janë të lejueshme në një seancë zyrtare dëgjimi, nëse nuk pengojnë dhe nuk kërcënojnë pjesëmarrësit, ose nuk ndërhyjnë në drejtimin e rregullt të procedimit.

Neni 29  
**Detyrat dhe kompetencat e personave drejtues**

**A. Detyrat**

1. Do të jetë detyra e personit drejtues, të drejtojë një seancë dëgjimi të drejtë dhe të paanshme dhe të përcaktojë çështjen sipas ligjit.

2. Personi drejtues do të bëjë që të gjitha paraqitjet gjatë një seance dëgjimi të regjistrohen me një shënim, se në emër të kujt është bërë çdo paraqitje.

3. Personi drejtues do të përcaktojë radhën e paraqitjes së rasteve të të gjithë pjesëmarrësve në seancën e dëgjimit.

4. Personi drejtues do të sigurojë që marrja e provave dhe çështjeve vijuese të procedojë me gjithë zellin e arsyeshëm dhe me sa më pak vonesa.

5. Pas përfundimit të seancës dëgjimore personi drejtues do të përgatisë për Bordin një projektvendim.

B. Përveçse kur urdhërohet ndryshe nga Bordi ose parashikohet ndryshe nga ligji, personi drejtues mund:

1. të programojë ose të rregullojë ndryshe drejtimin e seancës së dëgjimit;
2. të afrojë, të rimbledhë ose të shtyjë seancën e dëgjimit;
3. të vendosë dhe të marrë prova në një seancë zyrtare dëgjimi;
4. të vendosë dhe të disponojë çështjet procedurale, përfshirë mocionet gojore ose të shkruara në një seancë zyrtare dëgjimi;
5. të relatojë me shkrim një çështje nga një seancë zyrtare dëgjimi për Bordin;
6. të kërkojë ose të autorizojë pranimin e provave të mëtejshme për çdo çështje në çdo kohë para mbylljes së regjistrimit të provave në një seancë zyrtare dëgjimi;
7. të kërkojë paraqitjen e dëshmimeve të veçanta në një seancë zyrtare dëgjimi;
8. të shqyrtojë dëshmitë në një seancë zyrtare dëgjimi;
9. të kryejë detyra të tjera, për të realizuar seancën e dëgjimit në një mënyrë efikente dhe të drejtë.

**C. Skualifikimi**

1. Personi drejtues mund të tërhiqet nga procedimi, nëse ai/ajo mendon se nuk është i kualifikuar.

2. Bordi, për shkaqe të argumentuara, mund të urdhërojë heqjen e çdo personi drejtues nga një procedim, me një mocion të paraqitur ERE-s ose në raste të ndryshme.

3. Mbas këtij skualifikimi ose heqjeje, kryetari i Bordit do të emërojë një pasues të personit drejtues në përputhje me legjislacionin shqiptar.

#### Neni 30

#### **E drejta për të paraqitur prova**

Në përputhje me dispozitat e këtyre rregullave, pjesëmarrësi ka të drejtë të paraqesë çfarëdo lloj prove, përfshirë provën e refuzimit, për të bërë kundërshtime dhe argumentime të tilla, si dhe për të drejtuar ndërkërkime të tilla, siç mund të jetë e nevojshme, për të siguruar një zbulim të vërtetë dhe të plotë të fakteve.

#### Neni 31

#### **Transkriptimet**

A. Çdo deklaratë e bërë në një seancë dëgjimi do të shkruhet në një raport të saktë, pa hequr asgjë përveç kur në kushte të kufizuara, personi drejtues mund të urdhërojë me shkrim heqjen nga regjistrimet të deklaratave fyese.

B. Pas mbylljes së një regjistrimi, ndryshimet në transkriptim nuk lejohen, përveç rasteve të parashikuara nga paragrafi (C) i këtij neni.

C. Çdo korrigjim në transkriptimin e një seance dëgjimi mund të bëhet vetëm nëse personi drejtues vendos se korrigjimi përputhet me transkriptin e provës së paraqitur në seancën dëgjimore.

#### **PJESA V VENDIMET**

#### Neni 32

#### **Vendimet e Bordit të ERE-s**

Vendimet e Bordit të ERE-s merren me shumicën e votës së anëtarëve të tij. Votimi i Bordit do të jetë i hapur. Të gjitha vendimet e Bordit do të vulosen me vulën e ERE-s dhe do të firmosen nga kryetari i Bordit dhe sekretari/ja.

#### Neni 33

#### **Njoftimi i vendimit**

ERE do t'u dërgojë njoftim me shkrim të gjitha palëve të interesuara për vendimet përfundimtare të Bordit. Teksti i plotë i të gjitha vendimeve përfundimtare do të vendoset në regjistrin zyrtar të vendimeve dhe licencave dhe do të bëhet i disponueshëm për shqyrtim nga publiku.

#### Neni 34

#### **Rishqyrtimi ose ridëgjimi**

Nëse brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data kur një vendim i Bordit është marrë, çdo palë në mosmarrëveshje ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin të marrë një vendim të ndryshëm, ajo mund të apelojë në ERE për rishqyrtim ose ridëgjim për të paraqitur provën e re. Bordi do të shqyrtojë provën e re dhe do të nxjerrë vendimin e tij brenda 5 (pesë) ditëve të rregullta pune nga rishqyrtimi ose ridëgjimi dhe do të njoftojë palët për atë vendim. Megjithatë, apeli për rishqyrtim ose ridëgjim nuk do të lejojë personin që paraqet peticionin të ndërpresë ekzekutimin e vendimit të parë të Bordit brenda afateve të përcaktuara, përveç kur është pezulluar nga Bordi nën autoritetin e tij. Ky nen nuk do të interpretohet si i tillë, që i lejon secilës palë në mosmarrëveshje mundësinë të paraqesë të njëjtën provë për rishqyrtim ose ridëgjim, por ky nen do të përdoret vetëm nëse secila palë siguron prova të reja brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga vendimi i Bordit që mund të çojë Bordin të marrë një vendim të ndryshëm.

Neni 35  
**E drejta për apel**

Vendimet përfundimtare të Bordit të ERE-s mund të ankimohen në Gjykatën e Shkallës së Parë në Tiranë, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi.

Neni 36  
**Publikimi i vendimeve**

Vendimet e Bordit të ERE-s lidhur me çështjet me interes të gjerë publik, siç përcaktohet nga Bordi, do të dorëzohen nga ERE për publikim në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në faqen e ERE-s në internet.

PJESA VI  
**DISPOZITA TË TJERA**

Neni 37  
**Rishikimi dhe ndryshimi i rregullave**

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit.

Neni 38  
**Hyrja në fuqi**

Këto rregulla hyjnë në fuqi pas publikimit të tyre në Fletoren Zyrtare.

**VENDIM**  
**Nr.27, datë 30.5.2004**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E LICENCIMIT**

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 8 pika 2 germa a dhe neni 14 pika 2, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.5.2004, pasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Departamenti i Licencave dhe Monitorimit dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullores për procedurat e licencimit (Rregullorja bashkëngjitur vendimit).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S  
**Pjetër Dema**

## RREGULLORE PËR PROCEDURAT E LICENCIMIT

### KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1 **Autoriteti**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 14 dhe në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

#### Neni 2 **Qëllimi i rregullores**

Kjo rregullore përcakton kushtet dhe procedurat e përgjithshme që nevojiten për kërkimin, dhënien, modifikimin dhe heqjen e një licence për të realizuar të gjitha aktivitetet në sektorin e energjisë elektrike.

#### Neni 3 **Përkufizime**

Në këto rregulla termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

1. “Aplikues” do të thotë çdo person që aplikon për një licencë sipas kësaj rregulloreje.
2. “Bordi i Komisionerëve” do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga ligji nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
3. “ERE” do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike.
4. “Licencë” do të thotë dhënia e së drejtës nga ERE, një personi juridik për të operuar në sektorin e energjisë elektrike, duke përfshirë prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin, eksportin dhe importin e energjisë elektrike.
5. “I licencuar” do të thotë një person që mban një licencë të dhënë nga ERE për të operuar në sektorin e energjisë elektrike.
6. “Person” do të thotë çdo person fizik ose juridik, qeveria ose çdo agjenci shtetërore, çdo autoritet lokal ose ente të tjera juridike të njohura nga ligji, përveç ERE-s.
7. “Person drejtues” ose “Relatues” do të thotë personi i caktuar të drejtojë një procedim të ERE-s, me detyrat dhe fuqitë e parashtruara në rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.
8. “I deleguari përgjegjës” do të thotë një person fizik që aplikon për një licencë në emër të një aplikuesi sipas nenit 7.

#### Neni 4 **Licencat**

1. ERE lëshon licenca për aktivitetet e mëposhtme :
  - a) Ndërtimin dhe instalimin e një centrali të ri të energjisë elektrike;
  - b) Prodhimin e energjisë elektrike;
  - c) Transmetimin e energjisë elektrike;
  - d) Shpërndarjen e energjisë elektrike;
  - e) Furnizimin dhe tregtimin e energjisë elektrike;
  - f) Eksportimin e energjisë elektrike;
  - g) Importimin e energjisë elektrike.
2. Nuk kërkohet licencë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e një vetëprodhuesi të palidhur me sistemin elektroenergetik dhe për ndërtimin e një linje direkte.

## Neni 5

### **Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës**

1. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencave të lëshuara nga ERE për aktivitetet e parashikuara në nenin 3 të kësaj rregulloreje, përcaktohet nga ERE brenda kufijve të mëposhtëm:

- për prodhimin e energjisë elektrike deri në 30 vjet,
- për transmetimin e energjisë elektrike deri në 25 vjet,
- për shpërndarjen e energjisë elektrike deri në 20 vjet,
- për furnizimin dhe tregtimin e energjisë elektrike deri në 5 vjet,
- për eksportin e energjisë elektrike 1 vit,
- për importin e energjisë elektrike 1 vit.

2. Në rastin e një licence për ndërtimin e një centrali të ri, ERE mund të kërkojë ndaj të licencuarit një periudhë të arsyeshme ndërtimi dhe instalimi, duke marrë parasysh:

- a) tipin e teknologjisë së centralit (lënda djegëse);
- b) periudhën e propozuar të ndërtimit;
- c) madhësinë (fuqinë) e njësisë(ve).

## KAPITULLI II

### **PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR LICENCA**

## Neni 6

### **E drejta për të aplikuar për një licencë**

Ka të drejtë të aplikojë për një licencë të lëshuar nga ERE, çdo person që ka vendqëndrimin e tij në Shqipëri. Çdo person i huaj duhet të krijojë një shoqëri sipas legjislacionit në fuqi, për të gjithë periudhën e vlefshmërisë së licencës.

## Neni 7

### **Delegimi i të drejtave të aplikuesit**

1. Aplikuesi mund të caktojë një person fizik ose juridik si të deleguar përgjegjës për të aplikuar për një licencë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me këto procedura licencimi.

2. Detyrat e të deleguarit përgjegjës janë:

- a) të paraqesë aplikimin për një licencë, së bashku me dokumentacionin e kërkuar sipas neneve 9, 10 dhe 11 të kësaj rregulloreje;
- b) të paraqesë të dhëna dhe informacion shtesë të kërkuar nga ERE gjatë shqyrtimit të aplikimit për licencë;
- c) të monitorojë dhe të sigurojë përmbushjen nga i licencuari të kushteve të përcaktuara në licencë;
- d) të përgatisë raporte periodike lidhur me aktivitetin e të licencuarit, të cilat i paraqet në ERE.

3. I licencuari do të kërkojë aprovimin e ERE-s për të deleguarin përgjegjës nëpërmjet paraqitjes në ERE të dokumenteve të mëposhtme:

- a) prokurën e aplikuesit që aplikon për licencë me të cilën cakton personin përgjegjës;
- b) curriculum vitae të personit të caktuar;
- c) një letër reference e nënshkruar nga përfaqësuesi zyrtar i një organizate profesionale në sektorin e energjisë, që dëshmon cilësitë profesionale dhe eksperiencën në sektor të personit të caktuar;
- d) një vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale;
- e) certifikatë të punëdhënësit aktual të personit të caktuar si i deleguar përgjegjës (në rast se ai nuk është i punësuar nga punëdhënësi).



4. Brenda 7 ditëve nga paraqitja e dokumentacionit që përcaktohet në paragrafin e mësipërm, ERE do t'i komunikojë me shkrim aplikuesit aprovimin ose arsyet e refuzimit të të deleguarit përgjegjës.

5. Në rast se i deleguari përgjegjës i propozuar refuzohet, aplikuesi do të caktojë një person tjetër brenda 5 ditëve nga marrja e komunikimit të ERE-s, duke respektuar kushtet e sipërpërmendura. Në rast të një refuzimi të dytë, aplikuesi humbet të drejtën e caktimit të të deleguarit, përveç kur kjo lejohet nga ERE.

#### Neni 8

##### **Njoftimi i qëllimit për të paraqitur një aplikim për ndërtimin e një centrali të ri elektrik**

1. Personat e interesuar do të dërgojnë në ERE një njoftim mbi qëllimin e tyre për të paraqitur një aplikim për ndërtimin dhe instalimin e një centrali të ri elektrik me kapacitet jo më të vogël se 5 MW, jo më pak se 3 (tre) muaj më parë se paraqitja e aplikimit zyrtar për miratimin e propozimit.

2. Njoftimi për qëllimin do të përmbajë informacion mbi vendndodhjen dhe kapacitetin e centralit të propozuar, tipin e centralit, koston e përlllogaritur, afatin kohor të propozuar për ndërtim dhe shfrytëzim, skemën dhe nivelin e tensionit në të cilin centrali i propozuar do të lidhet me sistemin elektrik të vendit, si dhe qëndrimin e TSO-së lidhur me efektet që centrali i propozuar do të ketë në qëndrueshmërinë dhe aftësinë e sistemit elektrik.

#### Neni 9

##### **Forma e aplikimit**

Çdo aplikim do të paraqitet në formën e kërkuar nga ERE, në të kundërt nuk do të shqyrtohet.

#### Neni 10

##### **Dokumentet dhe të dhënat shoqëruese të kërkuara për të gjitha llojet e licencave**

Çdo aplikim për licencë do të përmbajë këto të dhëna:

###### **A. Identifikimi i Kompanisë.**

1. Emri i kompanisë
2. Adresa e selisë qendrore të kompanisë
3. Administratori i kompanisë
4. Përfaqësuesi apo i deleguari përgjegjës (nëse ka)
5. Certifikata dhe numri i kompanisë në regjistrin tregtar
6. NIPT (Numri i Personit të Tatueshëm)
7. Telefon
8. Fax
9. E-mail (nëse ka)
10. Tel.celular (nëse ka)
11. Nr. i llogarisë bankare të kompanisë e veçantë për këtë aktivitet.

###### **B. Dokumentacioni juridik që shoqëron kërkesën.**

1. Akti i themelimit të shoqërisë
2. Statuti i shoqërisë
3. Vendimi i regjistrimit si person juridik
4. Vërtetim që kompania, menaxheri i përgjithshëm, anëtarët e Këshillit Drejtues të kompanisë apo aplikuesi nuk janë të përfshirë në një proces të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata).

5. Një deklaratë të aplikuesit që tregon se aplikuesit i është mohuar ose jo apo i është hequr ndonjëherë një licencë për prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin ose eksportin e energjisë elektrike në ndonjë vend, dhe në rast se po, arsyet e këtij mohimi.

C. Dokumentacioni në fushën financiare dhe fiskale.

1. Vërtetim për regjistrimin dhe për shlyerjen e tatim-taksave.

2. Vërtetim për regjistrimin dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj institucionit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Vërtetim për siguracion (apo një kontratë sigurimi me një nga kompanitë e sigurimit) të veprimtarisë së aplikuesit në sektorin e energjisë elektrike.

4. Vërtetim që kompania nuk është në proces falimentimi (paraqitje bilanci të tre viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së saj)

5. Vërtetim për mbështetje financiare nga institucionet financiare, brenda dhe jashtë vendit për veprimtarinë e ardhshme në fushën e energjisë elektrike.

6. Vërtetimin e pagimit në llogari të ERE-s të pagesës së regjistrimit për marrje licence. (Shuma e pagesës caktohet me vendim të Bordit të ERE-s.)

D. Kërkesa në fushën administrative dhe organizative.

1. Shtrirja (gjeografike) e veprimtarisë së kompanisë ose aplikuesit për aktivitetin në fushën e energjisë elektrike. Ky dokument shoqërohet me hartën gjeografike.

2. Lidhjet dhe pjesëmarrjet ekzistuese në kompanitë ose grupe kompanish të tjera, ortakë apo aksionare. Paraqitja e detajuar e aktivitetit që kryejnë këto kompani të tjera. Paraqitja e detajuar e çdo aktiviteti tjetër që kryen aplikuesi jashtë fushës së energjisë elektrike.

3. Ndërtimi administrativ, struktura dhe përgjegjësitë e strukturave e shoqëruar me emrat përkatës.

4. Aftësitë tekniko-organizative dhe profesionale të personelit inxhiniero-teknik të kompanisë (kërkohen CV-të për të gjithë personelin), vërtetimet për aftësitë e tyre (diploma, certifikata, licenca, rekomandime etj.).

5. CV-të e manaxherit të aplikuesit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të kompanisë.

6. Rregullorja administrative dhe organizative e kompanisë.

## Neni 11

### Dokumentet shoqëruese dhe të dhënat specifike për tipin e licencës

Përveç dokumenteve të parashikuara në nenin 10 të kësaj rregulloreje, në varësi të tipit të licencës, aplikuesit duhet të paraqesin në ERE dokumentet e mëposhtme.

1. Për ndërtimin dhe instalimin e një centrali të ri, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga ky ose nga një central ekzistues:

- Tipi dhe modeli i centralit;
- Vendndodhja e centralit;
- Fuqia e tij në MW;
- Numri i njësive gjeneruese dhe fuqitë e tyre në MW;
- Sasia vjetore e energjisë elektrike që do të prodhojë;
- Data që mendohet për vënien në punë të centralit;
- Jetëgjatësia e pritshme e centralit;
- Vlerësimi paraprak i ndikimit në mjedis në nivel lokal dhe kombëtar;
- Vlerësime të përafërta të investimeve të kërkuara;
- Struktura e kapitalit që do të përdoret për ndërtimin e tij dhe burimet e financimit;
- Skema elektrike principale e centralit dhe lidhja e tij me sistemin e transmetimit ose shpërndarjes;
- Standardet teknike të pajisjeve të centralit;
- Lejen e ndërtimit të objekteve nga organet kompetente sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Të veçanta:

Për TEC-et:

- Teknologjia e përdorur në procesin e punës së centralit (me kondensim, kundër presion, cikël të kombinuar) parametrat teknikë të pajisjeve;
- Lloji i lëndës djegëse që do të përdoret dhe konsumi vjetor i saj;
- Rendimenti energjetik i njësive gjeneruese;
- Marrëveshjet paraprake për sigurinë e furnizimit me lëndë djegëse;
- Lejen e ndërtimit të objekteve nga organet kompetente sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Për HEC-et:

- Leja e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike;
- Tipi i centralit (me digë, derivacion, i kombinuar ose pompim);
- Parametrat kryesorë teknikë të digës, rezervuarit, kanalit të derivacionit dhe nyjeve kryesore të tij;
- Lejen e ndërtimit të objekteve nga organet kompetente sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

2. Për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike;

- Skema elektrike principale e linjave të transmetimit, nënstacioneve transformuese, nivelet e tensioneve të punës së tyre:

- Lista e linjave të transmetimit (ajrore, kabllore), gjatësitë në km, parametrat teknikë të tyre, kapaciteti nominal transformues MW;

- Lista e pikave të marrjes, dhënies dhe matjes së energjisë elektrike ndërmjet sistemit të transmetimit dhe centraleve, rrjeteve të shpërndarjes; vendndodhja e aparateve matës;

- Lista e linjave të interkonjeksionit, gjatësitë e tyre në km, parametrat teknikë të tyre, kapaciteti nominal transmetues në MW;

- Planet e investimeve për zgjerimin e sistemit të transmetimit;

- Planet e investimeve për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të transmetimit;

- Standardet teknike të linjave, elementeve përbërëse të tyre, transformatorëve, auto-transformatorëve, pajisjeve kyçëse-çkyçëse dhe elementeve të tjera të nënstacioneve;

- Sasia mesatare e energjisë elektrike e parashikuar për t'u transmetuar gjatë një viti në GWh;

- Lejen e ndërtimit të objekteve nga organet kompetente sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

3. Për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike:

- Gjatësia totale e rrjetit shpërndarës në km (linja ajrore, kabllore, ajrore-kabllore) nivelet e tensionit të punës së tyre;

- Lista e linjave 110 kV; 35 kV; 20 kV; 10 kV dhe 6 kV parametrat teknikë të tyre;

- Lista e nënstacioneve shpërndarës 110/35/10 kV; 110/35/6 kV; 110/20 kV; 35/6 kV, fuqitë transformuese të instaluar në to;

- Lista e pikave të marrjes së energjisë elektrike nga sistemi i transmetimit (niveli i tensioneve, si dhe mënyra e realizimit të matjes). Numri i kabinave të transformimit në nivelin 0.4 kV;

- Lista e centraleve elektrike të lidhura direkt me rrjetin e shpërndarjes ose nëpërmjet një nënstacioni transformimi (niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes);

- Numri i konsumatorëve që furnizon me energji elektrike;

- Sasia mesatare e energjisë së parashikuar për t'u shpërndarë gjatë një viti në zonën që mbulon;

- Planet e investimeve për zgjerimin e rrjetit shpërndarës;

- Planet e investimeve për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit shpërndarës;

- Lejen e ndërtimit të objekteve nga organet kompetente sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

4. Për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike:

- Sasia e energjisë mesatare të parashikuar për furnizimin e konsumatorëve gjatë një viti në GWh;

- Numri i konsumatorëve që do të furnizojë dhe sa nga ata janë konsumatorë të kualifikuar;

- Vendndodhja e pikave të marrjes së energjisë, niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes;

5. Për aktivitetin e importit dhe eksportit të energjisë elektrike:
- Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t'u importuar ose eksportuar në GWh;
  - Marrëveshjet paraprake për lejimin e transitimit nga sistemet e transmetimit të shteteve nga ku importohet ose eksportohet kjo energji;
  - Kapitali financiar për ushtrimin e këtij aktiviteti.

#### Neni 12

##### **Paraqitja e informacionit shtesë**

1. Gjatë një periudhe dymujore që nga data e marrjes së një aplikimi, ERE mund t'i kërkojë aplikuesit të paraqesë informacion shtesë, brenda një afati të caktuar, lidhur me çdo çështje që ERE e konsideron të nevojshme. Nëse ERE nuk bën asnjë njoftim të tillë brenda dy muajve, aplikimi do të konsiderohet i plotësuar.

2. Nëse aplikuesi nuk paraqet informacionin shtesë brenda afatit të caktuar nga ERE, aplikimi mund të mos pranohet.

#### Neni 13

##### **Publikimi i aplikimeve**

1. Brenda 14 ditëve nga paraqitja e një aplikimi, ERE do të publikojë për dy ditë me radhë në tri gazeta të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin që botohen në Tiranë:

- a) një përmbledhje të shkurtër të përmbajtjes së aplikimit;
- b) një njoftim që paraqitja e objeksioneve ose ankesave nga personat e interesuar mund të bëhen në ERE brenda dy muajve nga data e publikimit të parë.

2. Në rastin e një aplikimi për licencë importi ose eksporti, ERE do t'i dërgojë njoftim ministrit përgjegjës për energjinë.

3. ERE do të sigurojë që aplikimi dhe të gjitha dokumentet shoqëruese apo çdo informacion tjetër janë të disponueshme për inspektimin e publikut në zyrat e saj. ERE duke marrë parasysh pretendimet e aplikuesit, mund të vendosë se cilat informacione ose dokumente mbahen konfidenciale dhe mund të ndalojë inspektimin e tyre nga ana e palëve të interesuara.

#### Neni 14

##### **Objeksionet**

1. Brenda dy muajve nga data e publikimit të parë sipas paragrafit 1 të nenit 13 të kësaj rregulloreje, çdo person që ka interes ligjor mund të paraqesë në ERE një objeksion të arsyetuar në lidhje me ndonjë aplikim të bërë sipas kësaj rregulloreje.

2. ERE informon aplikuesin për objeksionet që mund të jenë marrë lidhur me aplikimin e tij.

3. Asnjë objeksion ose ankesë e marrë më vonë se afati i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni nuk do të merret parasysh nga ERE.

#### Neni 15

##### **Kontrolli i saktësisë së të dhënave të paraqitura nga aplikuesi**

1. Bordi i Komisionerëve të ERE-s do të caktojë një person drejtues sipas rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, i cili do të analizojë nëse dokumentet e depozituara nga aplikuesi përputhen me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe i komunikojnë deleguarit përgjegjës të aplikuesit nëse disa dokumente mungojnë ose janë në mospërputhje. Në rastin e fundit, aplikuesi do të plotësojë ose korrigjojë dokumentacionin sipas shënimeve të bëra nga personi drejtues, brenda kohës së specifikuar në rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

2. Në varësi të tipit të licencës së kërkuar, Departamenti i Licencimit dhe Departamenti Juridik mund të verifikojnë vërtetësinë e të dhënave të regjistruara në dokumente nëpërmjet inspektimit në vend. Përfaqësuesve të këtyre departamenteve do t'u jepet e drejta e hyrjes në

ambientet e aplikuesit për këtë qëllim. Rezultati i verifikimeve faktike në vend do të regjistrohet në një procesverbal që nënshkruhet nga përfaqësuesit e departamenteve dhe aplikuesi, ose i deleguari përgjegjës i aplikuesit. Në rast se të dhënat e regjistruara nuk mund të verifikohen, kjo do të vihet në dukje në procesverbal dhe pamundësia e verifikimit mund të justifikojë refuzimin e dhënies së licencës.

3. Pas kontrollit të dokumentacionit, përfshirë procesverbalin e përshkruar në paragrafin 2 të këtij neni, Departamenti i Licencimit dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun do t'i paraqesë Bordit një raport duke sugjeruar dhënien ose refuzimin e licencës, si dhe arsyetimet përkatëse.

### **KAPITULLI III DHËNIA E LICENCËS**

#### **Neni 16**

#### **Procedurat për shqyrtimin e aplikimeve**

1. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në nenin 14(1) për paraqitjen e objeksioneve ose ankesave, ERE shqyrton aplikimet në mënyrën që e konsideron më të përshtatshme për kushtet, si dhe duke aplikuar kriteret e specifikuar në nenin 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike".

2. Në marrjen e vendimit të tij, Bordi i ERE-s shqyrton :

a) aplikimin e aplikuesit, dokumentet dhe të dhënat e veçanta shoqëruese, si dhe çdo informacion shtesë të paraqitur nga aplikuesi;

b) çdo objeksion ose ankesë të paraqitur nga personat e interesuar;

c) raportin e hartuar nga Departamenti i Licencimit dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun.

3. Në marrjen e vendimit për të dhënë ose refuzuar një licencë për një aplikues, si dhe për termat dhe kushtet për një licencë të tillë, Bordi i ERE-s merr në konsideratë kriteret e detyrueshme të mëposhtme:

a) kompletimin dhe saktësinë e dokumentacionit të paraqitur;

b) aftësitë teknike, ekonomike dhe financiare të aplikuesit;

c) disponueshmërinë e një stafi të aftë dhe kompetent;

d) sigurinë dhe mbrojtjen e sistemit të transmetimit, rrjeteve të shpërndarjes, instalimeve të prodhimit dhe pajisjeve të ndërlydhura;

e) mbrojtjen e mjedisit;

f) prodhimin dhe përdorimin eficient të energjisë elektrike;

g) burimet e energjive primare dhe teknologjinë e propozuar për shndërrimin e energjisë;

h) nivelin e pritshëm të cilësisë së shërbimit që u është ofruar konsumatorëve;

i) detyrimet e shërbimit publik;

j) planifikimin afatgjatë të energjisë së vendit.

#### **Neni 17**

#### **Dhënia ose refuzimi i licencës**

1. Bordi i ERE-s e merr vendimin përfundimtar për dhënien ose refuzimin e licencës brenda 90 ditëve pas paraqitjes së aplikimit, duke e bazuar vendimin e tij në kriteret e specifikuar në nenin 16(3) të kësaj rregulloreje. Vendimi përfundimtar do të jetë me shkrim dhe do të përmbajë arsyet për dhënien ose refuzimin e licencës.

2. Vendimi i ERE-s për të dhënë një licencë sipas kësaj rregulloreje publikohet në Fletoren Zyrtare me shpenzimet e të licencuarit.

3. Vendimi i ERE-s, lidhur me dhënien ose refuzimin e licencës, mund të apelohe në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë nga aplikuesi ose çdo person që ka një interes ligjor dhe që ka paraqitur një objeksion sipas nenit 14 të kësaj rregulloreje brenda 30 ditësh nga data e vendimit.

## KAPITULLI IV MODIFIKIMET DHE HEQJA E LICENCAVE

### Neni 18

#### **Procedurat për modifikimin e licencave**

1. Në përgjigje të çdo kërkesë të të licencuarve ose me iniciativën e vet, ERE mund të modifikojë termat dhe kushtet e një licence që i konsideron të papërshtatshme, duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike.

2. ERE mund të vendosë modifikimin e licencës në rastet e mëposhtme:

a) kur ka ndryshime të rrethanave në datën e lëshimit të licencës (kuadri ligjor, vendime të gjykatës) ose të disa ngjarjeve që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në prodhimin, transmetimin ose shpërndarjen e energjisë elektrike ose tregun e energjisë elektrike;

b) kur këto ndryshime e bëjnë të pamundur plotësimin e pjesshëm ose të plotë të kushteve të vendosura në licencë;

c) kur ka ndryshime në strukturën e të licencuarit duke përfshirë ndarjen, bashkimin ose transformimin në një person tjetër juridik.

3. Nëse ERE vendos të ndryshojë një licencë, duhet t’i lëshojë të licencuarit një licencë me përmbajtje të ndryshuar, duke shfuqizuar licencën e mëparshme.

### Neni 19

#### **Procedurat për heqjen e licencave**

1. Licenca mund të hiqet kur i licencuari:

a) nuk përmbush kushtet ose termat e licencës;

b) shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit;

c) rrezikon shëndetin, jetën ose pronën e të tjerëve

d) nuk kryen pagesat rregullatore të kërkuara nga ERE.

2. Propozimi

a) Kur konstaton një nga rastet për heqjen e licencës, sipas nenit 18 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të paragrafit 1 të këtij neni, Departamenti i Licencimit apo personat e caktuar sipas rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, i propozon Bordit për heqjen e licencës.

b) Pas propozimit për heqje licence, ERE njofton zyrtarisht të licencuarin 60 ditë para se të dalë me vendim, për këtë propozim. Njoftimi përmban arsyet për heqjen e licencës, si dhe një afat prej 30 ditësh nga data e marrjes së njoftimit për të licencuarin, që ky i fundit të këtë mundësi të shprehet me anë të një përgjigje mbi propozimin dhe të ndërmarrë veprime për mënjanimin e shkaqeve për të cilat është propozuar heqja e licencës.

c) I licencuari ka të drejtë të kërkojë zhvillimin e një seance dëgjimore. Kërkesa për seancën dëgjimore duhet të shprehet në përgjigjen e të licencuarit të parashikuar në germën (b) të kësaj pike.

d) Seanca dëgjimore do të zhvillohet sipas dispozitave të pjesës IV të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.

e) Vendimi i ERE-s për heqjen e licencës do të hyjë në fuqi vetëm 60 ditë pas njoftimit të dhënë sipas germës (b) të kësaj pike. Nëse zhvillohet një seancë dëgjimore vendimi i ERE-s do të hyjë në fuqi pas mbarimit të seancës dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Vendimi i Bordit

a) Në përfundim të afatit të vënë në dispozicion të të licencuarit, Bordi, pasi shqyrton argumentat e paraqitura dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari, vendos mbi heqjen ose jo të licencës.

b) Kundër vendimit të Bordit i licencuari mund të bëjë ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare.

4. Kur Bordi i ERE-s i heq licencën një të licencuari ai ka autoritetin të vendosë masa të përkohshme deri në dhënien e një licence të re një personi që do të vazhdojë aktivitetin.

Masat e përkohshme do të konsistojnë në një ose më shumë nga rastet mëposhtme:

a) të lejojnë të licencuarin të vazhdojë përdorimin e aseteve dhe pajisjeve sipas kushteve dhe termave të caktuar nga ERE;

b) të kontaktojë me një ose më shumë shoqëri private që operojnë në sektorin e energjisë për vazhdimin e këtij aktiviteti;

c) të emërojë një administrator të përkohshëm, për mbikëqyrjen dhe përdorimin e pajisjeve deri në dhënien e një licence të re.

Emërimi i administratorit mund të vendoset vetëm pasi ERE të ketë përcaktuar se masat e përkohshme sipas germave (a) dhe (b) të kësaj pike, nuk janë efektive dhe nuk mbrojnë interesat e konsumatorëve.

5. Pas përfundimit të masave të përkohshme licenca i jepet një personi tjetër në përputhje me të gjitha rregullat për procedurat e licencimit. Kjo vlen edhe për personin të cilit i është hequr licenca në rastin e zbatimit të këtij neni, kur ai gjatë kësaj kohe me veprimet e kryera tregon se i ka mundësitë për t'u licencuar.

## KAPITULLI V REGJISTRI I LICENCEVE

### Neni 20

#### **Forma e regjistrit**

1. Licencat e lëshuara për kryerjen e aktiviteteve në sektorin e energjisë elektrike do të mbahen nga ERE në regjistrin e licencave.

2. Regjistri i licencave mbahet me shkrim dhe në mënyrë elektronike. Me regjistrin mbahet edhe dosja e dokumenteve shoqëruese.

3. Regjistri përbëhet nga të dhëna mbi çdo licencë të veçantë. Të dhënat në regjister shënohen me numrin e licencës.

### Neni 21

#### **Përmbajtja e regjistrit**

Në regjister futen detajet e mëposhtme:

a) Numri i licencës;

b) Data e miratimit të licencës;

c) Data e lëshimit të licencës;

d) Emrin e të licencuarit;

e) Vendndodhjen e të licencuarit;

f) Përshkrimin e aktivitetit, i cili është subjekt i licencës së lëshuar;

g) Kohëzgjatja e licencës;

h) Detaje mbi numrin dhe kualifikimin profesional të stafit të të licencuarit;

i) Të deleguarin përgjegjës të autorizuar për të përfaqësuar të licencuarin;

j) Skadimin e licencës;

k) Datën dhe përshkrimin e çdo modifikimi, tërheqje ose transferimi të licencës.

### Neni 22

#### **E drejta për t'u informuar mbi përmbajtjen e regjistrit**

1. Regjistri i licencave është i hapur për publikun. E drejta e inspektimit të regjistrit jepet vetëm në ambientet e ERE-s.

2. E drejta e hyrjes në dosjen e dokumenteve shoqëruese u jepet personave me interes ligjor siç përcaktohet nga ERE.

3. Informacioni konfidencial ose i biznesit nuk do të jetë i disponueshëm për inspektim ose rishikim publik, përderisa publikimi i tyre mund të sjellë dëme ekonomike.

## **KAPITULLI VI DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 23 Sanksionet**

ERE mund të ndërmarrë sanksione ndaj të licencuarit, në përputhje me nenin 64 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

### **Neni 24 Amendamente të rregullores**

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s.

### **Neni 25 Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

## **VENDIM Nr.34, datë 9.7.2004**

### **PËR MIRATIMIN E LICENCËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 13 pika 1 germa a dhe neni 15, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.7.2004, pasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Departamenti i Licencave dhe i Monitorimit dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun,

### **VENDOSI:**

1. Miratimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike (Licenca bashkëngjitur vendimit).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S  
Pjetër Dema**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

**LICENCË PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Seria: \_\_\_\_\_ Numri i licencës: \_\_\_\_\_

Data e hyrjes në fuqi: \_\_\_\_\_  
(Vendim i ERE-s, nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_)

Licenca i jepet: \_\_\_\_\_  
(Emri dhe adresa zyrtare)

Centrali: \_\_\_\_\_  
(Emërtimi, vendndodhja)

Kodi fiskal: \_\_\_\_\_

(Certifikata e regjistrimit: \_\_\_\_\_  
(Seria, numri, vendi i regjistrimit)

Bazuar në autoritetin që i është dhënë në pjesën e tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE) i jep këtë licencë prodhimi (“Licenca”), për të kryer aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike (PEE), personit të lartpërmendur, i quajtur “I licencuari”, subjekt i kushteve të kësaj licence. Kjo licencë hyn në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë prej \_\_\_\_ vjetësh, në rast se nuk përfundohet ose pezullohet nga ERE në përputhje me kushtet e licencës të përfshira këtu.

\_\_\_\_\_  
[Kryetari]

[Vula e ERE]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

**KUSHTET E LICENCËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Seria: \_\_\_\_\_ Numri i licencës: \_\_\_\_\_

I jepet: \_\_\_\_\_  
(Emri i plotë i të licencuarit)

**1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1.1 ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur sipas pjesës së tretë të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, për të lëshuar dhe deklaruar hyrjen në fuqi të kësaj licence.

1.2 Nëse ndonjë kusht i kësaj licence bëhet nul ose shfuqizohet, ky kusht do të hiqet nga kushtet e licencës dhe kushtet e mbetura të licencës do të vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi.

1.3 Asetet nuk mund të transferohen te një person tjetër, qoftë tërësisht apo pjesërisht pa një vendim të veçantë me shkrim të ERE-s.

1.4 ERE ka të drejtën ekskluzive për të ndryshuar këtë licencë, në rast se kushtet dhe rrethanat kanë ndryshuar, si dhe për të përmbushur dispozitat e çdo Kodi Rrjeti, Kodi Shpërndarje, Kodi Matës ose Rregulla Tregu të miratuara nga ERE sipas legjislacionit në fuqi.

1.5 Në çdo kohë i licencuari do të mbajë vetëm një licencë për prodhimin e energjisë elektrike.

1.6 Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përfshira në licencë, kushtet e licencës dhe anekset, kur përdoren, do të kenë kuptimet e mëposhtme:

|                               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Shërbimet ndihmëse            | Shërbimet e kërkuara për të ruajtur standarde të përcaktuara sigurie, qëndrueshmërie dhe cilësie të energjisë elektrike. Shërbimet ndihmëse përfshijnë: kompensimin reaktiv të energjisë, kontrollin fuqi-frekuencë, nivelet e tensionit, mirëmbajtjen dhe lëshimin e shpejtë të kapaciteteve rezervë dhe shërbime të tjera të këtij lloji.          |
| Biznesi shoqërues             | Çdo biznes tjetër që direkt ose indirekt, tërësisht ose pjesërisht:<br>1. është pronë e të licencuarit;<br>2. ka pronësi të licencuarin;<br>3. është në pronësi të një personi, i cili është pronë e të licencuarit.                                                                                                                                 |
| Ndërsubvencionimet            | Transferim fondesh ose ndarje kostosh brenda llogarive të të licencuarit ose mes bizneseve shoqëruese për mbështetje financiare të një aktiviteti ose biznesi me koston e një tjetri.                                                                                                                                                                |
| Furnizim me energji elektrike | Është dërgimi ose shitja e energjisë elektrike te klienti.                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| ERE                           | ERE do të thotë Enti i Rregullimit të Sektorit të Energjisë Elektrike ose institucioni pasues rregullator.                                                                                                                                                                                                                                           |
| Forca madhore                 | Një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend, si tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, ose akte apo ngjarje të tjera të cilat i) |

|                                                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
|-----------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                                       | janë jashtë kontrollit të mundshëm të të licencuarit dhe nuk ndodhin për faj të tij; ii) i licencuari nuk është në gjendje t'i eliminojë ato edhe pse ka ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e tij.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Prodhimi                                                              | Prodhimi i energjisë elektrike nëpërmjet transformimit të burimeve të ndryshme energjetike nga njësitë e prodhimit të të licencuarit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Njësi prodhimi                                                        | Njësitë individuale dhe/ose pajisjet kryesore të impiantit ose impianteve të poseduara nga i licencuari për prodhim të energjisë elektrike siç përshkruhen në mënyrë më të plotë në aneksin A.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Legjislacioni në fuqi                                                 | Ligjet e Republikës së Shqipërisë të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë dhe aktualisht në fuqi.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Licencë për furnizimin e energjisë elektrike me tarifa të rregulluara | Licencë e dhënë nga ERE që autorizon të licencuarin të sigurojë furnizim me energji elektrike për konsumatorët brenda një zone gjeografike të caktuar me tarifa të rregulluara nga ERE.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Aktiviteti i licencuar                                                | Prodhimi i energjisë elektrike nga i licencuari, përfshirë aktivitetet e nevojshme të lidhura me prodhimin e saj.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| I licencuari                                                          | Personi që mban këtë licencë për prodhimin e energjisë elektrike, i përmendur në faqen e parë të kësaj licence.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Personi                                                               | Person do të thotë çdo person fizik ose juridik.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Centrali i energjisë elektrike                                        | Tërësia e të gjithë sistemit të pajisjeve, përfshirë njësitë e prodhimit të dhëna në aneksin A, pajisjet sekondare të përfshira në të, ato që kryejnë furnizimin me lëndë djegëse, pajisjet shndërruese të tensionit të lartë dhe disa objekte jashtë zonës ku është vendosur ai (p.sh. ujësjellës, zona të depozitimit të mbetjeve teknologjike) etj. Asetet, të prekshme ose jo të prekshme, që zotërohen ose kontrollohen tërësisht ose pjesërisht, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj licence ose që blihen tërësisht ose pjesërisht në çdo kohë gjatë afatit të licencës nga i licencuari dhe përdoren për qëllimin e prodhimit të energjisë elektrike. |
| Sistemi elektroenergjetik                                             | Sistem i ndërlidhur që përbëhet nga centralet elektrike, linjat, nënstacionet dhe pajisjet për transmetimin ose shpërndarjen e energjisë elektrike te konsumatorët brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| Tarifat e rregulluara                                                 | Një tarifë aktualisht në fuqi, e aprovuar nga ERE sipas legjislacionit në fuqi.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Rregulloret dhe rregullat                                             | Standardet, kodet, rregulloret, urdhrat dhe rekomandime të tjera në fuqi të miratuara nga ERE.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Transferimi                                                           | Transferim do të thotë çdo shitje, dhënie me qira ose ndonjë disponim tjetër, i plotë ose i pjesshëm, i së drejtës për t'u angazhuar në aktivitetin e licencuar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Operatori i sistemit të transmetimit (OST)                            | Personi i licencuar, përgjegjës për aktivitetet e transmetimit dhe dispeçerimit dhe për procesin e kontrollit të operimit të centraleve prodhuese elektrike dhe faciliteteve të tjera të industrisë së energjisë elektrike për të siguruar stabilitetin, qëndrueshmërinë, sigurinë dhe operimin eficient të sistemit elektroenergjetik.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |

## 2. KRYERJA E AKTIVITETIT TË LICENCUAR

2.1 I licencuari autorizohet nga kjo licencë për të ushtruar aktivitetin e licencuar në centralet elektrike që përdorin njësitë prodhuese të specifikuara në aneksin A. I licencuari, në çdo kohë dhe në çdo aspekt të aktivitetit të tij të licencuar, do të prodhojë energji elektrike në përputhje me standardet e paraqitura në rregulloret dhe rregullat e miratuara nga ERE.

2.2 Nëse i licencuari është kompani vertikalisht e integruar, që mban gjithashtu licenca për t'u angazhuar në aktivitetet e transmetimit dhe shpërndarjes, tarifa e rregulluar e propozuar nga i licencuari duhet të përfshijë pagesa për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen. Pagesa për çdo aktivitet të licencuar dhe pagesa totale të vendosen të ndara në çdo tarifë të rregulluar të aprovuar nga ERE gjashtë muaj pas afatit të parashikuar në nenin 33 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike".

2.3 I licencuari do të njoftojë menjëherë ERE-n për çdo ndryshim në kapacitetin e secilit prej njërive prodhuese ose centraleve elektrike të identifikuara në aneksin A që rrisin ose ulin kapacitetin prodhues të disponueshëm nga i licencuari në një mënyrë që mund të ndikojë shumë në shërbimin e konsumatorëve për një periudhë më të madhe se 30 ditë.

2.4 Çdo rritje e kapacitetit të disponueshëm, që kalon 10% të sasisë të kapacitetit të identifikuar në aneksin A, me përjashtim të periudhave të përkohshme që zgjasin më pak se dymbëdhjetë muaj, do të kërkojë një amendim të kësaj licence.

2.5 Me qëllim që të nxitet konkurrenca në tregun e energjisë elektrike, ERE mund të kufizojë, herë pas here, kapacitetin total prodhues të autorizuar nga kjo licence.

2.6 Gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, të licencuarit i kërkohet të sigurojë jetën dhe shëndetin e njerëzve, si dhe pronat e tyre në përputhje me legjislacionin, rregulloret dhe rregullat e tjera në fuqi.

2.7 I licencuari nuk do të pengojë, parandalojë ose tentojë të pengojë të licencuarit e tjerë ose konkurrentët potencialë që të angazhohen ose të hyjnë në mënyrë të ligjshme në biznesin elektrik në Republikën e Shqipërisë.

2.8 I licencuari nuk do të angazhohet në ndërsbvencionime. Nëse i licencuari është plotësisht ose pjesërisht, një kompani vertikalisht e integruar e energjisë elektrike, do të ndajë llogaritë e tij financiare sipas aktiviteteve të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes brenda afatit të kërkuar nga legjislacioni në fuqi në mënyrë të mjaftueshme për të mundësuar që ERE të konkludojë se nuk ka ndërsbvencionime, aktivitete antikonkurruese ose diskriminuese.

2.9 I licencuari nuk do të angazhohet në asnjë formë aktiviteti monopol të ndaluar nga legjislacioni në fuqi ose rregulloret dhe rregullat e aprovuara nga ERE.

2.10 I licencuari do ta kryejë aktivitetin e licencuar në përputhje me parimet e efikasitetit ekonomik dhe objektivin për arritjen e kostove më të ulëta.

2.11 I licencuari nuk duhet të angazhohet në aktivitete të tjera, që pengojnë ose mund të pengojnë kryerjen e duhur të aktivitetit të licencuar. I licencuari do të informojë ERE-n para se të ndërmarrë ndonjë aktivitet, përveç aktivitetit të licencuar. ERE mund ta ndalojë të licencuarin të kryejë çdo aktivitet, përveç aktivitetit të licencuar, kur konstaton se interesat e konsumatorëve mund të dëmtohen.

2.12 I licencuari do të informojë ERE-n për ngritjen e çdo biznesi shoqëruar. ERE mund të imponojë kushte për ngritjen e biznesit shoqëruar, të nevojshme për të mbrojtur konsumatorët e Republikës së Shqipërisë.

2.13 I licencuari nuk do të bashkëpunojë në asnjë mënyrë me të licencuar të tjerë për përgatitjen dhe negocimin e çështjeve të ERE-s, që lidhen ose që ndikojnë në tarifat e energjisë elektrike ose në pagesat e tjera të konsumatorëve, ose të bashkëpunojë në ndonjë mënyrë lidhur me aktivitetin e licencuar në dëm të furnizuesve ekzistues ose potencialë ose të konsumatorëve, përveç kur i kërkohet shprehimisht nga rregulloret dhe rregullat e ERE-s.

## 3. DETYRIMET E TË LICENCUARIT

3.1 I licencuari do të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe gjithë vendimet e Qeverisë dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s jo në konflikt me legjislacionin në fuqi.

### 3.2 Llogaritë dhe raportimi

3.2.1 I licencuari do të mbajë regjistra llogarie dhe do të përgatisë bilance financiare, të cilat do të mbahen të ndara për aktivitetin e licencuar dhe çdo aktivitet tjetër (përfshirë aktivitete të tjera të licencuara) ku është angazhuar i licencuari, në përputhje me rregullat dhe procedurat e kontabilitetit të miratuara nga ERE dhe në përputhje me ligjin nr.7961, datë 19.1.1993 “Për kontabilitetin”, nenin 33 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. I licencuari do t’i dorëzojë ERE-s bilancet financiare vjetore së bashku me raportet e auditit brenda datës 30 maj të çdo viti.

3.2.2 Të licencuarit i kërkohet të përgatisë dhe t’i paraqesë ERE-s deri më 31 mars të çdo viti, një raport vjetor lidhur me operimet e tij gjatë vitit kalendarik të mëparshëm dhe që përmban sa më poshtë:

1. një përmbledhje dhe analizë të aktiviteteve të të licencuarit;
2. prodhimin e energjisë elektrike gjatë vitit;
3. cilësinë e prodhimit dhe detaje të çdo mase të marrë për përmirësimin e cilësisë së prodhimit;
4. çdo defekt të ndodhur gjatë vitit;
5. detaje mbi çdo ndryshim të bërë në asetet e prodhimit, përfshirë detaje të çdo elementi që është zgjeruar, nxjerrë jashtë përdorimit ose zëvendësuar gjatë vitit.

3.2.3 Nëse i licencuari parashikon një situatë emergjence siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi, i licencuari do të njoftojë pa vonesë ERE-n dhe ky njoftim do të përshkruajë çfarë masash do të marrë i licencuari për të parandaluar ose përmirësuar ndikimet e situatës emergjente në prodhimin e energjisë elektrike.

3.2.4 I licencuari do të ndajë shpenzimet e përbashkëta mes aktivitetit të tij të licencuar dhe aktiviteteve të tjera (përfshirë dhe ato të licencuara) mbi një bazë të arsyeshme, që të mos cenojë cilësinë e shërbimit për aktivitetet e licencuara, në përputhje me klauzolën 3.2.1 të kësaj licence. I licencuari do t’i paraqesë ERE-s dokumentacionin që tregon bazat për ndarjen e shpenzimeve të përbashkëta, si dhe rezultatet e arritura.

3.2.5 I licencuari do të njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të:

- a) adresës;
- b) statutit të të licencuarit;
- c) certifikatës së regjistrimit;
- d) kodit fiskal;
- e) menaxherit kryesor;
- f) strukturës së aseteve me mbi 10%.

3.2.6 Gjithë njoftimet zyrtare, aplikimet, petitionet, deklaratat ose korrespondenca tjetër me ERE-n, lidhur me detyrimet sipas kësaj licence, duhet të jenë me shkrim, duke caktuar respektivisht nga një zyrtar të autorizuar ose përfaqësues tjetër të të licencuarit ose të ERE-s. Këto dërgohen me korrier ose postë të regjistruar, duke kërkuar një verifikim të fletës së marrjes. Adresat e palëve duhet të vendosen mbi zarf. Gjithë njoftimet ose korrespondenca tjetër do të konsiderohen se hyjnë në fuqi nga momenti i dorëzimit ose, nëse nuk janë dorëzuar për shkak të gabimit të dërguesit, nga momenti i prezantimit.

### 3.3 Përdorimi i informacionit

3.3.1 I licencuari do të sigurojë që çdo informacion i marrë nga të tjerë si rezultat i aktivitetit të tij të licencuar nuk do t’i jepet askujt, me përjashtim të rasteve kur:

- a) jepet pëlqimi paraprak me shkrim i personit me të cilin lidhet informacioni;
- b) kur informacioni është bërë publik;
- c) të licencuarit i kërkohet ose i lejohet të përhapë informacionin për të përmbushur kushtet e kësaj licence sipas një urdhri të ERE-s ose çdo dispozite ligjore të aplikueshme.

3.3.2 I licencuari do të sigurojë që çdo biznes shoqërues nuk do të përdorë asnjë informacion në posedim të të licencuarit për të fituar një avantazh konkurrues të pajustifikuar, dhe do të sigurojë që nuk do të përhapë asnjë informacion te ndonjë person tjetër (përfshirë ata të një biznesi tjetër shoqërues) gjë që do të mundësonte këtë person të fitonte çdo lloj avantazhi komercial të pajustifikuar.

3.3.3 I licencuari do të hartojë dhe do t'i paraqesë ERE-s procedurat për të siguruar respektimin e paragrafëve 3.3.1 dhe 3.3.2. Me kërkesën e ERE-s, i licencuari do të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për të ruajtur informacionin konfidencial në posedim të të licencuarit dhe për t'i dorëzuar ERE-s raporte lidhur me përmbushjen e detyrimeve të specifikuara në paragrafët 3.3.1 dhe 3.3.2.

3.3.4 Informacioni i dërguar ERE-s nga i licencuari do të konsiderohet publik me përjashtim të rasteve kur me kërkesë specifike të të licencuarit, ERE me vendim, përcakton që ky informacion është i natyrës pronësore dhe se përhapja e tij nuk i shërben interesit publik.

3.4 I licencuari do të ndërmarrë gjithë masat e nevojshme për të rritur efikasitetin operativ dhe ekonomike të aktivitetit të licencuar, me qëllim që të sigurojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të kryera në përfitim të konsumatorëve.

3.5 I licencuari do të zbatojë rregulloret dhe rregullat e aplikueshme të operatorit të sistemit të transmetimit të aprovuara nga ERE, përfshirë kryerjen e të gjitha urdhrave operativë, instruksioneve ose udhëzimeve dhe paraqitjen e informacionit teknik dhe gjithë dokumentacionit tjetër të kërkuar.

3.6 Për të lehtësuar kryerjen e aktivitetit të licencuar, i licencuari mund të kërkojë të drejtat e përdorimit dhe shpronësimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. I licencuari, në bazë të legjislacionit në fuqi, ka të drejtën të blejë truall, prona të tjera dhe të kryejë punë ndërtuese përsa kohë këto veprime përputhen me rregulloret dhe rregullat e ERE-s.

3.7 Detyrimet ndaj operatorit të sistemit të transmetimit

3.7.1 I licencuari do ta vendosë gjithë kapacitetin prodhues të njërive të tij prodhuese, në rast të integritetit në sistemin elektroenergjetik, në dispozicion të operatorit të sistemit të transmetimit, me qëllim që ky të arrijë koordinimin e ekuilibrit të bilanceve elektroenergjetike brenda sistemit elektroenergjetik.

3.7.2 I licencuari do të respektojë rregulloret dhe rregullat e operatorit të sistemit të transmetimit të aprovuara nga ERE, përfshirë kryerjen e gjithë urdhrave operativë, instruksioneve ose udhëzimeve dhe dorëzimin e informacionit teknik dhe gjithë dokumentacionit tjetër të kërkuar.

3.7.3 I licencuari do të sigurojë shërbime ndihmëse sa herë që do t'i kërkohej për ta bërë këtë nga operatori i sistemit të transmetimit në përputhje me rregulloret dhe rregullat e aprovuara nga ERE.

3.7.4 Kontratat për shitje të energjisë elektrike nga i licencuari do të regjistrohen tek operatori i sistemit të transmetimit vetëm kur aprovohen nga ERE.

3.7.5 Gjithë kontratat për furnizim energjie elektrike (marrëveshjet për blerje energjie elektrike) ndërmjet të licencuarit dhe enteve të tjera duhet të përputhen me kontratat model të miratuara nga ERE.

3.8 Rritja ose ulja e kapacitetit prodhues.

3.8.1 I licencuari do të informojë ERE-n dhe operatorin e sistemit të transmetimit mbi reduktimin e pjesshëm ose të plotë të kapacitetit prodhues, të paktën një vit para realizimit të tij duke paraqitur një shpjegim të detajuar për këtë qëllim. ERE mund ta përjashtojë të licencuarin nga ky detyrim, në rast se reduktimi i kapacitetit të prodhimit shkaktohet nga një forcë madhore.

3.8.2 Planifikimi, ndërtimi dhe futja në punë e kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike, si dhe instalimet e tjera që lidhen me to, do të kryhen nga i licencuari në përputhje me rregulloret dhe rregullat në fuqi të miratuara nga ERE.

3.9 Mosmarrëveshja mes të licencuarit dhe një konsumatori ose të licencuarit dhe një të licencuarit tjetër që ka të bëjë me një çështje brenda juridiksionit të ERE-s, që nuk mund të zgjidhet nëpërmjet negociatave të palëve, do të zgjidhet nga ERE, pasi të dëgjojë më parë palët, brenda qëllimit të autoritetit të ERE-s dhe në përputhje me rregulloret dhe rregullat e tij.

3.10 Pagesat e rregullimit

3.10.1 I licencuari do të paguajë taksën rregullatore në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme gjatë afatit të kësaj licence siç përcaktohet nga ERE, në përputhje me nenin 12 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe rregulloret e aplikueshme të ERE-s.

3.10.2 Nëse i licencuari nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit në përputhje me paragrafin 3.10.1, brenda afatit të kërkuar nga ERE, i licencuari do të penalizohet në përputhje me nenin 64 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

#### 4. KONTROLI MBI KRYERJEN E AKTIVITETIT TË LICENCUAR

4.1 ERE do të monitorojë zbatimin e kushteve të licencimit nga i licencuari, do të shqyrtojë raportet e marra nga i licencuari dhe, në çdo kohe, mund të inspektojë regjistrimet e llogarive të të licencuarit dhe të kërkojë një auditim teknik dhe/ose kontabël të aktiviteteve të tij.

4.2 Përfaqësues të autorizuar të ERE-s kanë të drejtë të inspektojnë objektet e të licencuarit, pajisjet dhe dokumentet e tij për të verifikuar përputhjen e kryerjes së aktivitetit të licencuar me kushtet e licencës, si dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s. I licencuari do të sigurojë çdo ndihmë të kërkuar, të nevojshme për ERE-n gjatë këtij inspektimi.

4.3 Në bazë të ankesës së çdo pale të tretë ose në bazë të vetë propozimit të ERE-s, ky i fundit mund të nisë një hetim mbi zbatimin nga i licencuari të kushteve të licencës së tij ose të rregulloreve dhe rregullave të miratuara nga ERE.

4.4 I licencuari do të informojë ERE-n duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës brenda një jave nga momenti kur kjo shkelje bëhet e njohur për të licencuarin.

4.5 Nëse pas hetimit, ERE konkludon se i licencuari nuk i ka zbatuar kushtet e licencës, ERE mund të korrigjojë tarifat dhe kontratat e të licencuarit dhe/ose të marrë masa të tjera brenda qëllimit të autoritetit të tij për të mbrojtur interesat e konsumatorëve të energjisë elektrike.

4.6 I licencuari do t’u bindet vendimeve të marra nga ERE, përfshirë pagesën e gjobave të vendosura nga ERE, në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregulloret dhe rregullat e ERE-s dhe kushtet e kësaj licence.

#### 5. AMENDAMENTI I LICENCËS

5.1 ERE mund të amendojë kushtet e licencës, në rast se ato nuk përputhen me:

a) Legjislacionin në fuqi dhe vendimet e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, që janë në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) Vendimet e nxjerra nga Gjykata e Shkallës Parë, Tiranë ose një gjykatë tjetër shqiptare me kompetencë juridiksionale.

5.2 Në çdo kohë i licencuari ose ERE mund të propozojnë amendamente të tjera për këto kushte licence, përveç atyre të përcaktuara në paragrafin 5.1, duke i transmetuar një propozim me shkrim së bashku me çdo argument mbështetës, palës tjetër.

5.3 ERE do të marrë vendimin përfundimtar vetëm pasi të marrë në konsideratë interesat e konsumatorëve dhe të licencuarve të tjerë. Personat e interesuar do të informohen me shkrim për çdo amendament të propozuar. Nëse ERE dhe i licencuari arrijnë një marrëveshje për këto amendamente, kushtet e licencës do të amendohen. Nëse marrëveshja nuk arrihet, i licencuari mund të apelojë vendimin e ERE-s në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë.

#### 6. PEZULLIMI DHE HEQJA E LICENCËS

6.1 ERE mund ta pezullojë ose ta përfundojë licencën, në përputhje me rregulloret dhe rregullat e ERE-s kur:

- a) i licencuari kërkon revokimin e licencës;
- b) i licencuari shkel kushtet e licencës;
- c) i licencuari shkel legjislacionin në fuqi;
- d) i licencuari deklarohet i falimentuar dhe është i paaftë të përmbushë detyrimet e kushteve të licencës;
- e) i licencuari ka marrë licencë duke mashtruar.

6.2 Nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose nëse aksionari që kontrollon interesat ndryshohet pa autorizimin e ERE-s, licenca bëhet nul (e pavlefshme) dhe anulohet dhe pasuesi i të licencuarit do të aplikojë për një licencë të re, në përputhje me procedurat e ERE-s për dhënie licence.

## 7. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE E DREJTA PËR APELIM

7.1 Çdo çështje e diskutueshme ose kërkesë mes të licencuarit dhe çdo përdoruesi të sistemit të transmetimit lidhur me aktivitetin dispeçerues ose kushtet e licencës do të zgjidhet sa më shumë që të jetë e mundur me mirëkuptim, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s.

7.2 Nëse zgjidhja nuk arrihet me mirëkuptim, atëherë ERE në bazë të petitionit të çdo personi që është palë në këtë mosmarrëveshje do ta zgjidhë mosmarrëveshjen dhe do të nxjerrë vendim.

7.3 Çdo palë në konflikt mund të apelojë kundër vendimeve të ERE-s në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë.

7.4 Palët janë të detyruara t'u binden vendimeve të përkohshme të ERE-s në pritje të apelit në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë ose në ndonjë gjykatë tjetër të Republikës së Shqipërisë me kompetencë juridiksionale.

### REPUBLIKA E SHQIPËRISË ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

#### LICENCË PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Licenca i jepet:

(Emri i plotë i të licencuarit)

Seria: \_\_\_\_\_

Numri i licencës: \_\_\_\_\_

Data e hyrjes në fuqi të këtij aneksi: \_\_\_\_\_

#### ANEKSI A LISTA E AUTORIZUAR E IMPIANTEVE DHE NJËSIVE GJENERUESE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

| Impianti | Numri i njësisë | Kapaciteti i instaluar | Data e vënies në shërbim |
|----------|-----------------|------------------------|--------------------------|
|          |                 |                        |                          |
|          |                 |                        |                          |
|          |                 |                        |                          |



**VENDIM**  
**Nr.35, datë 9.7.2004**

**PËR MIRATIMIN E LICENCËS SË VEPRIMTARISË SË TRANSMETIMIT**

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 13 pika 1 germa b dhe neni 15, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.7.2004, pasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Departamenti i Licencave dhe i Monitorimit dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e licencës së veprimtarisë së transmetimit (Licenca bashkëngjitur vendimit).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Pjetër Dema**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE**

**LICENCË PËR VEPRIMTARINË E TRANSMETIMIT**

Seria: \_\_\_\_\_ Numri i licencës: \_\_\_\_\_

Data e hyrjes në fuqi: \_\_\_\_\_  
(Vendim i ERE-s, nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_)

Licenca i jepet: \_\_\_\_\_  
(Emri dhe adresa zyrtare)

Kompania \_\_\_\_\_  
(Emërtimi, vendndodhja)

Kodi fiskal: \_\_\_\_\_

Certifikata e regjistrimit: \_\_\_\_\_  
(Seria, numri, vendi i regjistrimit)

Bazuar në autoritetin që i është dhënë në pjesën e tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për energjinë elektrike”, Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (“ERE”) i jep këtë licencë transmetimi (“Licenca”), për të kryer veprimtarinë e transmetimit të energjisë elektrike (TEE), personit të lartpërmendur, i quajtur “I licencuari”, subjekt i kushteve të licencës të bashkëngjitur dhe pjesë integrale e saj. Kjo licencë hyn në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë \_\_\_\_ vitesh, në rast se nuk përfundohet ose pezullohet nga ERE në përputhje me kushtet e licencës të përfshira këtu.

\_\_\_\_\_  
( Kryetari )

[Vula e ERE]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

**KUSHTET E LICENCËS PËR AKTIVITETIN TRANSMETUES**

Seria: \_\_\_\_\_ Numri i licencës: \_\_\_\_\_

I jepet: \_\_\_\_\_  
(Emri i plotë i të licencuarit)

**1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1.1 ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur në pjesën e tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, për të lëshuar dhe deklaruar hyrjen në fuqi të kësaj licence.

1.2 Nëse ndonjë kusht i kësaj licence bëhet nul ose i anulueshëm apo pushon së qeni në fuqi, ky kusht do të hiqet nga licenca dhe kushtet e mbetura të licencës do të vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi.

1.3 Asetet nuk mund të transferohen tek asnjë person tjetër pa aprovimin paraprak me shkrim të ERE-s. Kur aprovon një transferim, ERE mund ta ndryshojë periudhën e licencës ose kushtet e tjera të licencës pasi të tregojë një shkak të arsyeshëm.

1.4 ERE ka të drejtën ekskluzive për të ndryshuar këtë licencë, në rast se kushtet dhe rrethanat kanë ndryshuar, si dhe për të përmbushur dispozitat e çdo Kodi Rrjeti, Kodi Shpërndarje, Kodi Matës ose Rregulla Tregu të miratuara nga ERE sipas legjislacionit në fuqi.

1.5 Në Republikën e Shqipërisë do të jepet vetëm një licencë për aktivitetin transmetues.

1.6 Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në licencë, kushtet e licencës dhe anekset, kur përdoren, do të kenë kuptimet e mëposhtme:

|                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|---------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Shërbimet ndihmëse        | Shërbimet e kërkuara për të ruajtur standarde të përcaktuara sigurie, qëndrueshmërie dhe cilësie të energjisë elektrike. Shërbimet ndihmëse përfshijnë: kompensimin reaktiv të energjisë, kontrollin fuqi-frekuencë, nivelet e tensionit, mirëmbajtjen dhe lëshimin e shpejtë të disa njësive dhe kapaciteteve rezervë, si dhe shërbime të tjera të këtij lloji. |
| Biznesi shoqërues         | Çdo biznes që direkt ose indirekt, tërësisht ose pjesërisht:<br>1. është pronë e të licencuarit;<br>2. ka të licencuarin në pronesi; ose<br>3. është në pronësi të personit, i cili është pronë e të licencuarit.                                                                                                                                                |
| Ndër-sbvencionimet        | Transferim fondesh ose ndarje kostosh brenda llogarive të të licencuarit ose mes bizneseve shoqëruese për mbështetje financiare të një aktiviteti ose biznesi me koston e një tjetri.                                                                                                                                                                            |
| Dispeçerimi               | Menaxhimi i sistemit elektroenergjetik duke marrë parasysh programimin dhe ruajtjen e sigurtisë operative dhe cilësisë së kushteve teknike.                                                                                                                                                                                                                      |
| Rrjeti shpërndarës (RrSh) | Linja elektrike, transformatorë dhe pajisje komutuese, me përcjellës zakonisht mbi tensionin mesatar dhe të ulët (110 kV dhe më pak), të përdorura për të siguruar furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve.                                                                                                                                             |
| Energjia elektrike        | Energjia elektrike dhe kapaciteti elektrik, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe.                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Konsumatori i kualifikuar | Një konsumator që ka të drejtën sipas legjislacionit në fuqi ose rregulloreve të aplikueshme të ERE-s, të zgjedh                                                                                                                                                                                                                                                 |

|                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|--------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                              | furnizuesin e energjisë elektrike për energjinë elektrike të përdorur për nevojat e tij.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Forca madhore                                                | Një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend si tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, ose akte apo ngjarje të tjera të cilat: i) janë jashtë kontrollit të mundshëm të të licencuarit dhe nuk ndodhin për faj të tij; ii) i licencuari nuk është në gjendje t'i eliminojë ato edhe pse ka ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e tij. |
| ERE                                                          | “ERE” do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike ose institucioni pasues rregullator.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Legjislacioni në fuqi                                        | Ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Aktiviteti i licencuar                                       | Aktivitete të nevojshme dhe të lidhura direkt me përdorimin e rrjetit transmetues për transportimin e energjisë elektrike, si dhe aktivitetet dispeçeruese dhe kontrolli i operimit të impianteve gjeneruese dhe faciliteteve të tjera energjetike dhe burimeve për sigurimin e stabilitetit, qëndrueshmërisë, sigurisë dhe operimit eficient të sistemit elektroenergjetik.                                                                                                                                                                                              |
| I licencuari                                                 | Personi që mban këtë licencë për aktivitetin transmetues i përmendur në faqen e parë të kësaj licence në bazë të së cilës zotëron, operon, mirëmban dhe zhvillon rrjetin transmetues.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| Metodologjia e llogaritjes së kostove për shërbimet ndihmëse | Procedurat e aprovuara nga ERE për të llogaritur kostot që do të vendosen sipas tarifave të aprovuara nga ERE për sigurimin e shërbimeve ndihmëse për FKK, prodhuesit e vegjël të energjisë dhe konsumatorët e kualifikuar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Tarifat e shërbimeve ndihmëse (TShS)                         | Një program pagesash dhe tarifash të aprovuara nga ERE, që bën i licencuari për sigurimin e shërbimeve ndihmëse.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Procedurat operuese                                          | Rregulla të hartuara nga i licencuari për aktivitetin dispeçerues dhe të aprovuara nga ERE, të nevojshme për të siguruar operimin e qëndrueshëm të sistemit të energjisë elektrike dhe të tregut të energjisë elektrike të Republikës së Shqipërisë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Personi                                                      | “Person” do të thotë çdo person fizik ose juridik.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Tregu i energjisë                                            | Marrëveshje tregtare për shit-blerjen e energjisë elektrike me shumicë në Sistemin Elektroenergjetik, me qëllim që të sigurohet furnizimi i qëndrueshëm i konsumatorëve me energji elektrike brenda sistemit elektroenergjetik të Republikës së Shqipërisë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Licenca për furnizim me energji                              | Licenca të mbajtura nga prodhuesit, FKK, prodhuesit e vegjël të energjisë ose çdo furnizues tjetër i energjisë elektrike.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Sistemi elektroenergjetik                                    | Një sistem i ndërlidhur që përbëhet nga impiante elektrike, linja energjetike, nënstacione dhe pajisje për transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Prodhuesi                                                    | Një person i licencuar për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |

|                                                                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|---------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Sistemi i transmetimit (ST)                                                           | Grup linjash elektrike të tensionit të lartë dhe të mesëm (110 kV, 220 kV, 400 kV) mekanizma dhe pajisje të tjera shoqëruese transformuese, përfshirë instalimet ndihmëse, që formojnë një sistem të ndërlidhur që përdoret për transmetimin në distancë të largët të energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë. |
| Furnizuesi konkurrues i kualifikuar (FKK)                                             | Një person që ka të drejtën të furnizojë me energji elektrike konsumatorët e kualifikuar siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi ose rregulloret dhe rregullat e miratuara nga ERE.                                                                                                                                 |
| Rregulloret dhe rregullat                                                             | Standardet, kodet, rregulloret, rregullat, urdhrat dhe rekomandimet e tjera në fuqi të aprovuara nga ERE ose ndonjë autoritet tjetër i përcaktuar me ligj.                                                                                                                                                            |
| Prodhuesi i vogël i energjisë elektrike<br>Furnizuesi                                 | Person i licencuar për prodhimin e energjisë elektrike nga një central me kapacitet të instaluar deri në 5 MW<br>Një person i licencuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve.                                                                                                                         |
| Shërbimet e transmetimit                                                              | Transmetimi i energjisë elektrike mes dy ose më shumë pikave të sistemit të transmetimit.                                                                                                                                                                                                                             |
| Tarifat e shërbimeve transmetuese (Tarifat e ShT)                                     | Tarifat e aprovuara nga ERE, që i licencuari është i detyruar të aplikojë për shërbimet e transmetimit të energjisë elektrike në sistemin e transmetimit.                                                                                                                                                             |
| Përdoruesi i sistemit të transmetimit (Përdoruesi i ST)                               | Persona që kryejnë aktivitetet të licencuar në sistemin e energjisë elektrike, si prodhues, shpërndarës, konsumatorë të kualifikuar të lidhur me sistemin e transmetimit dhe që përfitojnë nga shërbimet e transmetimit.                                                                                              |
| Përdorimi i sistemit të transmetimit nga sistemet transmetuese të rajonit             | Transportimi i energjisë elektrike ndërmjet sistemeve transmetuese të vendeve të rajonit, duke përdorur sistemin e transmetimit të Shqipërisë.                                                                                                                                                                        |
| Tarifat e përdorimit të sistemit të transmetimit nga sistemet transmetuese të rajonit | Tarifa e aprovuar nga ERE që i licencuari është i detyruar të aplikojë për transmetimin e energjisë elektrike nga sisteme transmetuese të rajonit, duke përdorur sistemin e transmetimit të Shqipërisë.                                                                                                               |

## 2. KRYERJA E AKTIVITETIT TË LICENCUAR

2.1 I licencuari autorizohet nga kjo licencë për të drejtuar aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë. Kjo e drejtë i jepet ekskluzivisht të licencuarit.

2.2 I licencuari nuk do të vendosë pagesa për Shërbimet e Transmetimit ose Shërbimet Ndhmëse përveç kur autorizohet nga tarifat ShT të aprovuara nga ERE herë pas here sipas legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve dhe rregullave të ERE-s. (Nëse i licencuari është një kompani vertikalisht e integruar që mban licencë për aktivitetin e transmetimit dhe licenca për t'u angazhuar në aktivitetet e shpërndarjes dhe gjenerimit, tarifa e rregulluar e propozuar nga i licencuari për aktivitetin e shpërndarjes do të përfshijë pagesa të aplikueshme mbi konsumatorët për të gjithë aktivitetet e licencuara ku është angazhuar kompania vertikalisht e integruar, me kusht, që pagesa për çdo aktivitet të licencuar dhe pagesa totale të vendosen të ndara në çdo tarifë të rregulluar të aprovuar nga ERE brenda gjashtë muajve pas afatit të parashikuar në nenin 33 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjise elektrike".

2.3 I licencuari do të përdorë dhe do të mirëmbajë sistemin e transmetimit në përputhje me kodin e transmetimit dhe vendimet e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, rregulloreve dhe rregullave të ERE-s dhe kushteve të kësaj licence, për të siguruar funksionimin dhe koordinimin eficient dhe kontrollin e Sistemit Elektroenergjetik të Republikës së Shqipërisë.

2.4 I licencuari, pa diskriminim do të sigurojë lidhjen me Sistemin e transmetimit për të gjithë konsumatorët e kualifikuar dhe të gjithë personat që mbajnë licencë për ushtrimin e aktivitetit në sektorin e energjisë elektrike, duke garantuar transmetimin e energjisë elektrike që ata kanë kontraktuar ndërmjet tyre.

2.5 I licencuari nuk do të pengojë, parandalojë ose të tentojë të parandalojë të licencuarit e tjerë ose pjesëmarrësit potenciale ose konkurrentët që të angazhohen ose të hyjnë:

a) në biznesin e aktiviteteve në sektorin e energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë; ose

b) në biznesin e importimit ose eksportimit të energjisë elektrike në ose nga Republika e Shqipërisë, me përjashtim kur i licencuari udhëzohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi.

2.6 I licencuari nuk do të angazhohet në ndërsuvencionime. Nëse i licencuari është një kompani vertikalisht e integruar elektroenergjetike, do t'i ndajë llogaritë e tij financiare sipas aktiviteteve të gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes brenda afatit të kërkuar nga legjislacioni në fuqi në mënyrë të mjaftueshme për të mundësuar që ERE të konkludojë se nuk ka ndër-suvencionime, aktivitete antikonkurrence ose diskriminim.

2.7 I licencuari nuk do të angazhohet në asnjë formë aktiviteti monopol ose antikonkurrence të ndaluar nga legjislacioni në fuqi ose rregulloret dhe rregullat e miratuara nga ERE.

2.8 Brenda datës 15 shkurt të çdo viti, i licencuari do t'i dërgojë ERE-s një deklaratë me shkrim, në formën e specifikuar nga ERE, që të vërtetojë se i licencuari ka zbatuar dispozitat e paragrafëve 3.4, 3.5 dhe 3.6 gjatë periudhës së kaluar dymbëdhjetë mujore.

2.9 Gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, i licencuari është i detyruar të sigurojë jetën dhe shëndetin e njerëzve, si dhe pasurinë e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi ose rregullore dhe rregulla të tjera të miratuara nga ERE.

2.10 I licencuari nuk do të bashkëpunojë me persona të tjerë për të dëmtuar të licencuarit ose konsumatorët e përfshirë në sistemin elektroenergjetik. I licencuari mund të bashkëpunojë me persona të tjerë për çështje që lidhen me rritjen e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe modernizimit të sistemit elektroenergjetik.

2.11 I licencuari do ta kryejë aktivitetin e licencuar në përputhje me parimet e efikasitetit ekonomik dhe objektivin e arritjes së kostos me të ulët pa rrezikuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit të transmetimit.

2.12 I licencuari do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të përmirësuar efikasitetin operativ dhe ekonomik të aktivitetit të licencuar dhe do të sigurojë nivelet e kërkuara të cilësisë dhe qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike sipas rregulloreve dhe rregullave të miratuara nga ERE.

2.13 I licencuari do të hartojë dhe do të nxisë politika dhe programe që synojnë të respektojnë standardet e cilësisë dhe qëndrueshmërisë të vendosura për sistemin e transmetimit, sipas rregulloreve dhe rregullave të ERE-s.

2.14 I licencuari nuk do të angazhohet në aktivitete të tjera që pengojnë ose mund të pengojnë kryerjen e aktivitetit të licencuar. I licencuari duhet të informojë ERE-n në rastet kur synon:

a) të angazhohet në aktivitete tjetër përveç aktivitetit të licencuar;

b) të ngrejë një biznes shoqërues.

2.15 I licencuari do të informojë ERE-n për ngritjen e çdo biznesi shoqërues. ERE mund ta ndalojë ose të vendosë kushte të veçanta për ngritjen e bizneseve shoqëruese të nevojshëm për të mbrojtur interesat e konsumatorëve.

2.16 I licencuari është i autorizuar të vendosë pagesa për sigurimin e shërbimeve ndihmëse. Tarifat e shërbimeve ndihmëse llogariten sipas metodologjisë së llogaritjes së kostove të shërbimeve ndihmëse dhe në përputhje me tarifën e shërbimeve ndihmëse të regjistruara dhe të aprovuara nga ERE.

2.17 I licencuari nuk është përgjegjës për mospërmblidhjen e kushteve të licencës në rast të një force madhore deri në atë shkallë sa forca madhore është shkaku për këtë mospërmblidhje të kushteve të licencës. Në këtë rast, i licencuari duhet të njoftojë menjëherë ERE-n dhe të licencuarit e tjerë ose konsumatorët me të cilët i licencuari ka lidhur kontrata për transmetimin e energjisë elektrike.

### 3. DETYRIMET E TË LICENCUARIT

3.1 I licencuari është i detyruar të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe gjithë vendimet e Qeverisë dhe rregulloret e rregullat e miratuara nga ERE.

#### 3.2 Llogaritë dhe raportimi

3.2.1 I licencuari do të mbajë regjistra llogarie dhe do të përgatisë bilance financiare, të cilat do të mbahen të ndara për aktivitetin e licencuar dhe çdo aktivitet tjetër (përfshirë aktivitete të tjera të licencuara) ku është angazhuar i licencuari, në përputhje me rregullat e kontabilitetit dhe procedurat e miratuara nga ERE dhe në përputhje me ligjin nr.7961, datë 19.1.1993 “Për kontabilitetin”, nenin 33 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”. I licencuari do t’i dorëzojë ERE-s bilance financiare vjetore deri në datën 30 prill të çdo viti.

3.2.2 Nëse i licencuari parashikon një situatë emergjence siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi, i licencuari do të njoftojë pa vonesë ERE-n dhe ky njoftim do të përshkruajë çfarë masash do të marrë i licencuari për të parandaluar ose përmirësuar ndikimet e situatës emergjente të parashikuar.

3.2.3 I licencuari do të ndajë shpenzimet e përbashkëta mes aktivitetit të tij të licencuar dhe tipeve të tjera të aktiviteteve (përfshirë aktivitetet e autorizuar nga një i licencuar tjetër) në bazë të arsyeshme në përputhje me rregulloret dhe rregullat e ERE-s dhe praktikën e biznesit përgjithësisht të pranuar. I licencuari do t’i paraqesë ERE-s, me kërkesën e tij, në formën dhe në afatin e vendosur nga ERE, dokumentacionin që vendos bazat për ndarjen e shpenzimeve të përbashkëta mes aktiviteteve që do të ushtrohen, si dhe rezultatet e arritura pas kësaj ndarjeje.

3.2.4 I licencuari do të njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të:

- a) adresës;
- b) statutit të të licencuarit;
- c) certifikatës së regjistrimit;
- d) kodit fiskal;
- e) menaxherët kryesorë;
- f) strukturës së aseteve me mbi 10%.

Nëse i licencuari nuk e bën këtë njoftim, ERE mund të aplikojë gjoba, sipas nenit 64 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” .

3.2.5 Gjithë njoftimet zyrtare, aplikimet, peticionet, pretendimet ose korrespondenca tjetër me ERE-n lidhur me licencën duhet të jenë me shkrim dhe të nënshkruara respektivisht nga një zyrtar i autorizuar ose përfaqësues i caktuar i të licencuarit ose ERE-s dhe të dërgohet me korrier ose poste të regjistruar, duke kërkuar një verifikim të fletës së marrjes. Adresat e palëve duhet të vendosen mbi zarf. Gjithë njoftimet ose korrespondenca tjetër do të konsiderohen se hyjnë në fuqi nga momenti i dorëzimit ose, nëse nuk janë dorëzuar për shkak të gabimit të dërguesit, nga momenti i prezantimit.

#### 3.3 Përdorimi i informacionit

3.3.1 I licencuari do të sigurojë që çdo informacion i marrë si rezultat i aktivitetit të tij të licencuar nuk do t’i jepet askujt, me përjashtim të rasteve kur:

- a) jepet pëlqim paraprak me shkrim i personit me të cilin lidhet informacioni;
- b) informacioni është bërë publik;
- c) kur të licencuarit i kërkohet ose lejohet të përhapë informacionin për të përmbushur kushtet e kësaj licence sipas një urdhri të ERE-s ose çdo dispozite ligjore të aplikueshme;
- d) informacioni duhet përhapur në rrjedhën normale të kryerjes së aktivitetit të licencuar.

3.3.2 I licencuari do të sigurojë që çdo biznes shoqëruar nuk do të përdorë asnjë informacion të të licencuarit për të fituar një avantazh konkurrues të pajustificuar dhe do të sigurojë që nuk do të përhapë asnjë informacion tek ndonjë person tjetër (përfshirë biznese të tjera shoqëruar) që mund ta mundësojnë këtë person të fitojë çdo lloj përfitimi komercial të pajustificuar.

3.3.3 I licencuari do të hartojë dhe do t’i paraqesë ERE-s procedurat për të siguruar zbatimin e paragrafëve 3.3.1 dhe 3.3.2. I licencuari do të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për ta ruajtur informacionin konfidencial në posedim të të licencuarit dhe për t’i raportuar ERE-s në përputhje me obligimet e paraqitura në paragrafët 3.3.1 dhe 3.3.2.

3.3.4 Informacioni i dërguar ERE-s nga i licencuari do të konsiderohet publik me përjashtim të rasteve kur me kërkesë specifike të të licencuarit, ERE me vendim përcakton që ky informacion është i natyrës pronësore dhe përhapja e tij nuk i shërben interesit publik.

3.4 Kontrolli i centralizuar dhe koordinimi i rrjetit të transmetimit të energjise elektrike.

3.4.1 I licencuari do të drejtojë dhe do të koordinojë operimin e sistemit të transmetimit në përputhje me kodin e transmetimit dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s.

3.4.2 Për të siguruar një aktivitet dispeçerues të koordinuar dhe një operim sa me efektiv dhe të qëndrueshëm të sistemit të transmetimit, i licencuari do t'i instalojë, përdorë dhe mirëmbajë pajisjet e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e sistemit elektroenergjetik nga gabimet operuese, humbjet e befasishme të ngarkesës ose kapacitetit gjenerues ose çdo ngjarje tjetër të mundshme me ndikim të dëmshëm në punën normale të tij.

3.4.3 I licencuari do të sigurojë shërbime ndihmëse në përputhje me kodin e transmetimit dhe me rregulloret dhe rregullat e ERE-s.

3.5 Regjistrimi dhe sistemi i raportimit

3.5.1 I licencuari do të regjistrojë çdo orë, gjithë flukset elektrike që hyjnë ose dalin nga sistemi i transmetimit, përfshirë energjinë e transmetuar nëpërmjet përdorimit të rrjetit nga vende të treta. Në vendet ku nuk ka matës ose ku matësit nuk i regjistrojnë këto flukse, i licencuari do të përcaktojë sasinë në orë të këtyre flukseve elektrike sipas procedurave operative efektive dhe do të ndërmarrë pa vonesë masa për të instaluar pajisjet matëse të duhura.

3.5.2 I licencuari do të përgatisë raporte mujore të detajuara mbi hyrjen dhe daljen e flukseve elektrike, operimin e sistemit të transmetimit, bilancin energjetik, flukset e jashtëzakonshme elektrike, shërbimet ndihmëse të siguruara, transmetimin e energjisë elektrike nga dhe për në vendet e treta dhe detaje të tjera mbi operimin e sistemit të transmetimit.

3.5.3 Çdo muaj, i licencuari do t'u paraqesë të gjithë përdoruesve të ST, me të cilët ka përfunduar kontrata për sigurimin e shërbimeve të transmetimit të energjise elektrike, si dhe të dhëna mbi energjinë elektrike të transmetuar.

3.5.4 Pagesa për energjinë elektrike të transmetuar nga dhe për në vendin e tretë nga i licencuari, si dhe për shërbimet ndihmëse të siguruara prej tij, është detyrim i përdoruesve të sistemit të transmetimit, konsumatorëve dhe personave që transmetojnë energji elektrike nëpërmjet përdorimit të rrjetit nga vendi i tretë.

3.6 Ndryshimet në sistemin e transmetimit

3.6.1 I licencuari do të njoftojë menjëherë ERE-n për çdo rrethanë që çon në ndryshime të rëndësishme të kapacitetit transmetues të linjave dhe stacioneve transformuese të sistemit të transmetimit, për një periudhë më shumë se tridhjetë (30) ditë dhe do t'i japë ERE-s një opinion për zgjidhjen më të përshtatshme transitore për të reduktuar ndikimin e dëmshëm.

3.6.2 I licencuari do të informojë ERE-n për qëllimet për reduktimin e linjave të tensionit të lartë ose transformatoreve të sistemit të transmetimit, të paktën dymbëdhjetë (12) muaj para reduktimit të planifikuar dhe do t'i sigurojë ERE-s një shpjegim të detajuar të veprimeve të synuara dhe masave që do të merren për të reduktuar ndikimin e mundshëm të dëmshëm.

3.6.3 I licencuari do të informojë menjëherë ERE-n për çdo instalim ose shkëputje të linjave të tensionit të lartë, transformatorëve dhe pajisjeve të tjera.

3.6.4 I licencuari do të njoftojë ERE-n dhe palët e tjera të interesuara mbi çdo mosfunksionim ose rrezik të rastit që ndodh në sistemin e transmetimit, si dhe për kushtet e sistemit gjatë këtyre ngjarjeve. I licencuari do të paraqesë brenda pesë (5) ditëve pas kësaj ngjarjeje, një raport me shkrim që përshkruan shkaqet e ngjarjeve të përmendura, masat e marra, si dhe masat që do të parandalojnë ose kufizojnë përsëritjen në të ardhmen e këtyre ngjarjeve.

3.6.5 I licencuari do të ndërtojë dhe mirëmbajë sistemin e transmetimit duke siguruar kapacitetin e mjaftueshëm të nevojshëm për të përmbushur kërkesat e gjithë përdoruesve të ST, duke e zgjeruar dhe modernizuar atë sipas nevojës. Nëse i licencuari synon të ndërtojë facilitete të reja të sistemit të transmetimit (përfshirë linja të tensionit të lartë, stacione transformimi), do t'ja paraqesë ERE-s sipas procedurave të miratuara dhe do t'i mbështesë këto plane me studime fizibiliteti etj.

3.6.6 Brenda datës 15 shkurt të çdo viti, i licencuari do t'i paraqesë ERE-s një raport mbi kushtet e sistemit të transmetimit, problemet ekzistuese dhe zgjidhjet për t'i kapërcyer, sipas një formati të përcaktuar nga rregulloret dhe rregullat e ERE-s.

3.6.7 Brenda datës 31 mars të çdo viti, i licencuari do t'i paraqesë ERE-s propozime mbi zhvillimet afatshkurtra dhe afatgjata të kostove me të ulta të sistemit të transmetimit sipas një raporti formati të përcaktuar nga rregulloret dhe rregullat e ERE-s.

3.7 Tarifat e shërbimeve transmetuese dhe ato të përdorimit të sistemit të transmetimit nga sistemet transmetuese të rajonit.

3.7.1 Tarifat e shërbimeve transmetuese (tarifat e ShT) dhe tarifat e shërbimeve të përdorimit të sistemit të transmetimit nga sistemet transmetuese të rajonit (tarifat ShTSTR) rregullohen dhe aprovohen nga ERE.

3.7.2 Në bazë të legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve dhe rregullave të ERE-s, i licencuari mund të apelojë në ERE për të ndryshuar tarifën ShT dhe ShTSTR ekzistuese për një shkak të arsyeshëm të provuar.

3.7.3 I licencuari do të autorizohet të vendosë pagesa mbi përdoruesit e ST për kryerjen e shërbimeve të transmetimit, me kusht që këto pagesa të jenë sipas tarifave ST dhe ShTSTR, të aprovuara nga ERE. Sasia e pagesave do të përcaktohet në bazë të tarifave ShT dhe ShTSTR dhe sasisë së energjisë elektrike të regjistruar nga matësit e instaluar në:

- a) kufirin e sistemit të transmetimit dhe rrjetit të shpërndarjes;
- b) kufirin e sistemit të transmetimit dhe të konsumatorëve që marrin energji elektrike nëpërmjet lidhjes direkte me sistemin e transmetimit; dhe
- c) ndërlidhjen me sisteme të tjera transmetimi.

3.7.4 Tarifat ShT dhe ShTSTR të aprovuara nga ERE do të vendosen për të siguruar të licencuarin me:

- a) të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar nivelet e arsyeshme të kostove përfshirë kostot kapitale;
- b) stimuj për të reduktuar kostot dhe për të operuar në mënyrë më efikente.

3.7.5 ERE mund të korrigjojë tarifën ShT dhe ShTSTR herë pas here në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s.

3.7.6. I licencuari mund t'i propozojë ERE-s amendamente në metodologjinë e llogaritjes së tarifave ShT dhe ShTSTR për të përmirësuar përputhjen e tyre me kostot reale për sigurimin e shërbimeve të transmetimit nga ana e tij.

3.8 Akses dhe lidhja me sistemin e transmetimit

3.8.1 I licencuari është i detyruar t'u sigurojë akses të drejtë, të arsyeshëm dhe jo-diskriminues përdoruesve të ST:

- a) për të transmetuar energji elektrike brenda sistemit të transmetimit;
- b) për të transmetuar energji elektrike nga dhe për në sistemet e transmetimit të rajonit;
- c) për t'u lidhur me sistemin e transmetimit;
- d) për të ndërtuar ose përmirësuar facilitetet;
- e) për të përdorur mjetet e teknologjisë së re.

3.8.2 Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga marrja e kërkesës për akses nga një aplikant, i licencuari do t'i sigurojë aplikantit informacion mbi lidhjen me facilitetet e sistemit të transmetimit ose do t'i sigurojë shërbime të tjera, përfshirë informacion të detajuar mbi kushtet teknike të duhura, autorizimet shtesë, kërkesat për matjen, përpunimin e informacionit, pagesën, termat e marrëveshjes dhe kushtet.

3.8.3 I licencuari nuk do të hyjë në marrëveshje të cilat i licencuari i di ose duhet t'i dijë që çojnë në shkelje të kushteve të licencës.

3.8.4 I licencuari mund të pezullojë shërbimet e transmetimit sipas kushteve të licencës për çdo periudhë kohe, kur veprimet ose mosveprimet e disa të licencuarve ose konsumatorëve ose enteve të tjera rrezikojnë qëndrueshmërinë, sigurinë dhe cilësinë e shërbimit të transmetimit ose shërbimeve të siguruara të licencuarve të tjerë dhe/ose konsumatorëve, ose mund të parandalojnë ose të pengojnë përmbushjen e kushteve të licencës nga i licencuari.



### 3.9 Detyrime të tjera

3.9.1 I licencuari do të planifikojë, brenda tre muajve pas lëshimit të licencës dhe do t'i propozojë ERE-s për aprovim metodologjinë e llogaritjes së kostove për shërbimet ndihmëse. Metodologjia e llogaritjes së Kostove për shërbimet ndihmëse, si dhe amendamentet e saj do të hyjnë në fuqi pas aprovimit nga ERE, por mund të mos përfshijnë kostot e marra në konsideratë për llogaritjen e tarifave ShT dhe ShTSTR. Pagesat për shërbimet ndihmëse do të përcaktohen në mënyrë që i licencuari të mbulojë shpenzimet e arsyeshme për sigurimin e këtyre shërbimeve.

3.9.2 I Licencuari do të respektojë ligjet dhe vendimet e qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe rregulloret e rregullat e ERE-s.

### 3.10 PAGESAT E RREGULLIMIT

3.10.1 I Licencuari do t'i paguajë ERE-s pagesa rregullimi në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme gjatë afatit të kësaj licence siç përcaktohet nga ERE në përputhje me nenin 12 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe rregulloret e aplikueshme të ERE-s.

3.10.2 Nëse i licencuari nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit në përputhje me paragrafin 3.10.1 brenda afatit të përcaktuar nga ERE, i licencuari do të penalizohet në përputhje me nenin 64 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike".

### 4. KONTROLLI MBI KRYERJEN E AKTIVITETIT TË LICENCUAR

4.1 ERE do të monitorojë zbatimin nga i licencuari të kushteve të licencimit, do të shqyrtojë raportet e marra nga i licencuari dhe, në çdo kohë pas njoftimit, është i autorizuar të inspektojë asetet ose regjistrimet e llogarive dhe mund të kërkojë një auditim teknik dhe/ose kontabël të aktiviteteve të të licencuarit.

4.2 Përfaqësuesit e autorizuar të ERE-s kanë të drejtë të hyjnë në ndërtesat e të licencuarit, pajisjet dhe dokumentet për të inspektuar aktivitetin e licencuar në përputhje me rregulloret dhe rregullat e ERE-s. I licencuari do të sigurojë çdo ndihmë të kërkuar, të nevojshme për ERE-n gjatë këtij inspektimi.

4.3 Në bazë të ankesës së vërtetuar të çdo personi të tretë ose në bazë të vetë propozimit të tij, ERE mund të nisë një hetim për zbatimin e kushteve të licencës ose rregulloreve dhe rregullave të ERE-s, përfshirë shqyrtimin e praktikave të biznesit nga të licencuarit lidhur me aktivitetin e licencuar.

4.4 Nëse pas hetimit ERE konkludon se i licencuari nuk ka zbatuar kushtet e licencës, ERE mund t'i korrigjojë tarifat e të licencuarit dhe/ose të ndërmarrë masa të tjera me qëllim që të mbrojë interesat e konsumatorëve të energjisë elektrike, deri në heqjen e kësaj licence.

4.5 I licencuari do të informojë ERE-n për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës brenda një jave që kjo shkelje i bëhet e njohur të licencuarit.

4.6 I licencuari do të zbatojë të gjitha vendimet e nxjerra nga ERE, përfshirë pagesën e plotë të gjobave të vendosura nga ERE, në përputhje me rregulloret dhe rregullat e ERE-s, për shkeljen e kushteve të licencës.

### 5. AMENDAMENTI I LICENCËS

5.1 ERE mund të amendojë kushtet e licencës në rast se ato nuk përputhen me:

a) Legjislacionin në fuqi dhe vendimet e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë që janë në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) Vendimet e nxjerra nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ose një gjykatë tjetër shqiptare me kompetencë juridiksionale.

5.2 Brenda një viti duke filluar nga data e hyrjes në fuqi e kësaj licence, ERE mund t'i amendojë këto kushte licence, pas sigurimit të mundësisë që të gjithë palët e interesuara, përfshirë të licencuarin, të shprehin opinionet në përputhje me rregulloret dhe rregullat e ERE-s. ERE do të marrë në konsideratë me kujdes gjithë argumentet e paraqitura para se të bëjë amendamente të këtyre kushteve të licencës. Njoftimet me shkrim të amendamenteve të propozuara do t'i dorëzohen të licencuarit 30 ditë para se këto amendamente të hyjnë në fuqi.

5.3 Në çdo kohë i licencuari ose ERE mund të propozojnë amendamente të tjera për këto kushte licence, përveç atyre të përcaktuara në paragrafët 5.1 dhe 5.2, duke i transmetuar palës tjetër një propozimi me shkrim, së bashku me dokumentet mbështetëse.

5.4 ERE do të marrë vendimin përfundimtar vetëm pasi të marrë në konsideratë interesat e konsumatorëve dhe të licencuarve të tjerë. Palët e interesuara do të informohen me shkrim për çdo amendament të propozuar. Nëse ERE dhe i licencuari arrijnë një marrëveshje për këto amendamente, kushtet e licencës do të amendohen. Nëse marrëveshja nuk arrihet, i licencuari mund të apelojë në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

5.5 Amendamentet e bëra në kushtet e licencës do të publikohen në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë tridhjetë (30) ditë para se të hyjnë në fuqi.

#### **6. PEZULLIMI DHE PËRFUNDIMI I LICENCËS**

6.1 ERE mund ta pezullojë ose përfundojë licencën në përputhje me ligjin mbi sektorin e energjisë elektrike dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s kur:

- a) i licencuari kërkon revokimin e licencës;
- b) i licencuari shkel kushtet e licencës;
- c) i licencuari shkel legjislacionin në fuqi;
- d) i licencuari deklarohet i falimentuar dhe është i paaftë të përmbushë detyrimet e kushteve të licencës;
- e) i licencuari ka marrë licencë duke mashtruar.

6.2 Nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose aksionari që kontrollon interesat ndryshohet pa autorizimin e ERE-s, licenca bëhet nul (e pavlefshme) ose anulohet dhe pasuesi i të licencuari do të aplikojë për një licencë të re, në përputhje me procedurat e ERE-s për dhënie licence.

#### **7. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE E DREJTA PËR APELIM**

7.1 Çdo çështje e diskutueshme ose kërkesë mes të licencuarit dhe çdo përdoruesi të ST lidhur me aktivitetin dispeçerues ose kushtet e licencës do të zgjidhet sa më shumë që të jetë e mundur me mirëkuptim, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s.

7.2 Nëse zgjidhja nuk arrihet me mirëkuptim, atëherë ERE në bazë të peticionit të çdo personi që është palë në këtë mosmarrëveshje do ta zgjidhë mosmarrëveshjen dhe do të nxjerrë vendimin e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret dhe rregullat e saj.

7.3 I licencuari mund të apelojë kundër vendimeve të ERE-s në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

7.4 I licencuari duhet t'u bindet vendimeve të përkohshme të ERE-s në pritje të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ose të ndonjë gjykate tjetër të Republikës së Shqipërisë me kompetencë juridiksionale.

### **VENDIM**

**Nr.36, datë 9.7.2004**

### **PËR MIRATIMIN E LICENCËS PËR SHPËRNDARJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", neni 13 pika 1 germa c dhe neni 15, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.7.2004, pasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Departamenti i Licencave dhe Monitorimit dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun:

#### **VENDOSI:**

1. Miratimin e licencës për shpërndarjen e energjisë elektrike (Licenca bashkëngjitur vendimit).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**

**Pjetër Dema**

4003

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË ENERGIJISË ELEKTRIKE

**LICENCË PËR SHPËRNDARJEN E ENERGIJISË ELEKTRIKE**

Seria: \_\_\_\_\_ Numri i licencës: \_\_\_\_\_

Data e hyrjes në fuqi: \_\_\_\_\_  
(Vendim i ERE-s, nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_)

Licenca i jepet: \_\_\_\_\_  
(Emri dhe adresa zyrtare)

Kompania \_\_\_\_\_  
(Emërtimi, vendndodhja)

Kodi fiskal: \_\_\_\_\_

Certifikata e regjistrimit: \_\_\_\_\_  
(Seria, numri, vendi i regjistrimit)

Bazuar në autoritetin që i është dhënë sipas pjesës së tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (“ERE”) i jep këtë licencë shpërndarje (“licenca”), për të kryer veprimtarinë e shpërndarjes së energjisë elektrike (ShEE) me tarifa të rregulluara brenda territorit të autorizuar të përshkruar në aneksin A, personit fizik ose juridik të lartpërmendur, i quajtur “I licencuari”, subjekt i kushteve të kësaj licence. Kjo licencë hyn në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë prej \_\_\_\_ vjetësh, në rast se nuk përfundohet ose pezullohet nga ERE në përputhje me kushtet e licencës të përfshira këtu.

[Kryetari]

\_\_\_\_\_

[Vula e ERE]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

**KUSHTET E LICENCËS PËR SHPËRNDARJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Seria: \_\_\_\_\_ Numri i licencës: \_\_\_\_\_

I jepet: \_\_\_\_\_  
(Emri i plotë i të licencuarit)

**1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1.1 ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur sipas pjesës së tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, për të lëshuar dhe deklaruar hyrjen në fuqi të kësaj licence.

1.2 Nëse ndonjë kusht i kësaj licence shfuqizohet, ky kusht do të fshihet nga kushtet e licencës dhe kushtet e mbetura të licencës do të vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi.

1.3 Kjo licencë nuk mund të transferohet, tërësisht ose pjesërisht, tek asnjë person tjetër pa vendim të veçantë me shkrim të ERE-s. Kur aprovon një transferim, ERE mund ta ndryshojë periudhën e licencës ose kushtet e tjera të licencës pasi të parashtrrojë një shkak të arsyeshëm.

1.4 ERE ka të drejtën ekskluzive për të ndryshuar atë në rast se kushtet dhe rrethanat kanë ndryshuar. ERE rezervon në mënyrë specifike të drejtën për ta ndryshuar këtë licencë për përputhjen e saj me dispozitat e çdo kodi rrjeti, kodi shpërndarjeje, kodi matës ose rregullave të Tregut të miratuara nga ana e saj në bazë të legjislacionit në fuqi.

1.5 Vetëm një licencë për shpërndarjen e energjisë elektrike me tarifa të rregulluara do të lëshohet për një rajon të veçantë gjeografikisht të kufizuar, por mund të jepen gjithashtu licenca për furnizimin me energji elektrike nga furnizues të kualifikuar konkurrues për klientët e kualifikuar të vendosur brenda këtij rajoni.

1.6 Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në licencë, kushtet e licencës dhe anekset, kur përdoren, do të kenë kuptimet e mëposhtme:

|                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|--------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Shërbimet ndihmëse:                                                                        | Shërbimet e nevojshme për të ruajtur standarde të përcaktuara sigurie, qëndrueshmërie dhe cilësie të energjisë elektrike. Shërbimet ndihmëse përfshijnë: kompensimin e energjisë reaktive, kontrollin fuqi-frekuencë, nivelet e tensionit, gadishmërinë dhe lëshimin e kapaciteteve rezervë dhe shërbime të tjera të këtij lloji. |
| Biznesi shoqërues:                                                                         | Çdo biznes tjetër që direkt ose indirekt, tërësisht ose pjesërisht:<br>1. është pronë e të licencuarit;<br>2. ka të licencuarin pronë;<br>3. është në pronësi të një personi, i cili është pronë e të licencuarit.                                                                                                                |
| Territori i autorizuar:                                                                    | Rajon gjeografikisht i kufizuar, i specifikuar në aneksin A të licencës, brenda të cilit i licencuari është i autorizuar të kryejë aktivitetin e licencuar.                                                                                                                                                                       |
| Tarifa e përdorimit të rrjetit shpërndarës nga furnizuesit e kualifikuar FKK (Tarifat FKK) | Pagesa që i licencuari mund të vendosë për përdorimin e faciliteteve të rrjetit të tij shpërndarës nga furnizuesit konkurrues të kualifikuar për shpërndarje të energjisë tek konsumatorët e kualifikuar që aprovohet nga ERE herë pas here.                                                                                      |

|                                                   |                                                                                                                                                                                                                                      |
|---------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Ndërsubvencionimet:                               | Transferim fondesh ose ndarje kostosh brenda llogarive të të licencuarit ose mes bizneseve shoqëruese për mbështetje financiare të një aktiviteti ose biznesi me koston e një tjetri.                                                |
| Shpërndarja:                                      | Transporti i energjisë elektrike në rrjete shpërndarjeje të tensionit të mesëm dhe të ulët (110 kV, 35 kV, 20 kV, 10 kV, 6 kV dhe 0.4 kV) për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve.                                      |
| Rrjeti shpërndarës:<br>(RrSh)                     | Linja elektrike, të tensionit të mesëm dhe të ulët (110 kV, 35 kV, 20 kV, 10 kV 6 kV dhe 0.4 kV), transformatorë dhe pajisje kyçëse e shkyçëse që përdoren për të siguruar furnizim me energji elektrike për konsumatorët.           |
| Energjia elektrike:                               | Energjia elektrike dhe kapaciteti elektrik përveç kur konteksti e kërkon ndryshe.                                                                                                                                                    |
| Konsumatori i kualifikuar                         | Një konsumator që ka të drejtën sipas legjislacionit në fuqi ose rregulloreve të aplikueshme të ERE-s të zgjedhë furnizuesin e energjisë elektrike për energjinë elektrike të përdorur për nevojat e tij.                            |
| ERE                                               | “ERE” do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike ose institucioni pasues rregullator.                                                                                                                            |
| Legjislacioni në fuqi                             | Ligjet e Republikës së Shqipërisë të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë dhe aktualisht në fuqi.                                                                                                                                      |
| Licencë për shpërndarjen e energjisë elektrike    | Një licencë e dhënë nga ERE për të kryer veprimtarinë e shpërndarjes së energjisë elektrike në një zonë të caktuar.                                                                                                                  |
| Aktiviteti i licencuar                            | Aktivitete të nevojshme dhe direkt të lidhura me operimin e një rrjeti shpërndarës, me qëllim furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve brenda territorit të autorizuar me tarifa të rregulluara.                             |
| I licencuari                                      | Personi që mban këtë licencë për shpërndarjen e energjisë elektrike, përmendur në faqen e parë të kësaj licence.                                                                                                                     |
| Personi                                           | “Personi” do të thotë çdo person fizik ose juridik.                                                                                                                                                                                  |
| Faktori i humbjeve të energjisë                   | Humbjet e vlerësuara të energjisë elektrike në rrjetin elektrik me tension specifik, të shprehura në përqindje të sasisë totale të energjisë elektrike të shpërndarë në rrjetin respektiv brenda periudhës përkatëse të llogaritjes. |
| Furnizuesi konkurrues i kualifikuar (FKK)         | Një person që ka të drejtën të furnizojë me energji elektrike konsumatorët e kualifikuar, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi dhe rregulloret e aplikueshme të ERE-s.                                                          |
| Tarifa e rregulluar                               | Një tarifë aktualisht në fuqi e aprovuar nga ERE, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve dhe rregullave të ERE-s.                                                                                                        |
| Rregulloret dhe rregullat                         | Standardet, kodet, rregulloret, urdhrat dhe rekomandime të tjera në fuqi të miratuara nga ERE.                                                                                                                                       |
| Metodologjia e llogaritjes së kostos së shërbimit | Procedurat për llogaritjen e tarifave FKK të vendosura nga i licencuari për lidhjen me facilitetet e tij të Republikën e Shqipërisë.                                                                                                 |
| Prodhuesi i vogël i energjisë                     | Prodhuesi i energjisë elektrike nga një central me kapacitet deri në 5 MW.                                                                                                                                                           |

|                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|--------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Transferimi                                | Transferim do të thotë çdo shitje, qira ose disponim tjetër, i plotë ose i pjesshëm, i së drejtës për t'u angazhuar në aktivitetet të licencuar.                                                                                                                                                                                                  |
| Operatori i sistemit të transmetimit (OST) | Personi i licencuar përgjegjës për aktivitetet e transmetimit dhe dispeçerimit dhe për procesin e kontrollit të operimit të centraleve prodhues elektrike dhe faciliteteve të tjera të industrisë së energjisë elektrike dhe burimet për të siguruar stabilitetin, sigurinë, qëndrueshmërinë dhe operimin eficient të sistemit elektroenergjetik. |

## 2. KRYERJA E AKTIVITETIT TË LICENCUAR

2.1 I licencuari autorizohet nga kjo licencë për të ushtruar aktivitetin e licencuar vetëm brenda kufijve të territorit të autorizuar. Kjo e drejtë i jepet ekskluzivisht të licencuarit, përveç kërkesave të paragrafit 2.2.

2.2 I licencuari nuk do të vendosë pagesa për konsumatorët, përveç kur kjo është përcaktuar nga tarifat e rregulluara. Lidhur me një kompani vertikalisht të integruar që mban licencë për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe licenca për t'u angazhuar në aktivitetet e transmetimit dhe prodhimit, tarifa e rregulluar mund të përfshijë pagesa të konsumatorëve për të gjitha aktivitetet e licencuara ku është angazhuar kompania vertikalisht e integruar, me kusht që pagesa për çdo aktivitet të licencuar dhe pagesa totale të vendosen të ndara në çdo tarifë të rregulluar të aprovuar nga ERE brenda gjashtë muajve pas afatit të dhënë në nenin 33 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" për ndarjen e llogarive financiare.

2.3 Nëse një konsumator ndodhet në ose pranë territorit të autorizuar të më shumë se një të licencuari, që mban licencë për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe dëshiron të lidhet me rrjetin shpërndarës ose ka nevojë për një rrjet tjetër shpërndarës, ERE mund të kërkojë një analizë të kostove për zgjerimin e shërbimeve RRSht nga çdo i licencuar. Aty ku një zgjerim i tillë i faciliteteve të shërbimit mund të sigurohet nga një i licencuar me kosto mjaft të ulët krahasuar me tjetrin, ERE mund të autorizojë ose kërkojë që ky shërbim të sigurohet nga i licencuari që mund t'i sigurojë këto shërbime me koston më të ulët, pavarësisht nga kërkesat që përmbajnë paragrafët 1.5 dhe 2.1.

2.4 I licencuari nuk do të bashkëpunojë në asnjë mënyrë me të licencuar të tjerë për përgatitjen dhe negocimin e çështjeve të ERE-s që lidhen ose ndikojnë në tarifat e energjisë elektrike ose për pagesa të tjera të aplikuara mbi konsumatorët, me përjashtim nga sa mund të lejohet shprehimisht nga legjislacioni në fuqi ose rregulloret dhe rregullat, dhe nuk do të bashkëpunojë në ndonjë mënyrë tjetër lidhur me aktivitetin e licencuar për të dëmtuar furnizuesit ose konsumatorët ekzistues ose potencialë.

2.5 I licencuari nuk do të angazhohet në ndërsuvencionime. Nëse i licencuari është një kompani vertikalisht e integruar, do t'i ndajë llogaritë e tij financiare sipas aktiviteteve të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes brenda afatit të kërkuar nga legjislacioni në fuqi në mënyrë të mjaftueshme për të mundësuar që ERE të konkludojë se nuk ka ndërsuvencionime, aktivitete antikonkurrencë ose diskriminim.

2.6 I licencuari nuk do të angazhohet në asnjë formë aktiviteti monopol ose antikonkurrencë të ndaluar nga legjislacioni në fuqi dhe rregullat e miratuara nga ERE.

2.7 I licencuari do ta kryejë aktivitetin e licencuar në përputhje me parimet e efikasitetit ekonomik dhe objektivin e arritjes së koston më të ulët.

2.8 I licencuari nuk do të angazhohet në aktivitete të tjera, që pengojnë ose mund të pengojnë kryerjen e duhur të aktivitetit të licencuar. I licencuari do të informojë ERE-n para se të ndërmarrë ndonjë aktivitet, përveç aktivitetit të licencuar. ERE mund ta ndalojë të licencuarin të kryejë çdo aktivitet përveç aktivitetit të licencuar ose mund të vendosë kushte për kryerjen e këtij aktiviteti, të nevojshme për të mbrojtur konsumatorët.

2.9 I licencuari do të informojë ERE-n për ngritjen e çdo biznesi shoqëruar. ERE mund të ndalojë ose imponojë kushte për ngritjen e biznesit shoqëruar, të nevojshme për të mbrojtur konsumatorët e Republikës së Shqipërisë.

2.10 I licencuari nuk do të pengojë, parandalojë ose të përpiqet të parandalojë të licencuarit e tjerë ose konkurrentët potencialë që të angazhohen ose të hyjnë në mënyrë të ligjshme në biznesin e sektorit të energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë.

### 3. DETYRIMET E TË LICENCUARIT

3.1 I licencuari do të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe të gjitha vendimet e Qeverisë dhe rregulloret e rregullat e ERE-s në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### 3.2 Llogaritë dhe raportimi

3.2.1 I licencuari do të mbajë regjistra llogarie dhe do të përgatisë deklarata financiare, të cilat do të mbahen të ndara për aktivitetin e licencuar dhe çdo aktivitet tjetër (përfshirë aktivitete të tjera të licencuara) ku është angazhuar i licencuari, në përputhje me rregullat dhe procedurat e kontabilitetit të aprovuara nga ERE dhe në përputhje me ligjin nr.7961, datë 19.1.1993 “Për kontabilitetin”, nenin 33 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. I licencuari do t’i dorëzojë ERE-s deklarata financiare vjetore në datën 30 qershor të çdo viti.

3.2.2 Të licencuarit i kërkohet të përgatisë dhe t’i dorëzojë në ERE, në 31 mars të çdo viti, një raport vjetor lidhur me veprimtarinë e tij në vitin kalendarik të mëparshëm që të përmbajë sa më poshtë:

- a) një përmbledhje dhe analizë të aktivitetit shpërndarës të të licencuarit;
- b) shitjet e energjisë elektrike dhe të dhënat për mbledhjen e faturave gjatë vitit;
- c) cilësinë e shërbimit shpërndarës dhe detajet e çdo mase të marrë për përmirësimin e shërbimit shpërndarës në zonë;
- d) çdo defekt të ndodhur gjatë vitit;
- e) çdo ndërprerje të programuar të energjisë elektrike që ka zgjatur më shumë se normalja sipas rregullave ose rregulloreve.

3.2.3 I licencuari do t’i dorëzojë ERE-s, me kërkesën e tij, në formën dhe brenda afatit të vendosur nga ERE, çdo informacion, të nevojshëm për ERE-n, për drejtimin e përgjegjësisë të tij rregullatore të autorizuara.

3.2.4 I licencuari do të ndajë shpenzimet e përbashkëta mes aktivitetit të tij të licencuar dhe aktiviteteve të tjera (përfshirë dhe ato të licencuara) në baza të arsyeshme në përputhje me paragrafin 3.2.1 të kësaj licence dhe praktikat e biznesit përgjithësisht të pranuara. I licencuari do t’i paraqesë ERE-s dokumentacionin që paraqet bazat për ndarjen e shpenzimeve të përbashkëta, si dhe rezultatet e arritura.

3.2.5 I licencuari do ta njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të:

- a) adresës;
- b) statutit të të licencuarit;
- c) certifikatës së regjistrimit;
- d) kodit fiskal;
- e) menaxherët kryesorë;
- f) strukturës së aseteve me mbi 10%.

3.2.6 Nëse i licencuari parashikon një situatë emergjence siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi, i licencuari do të njoftojë pa vonesë ERE-n dhe ky njoftim do të përshkruajë çfare masash do të marrë i licencuari për të parandaluar ose përmirësuar ndikimet e situatës së emergjencës të parashikuar.

3.2.7 Të gjitha njoftimet zyrtare, aplikimet, peticionet dhe deklaratat lidhur me licencën duhet të jenë me shkrim, duke caktuar respektivisht nga një zyrtar të autorizuar ose përfaqësues tjetër të të licencuarit ose ERE-s. Këto do të dërgohen me korrier ose postë të regjistruar, duke kërkuar verifikimin e fletës së marrjes. Adresat e palëve duhet të duken në zarf. Të gjitha njoftimet ose korrespondenca tjetër do të konsiderohen efektive nga momenti i dërgimit ose, nëse nuk janë dërguar për shkak të gabimit të dërguesit, nga momenti i paraqitjes.

### 3.3 PËRDORIMI I INFORMACIONIT

3.3.1 I licencuari do të sigurojë që çdo informacion i marrë nga të tjerë si rezultat i aktivitetit të tij të licencuar nuk do t'i jepet askujt, me përjashtim të rasteve kur:

a) jepet pëlqimi paraprak me shkrim i personit me të cilin lidhet informacioni;

b) informacioni është bërë publik;

c) të licencuarit i kërkohet ose i lejohej ta përhapë informacionin për të përmbushur kushtet e kësaj licence, një urdhër të ERE-s ose çdo dispozitë ligjore të aplikueshme.

3.3.2 I licencuari do të sigurojë që bizneset shoqëruese nuk do të përdorin asnjë informacion që disponon i licencuari për të fituar një avantazh konkurrues të pajustificuar dhe do të sigurojë që nuk do ta përhapin informacionin tek asnjë person tjetër (përfshirë ata të një biznesi tjetër shoqërues) gjë që mund ta mundësojë këtë person të fitojë çdo lloj avantazhi komercial të pajustificuar.

3.3.3 I licencuari do të hartojë dhe do t'i paraqesë ERE-s procedurat për të siguruar zbatimin e paragrafëve 3.2.1 dhe 3.2.2. Me kërkesën e ERE-s, i licencuari do të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për të ruajtur informacionin konfidencial që disponon, si dhe për t'i paraqitur ERE-s raporte lidhur me përmbushjen e detyrimeve të specifikuar në paragrafët 3.2.1 dhe 3.2.2.

3.3.4 Informacioni i dërguar ERE-s nga i licencuari do të konsiderohet publik me përjashtim të rasteve kur me kërkesë specifike të të licencuarit, ERE me vendim përcakton që ky informacion është i natyrës pronësore dhe se interesi publik i shërbyer nga përhapja e informacionit nuk do ta justifikojë ose kompensojë dëmin potencial komercial që i shkaktohet të licencuarit.

3.4 I licencuari do të ndërtojë dhe mirëmbajë rrjetin e tij shpërndarës me një kapacitet të përshtatshëm për të përmbushur kërkesat e gjithë konsumatorëve brenda territorit të autorizuar, përfshirë zgjerimin ose përmirësimin e faciliteteve të tij teknike sipas nevojës, megjithatë me kusht që të licencuarit të mos i kërkohet të sigurojë shërbime shpërndarje në pjesë të territorit të autorizuar në të cilin nuk e siguron këtë shërbim në datën e hyrjes në fuqi të kësaj licence, përveç kur mund të kërkohet nga ndonjë rregullore e aprovuar nga ERE që siguron një ndarje të drejtë të kostos shtesë për sigurimin e këtij shërbimi mes konsumatorëve që e kërkojnë këtë shërbim dhe konsumatorëve ekzistues të të licencuarit.

3.5 I licencuari do të hartojë dhe do të nxisë politika dhe programe për të arritur cilësi të nivelit të lartë dhe qëndrueshmëri të shërbimeve shpërndarëse në përputhje me rregulloret dhe rregullat e ERE-s.

3.6 I licencuari do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të përmirësuar efikasitetin operative dhe ekonomike të aktivitetit të licencuar me qëllim që të sigurojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të kryera në përfitim të konsumatorëve.

3.7 I licencuari do të respektojë rregulloret dhe rregullat e aplikueshme të operatorit të sistemit të transmetimit të aprovuara nga ERE, përfshirë kryerjen e gjithë urdhrave operative, instruksioneve ose udhëzimeve dhe dorëzimin e informacionit teknik dhe të gjithë dokumentacionit tjetër të kërkuar.

3.8 Për të lehtësuar kryerjen e aktiviteteve të licencuara, i licencuari mund të kërkojë të drejtat e linjës, të drejtat e përdorimit dhe shpronësimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

I licencuari, në bazë të legjislacionit në fuqi, ka të drejtën të blejë truall, prona të tjera dhe të kryejë punë ndërtuese për sa kohë këto veprime përputhen me rregulloret dhe rregullat e ERE-s.

#### 3.9 Pagesat e rregullimit

3.9.1 I licencuari do të paguajë pagesa rregullimi në mënyrë të rregullt e të vazhdueshme gjatë afatit të kësaj licence siç përcaktohet nga ERE në përputhje me nenin 12 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe rregulloret e aplikueshme të ERE-s.

3.9.2 Nëse i licencuari nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit sipas paragrafit 3.10.1 brenda afatit të kërkuar nga ERE, i licencuari do të penalizohet në përputhje me nenin 64 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike".

#### 3.10 Tarifat FKK:

3.10.1 Tarifat FKK do të rregullohen dhe do të aprovohen nga ERE. Është e drejtë e të licencuarit të kërkojë ndryshimin e tarifave FKK herë pas here, me qëllim që të reflektojnë koston reale.



3.10.2 Pagesa totale e FKK-së do të përcaktohet në bazë të tarifave FKK dhe sasisë së energjisë elektrike të regjistruar nga matësit e instaluar në kufijtë mes rrjetit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të lidhur me rrjetin e shpërndarjes.

3.10.3 Tarifat e FKK-së, të aprovuara nga ERE do të vendosen për t'i siguruar të licencuarit:

a) të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar nivelet e arsyeshme të kostove dhe përfitimet; dhe b) stimuj për të reduktuar kostot dhe për të operuar në mënyrë efikente.

3.10.4 Gjatë dy viteve të para pas datës së hyrjes në fuqi të çdo tarife fillestare FKK, i licencuari do t'i propozojë ERE-s ndryshimin e tarifave FKK për të përmirësuar lidhjen mes strukturës së çmimeve dhe kostos aktuale të sigurimit të shërbimeve shpërndarëse.

3.10.5 I licencuari do të hartojë metodologjinë e llogaritjes së kostove të shërbimit për hartimin e tarifave FKK për të shlyer kostot e arsyeshme dhe përfitimet e sigurimit të këtyre shërbimeve. Metodologjia e llogaritjes së kostove të shërbimit dhe çdo amendament do të konsiderohen efektive vetëm pas aprovimit nga ERE.

3.11 I licencuari mund të kërkojë siguri të arsyshme pagese nga konsumatorët sipas detyrave ose përgjegjësi të tij gjatë aktivitetit të tij të licencuar në përputhje me çdo rregullore e rregull të miratuar nga ERE.

3.12 I licencuari mund ta shkëpusë një konsumator për mospagesë të faturave të energjisë elektrike në përputhje me çdo rregullore dhe rregull të aplikueshëm të ERE-s. I licencuari do ta rilidhë konsumatorin pas pagesës së faturave të papaguara, në përputhje me çdo rregullore e rregull të miratuar nga ERE.

3.13 Aksesit në rrjetin e shpërndarjes

3.13.1 I licencuari do t'u sigurojë akses në rrjetin shpërndarës për t'u lidhur dhe për të përdorur facilitetet e rrjetit të shpërndarjes, për konsumatorët, prodhuesit e vegjël të licencuar të energjisë dhe furnizuesve kompetitive të kualifikuar të licencuar, në bazë të drejtë, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.

3.13.2 Brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës nga një konsumator, prodhues i vogël i energjisë ose furnizues kompetitiv i kualifikuar, i licencuari do të përgjigjet duke i siguruar aplikantit informacionin lidhur me lidhjen në facilitetet e tij shpërndarëse ose shërbime të tjera, përfshirë informacion të detajuar mbi kushtet teknike, shërbimet dhe lejet shtesë të nevojshme, kërkesat për matjen e energjisë elektrike, përpunimin e informacionit, pagesën, termat dhe kushtet e marrëveshjeve. I licencuari mund të ngarkojë pagesa shtesë për kryerjen e këtij informacioni. ERE mund t'i japë të licencuarit një zgjatje prej 30 ditësh për përgjigje, pas tregimit të shkakut të arsyeshëm nga i licencuari, nëse i licencuari kërkon një zgjatje nga ERE brenda 15 ditëve pas marrjes së kërkesës.

3.13.3 I licencuari do t'i dërgojë aplikantit draftin e marrëveshjes respektive brenda 30 ditëve pas marrjes së aplikimit për lidhje ose përdorimit të faciliteteve të rrjetit të tij shpërndarës.

3.13.4 I licencuari nuk do të lidhë asnjë marrëveshje që mund të rezultojë në shkelje të kushteve të licencës.

3.13.5 I licencuari do t'u kërkojë konsumatorëve, prodhuesve të vegjël të energjisë dhe furnizuesve kompetitivë të kualifikuar të paguajnë pagesën e aplikueshme për lidhjen. I licencuari do t'u japë konsumatorëve opsionin për të shlyer pagesat e aplikueshme të lidhjes nëpërmjet pagesës së menjëhershme të shumës së plotë ose me pagesa mujore në pjesë të barabarta gjatë një periudhe të përcaktuar në marrëveshjen e lidhjes prej jo më pak se gjashtë (6) muaj.

3.13.6 I licencuari nuk do të diskriminojë në mënyrë të paarsyeshme ndonjë person gjatë ushtrimit të aktivitetit të licencuar.

3.13.7 I licencuari mund të pezullojë shërbimet e siguruara prej tij në përputhje me këtë licencë për çdo periudhë kohe gjatë së cilës veprimi ose mosveprimi i një ose më shumë konsumatorëve ose furnizuesve të energjisë elektrike kërcënon sigurinë, qëndrueshmërinë ose cilësinë e operimit të rrjetit shpërndarës ose shërbimet e siguruara konsumatorëve të tjerë ose furnizuesve, ose mund të parandalojë ose pengojë kryerjen e aktivitetit të licencuar nga i licencuari ose gjatë situatave të emergjencës në furnizimin me energji elektrike siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi.

3.14 Mosmarrëveshja mes të licencuarit dhe një konsumatori ose të licencuarit dhe një të licencuari tjetër (përfshirë një furnizues kompetitiv të kualifikuar) që ka të bëjë me një çështje brenda juridiksionit të ERE-s, që nuk mund të zgjidhet nëpërmjet negociatave të palëve, do të zgjidhet nga ERE, pas dëgjimit plotësisht të palëve para ERE-s, brenda qëllimit të autoritetit të ERE-s dhe në përputhje me rregulloret dhe rregullat e ERE-s.

3.15 Një vendim i ERE-s mund të apelohej në Gjykatën e Faktit, Tiranë sipas legjislacionit në fuqi.

3.16 Matja e energjisë elektrike dhe faktori i humbjeve të energjisë:

3.16.1 I licencuari do të sigurojë leximin e matësit të tij komercialë të vendosur në pikat e ndërlydhjes në territorin e autorizuar, për ushtrimin e aktivitetit të tij të specifikuar në aneksin A.

3.16.2 I licencuari do të sigurojë lexues matësish për konsumatorët e vendosur në territorin e aktivitetit të licencuar për të gjithë furnizuesit, përfshirë furnizuesit kompetitivë të kualifikuar, në baza jodiskriminuese dhe konfidenciale dhe do të kompensohet në mënyrë të arsyeshme për kostot përkatëse nga tarifat FKK.

3.16.3 I licencuari:

a) do të mbajë një sistem për vlerësimin e sasisë së energjisë elektrike të konsumuar nga konsumatorët për të cilët leximet aktuale të matësve nuk janë arritur apo nuk janë të rregullt; në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e miratuara nga ERE;

b) do të përcaktojë konsumin për çdo orë të energjisë elektrike për konsumatorët e kualifikuar të furnizuar nga furnizuesit kompetitivë të kualifikuar nëpërmjet matjes, vlerësimit të ngarkesës orare të konsumit ose nëpërmjet çdo metode tjetër të pranueshme; dhe

c) do të marrë aprovimin nga ERE për metodat dhe procedurat e përdorura për të përcaktuar dhe vlerësuar konsumin e energjisë elektrike.

3.16.4 ERE autorizohet të korrigjojë faktorin e humbjeve të energjisë elektrike, të paraqitur në çdo tarifë FKK, të paktën çdo tre vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj licence. Korrigjimi i faktorit të humbjeve të energjisë elektrike mund të kryhet në çdo kohë tjetër, nëse është bërë një marrëveshje mes ERE-s dhe të licencuarit. ERE mund të propozojë ndryshime të faktorit të humbjeve të energjisë elektrike bazuar në korrigjimin e llogaritjeve teknike, planeve të të licencuarit dhe çdo të dhënë tjetër lidhur me aktivitetin e licencuar.

3.16.5 I licencuari, brenda dy vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, do t'i propozojë ERE-s të rregullojë faktorin e humbjeve të energjisë elektrike në përputhje me ndryshimet e tarifave FKK.

3.16.6 I licencuari do të koperojë me operatorin e sistemit të transmetimit për qëllimin e përcaktimit të sasisë së energjisë elektrike të siguruar konsumatorëve brenda territorit të autorizuar të të licencuarit nga furnizuesit kompetitivë të kualifikuar. Me qëllim që operatori i sistemit të transmetimit të përcaktojë sasinë e energjisë elektrike të dhënë nga rrjeti transmetues tek rrjeti i shpërndarjes i të licencuarit për furnizim të konsumatorëve nga çdo i licencuar i veçantë, përfshirë tarifat e rregulluara dhe furnizuesit kompetitivë të kualifikuar të licencuar, i licencuari:

a) do të përcaktojë në bazë orësh sasinë e energjisë elektrike të dhënë nga i licencuari tek çdo konsumator të cilit i është siguruar furnizim me energji elektrike nga një furnizues kompetitiv i kualifikuar i licencuar, duke marrë parasysh treguesit e matësve të këtyre konsumatorëve; dhe

b) do ta raportojë këtë informacion të rregulluar për faktorin e humbjeve të energjisë elektrike të paraqitur në aneksin B, në bazë ditore operatorit të sistemit të transmetimit në përputhje me aplikimin e rregulloreve dhe kodeve.

3.17 I licencuari do të informojë ERE-n të paktën një vit para, për planet për të kryer ndryshime të mëdha në rrjetin e tij të energjisë elektrike, nëse këto ndryshime mund të çojnë në reduktim të kapacitetit të rrjetit ose ulje të qëndrueshmërisë së rrjetit shpërndarës. Me kërkesën e ERE-s, i licencuari do t'i paraqesë ERE-s provat ekonomike dhe teknike të veprimeve të tij të synuara.

#### 4. KONTROLLI MBI KRYERJEN E AKTIVITETIT TË LICENCUAR

4.1 ERE do të monitorojë zbatimin nga i licencuari të kushteve të licencimit, do të shqyrtojë raportet e marra nga i licencuari dhe, në çdo kohë, është i autorizuar të inspektojë regjistrimet e llogarive të të licencuarit dhe mund të kërkojë një auditim teknik dhe/ose kontabël të aktiviteteve të të licencuarit.

4.2 Përfaqësues të autorizuar të ERE-s kanë të drejtë të inspektojnë objektet e të licencuarit, pajisjet dhe dokumentet e tij për të verifikuar kryerjen e aktivitetit të licencuar në përputhje me kushtet e licencës, si dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s. I licencuari do të sigurojë çdo ndihmë të kërkuar, të nevojshme për ERE-n gjatë këtij inspektimi.

4.3 Në bazë të ankesës së vërtetuar të çdo pale të tretë ose në bazë të vetë propozimit të ERE-s, ky i fundit mund të nisë një hetim mbi zbatimin nga i licencuari të kushteve të licencës së tij ose rregulloreve dhe rregullave të ERE-s.

4.4 Nëse pas hetimit, ERE konkludon se i licencuari nuk ka përmbushur kushtet e licencës, ERE mund të korrigjojë tarifat e të licencuarit dhe/ose të ndërmarrë masa të tjera brenda qëllimit të autoritetit të tij me qëllim që të mbrojë interesat e konsumatorëve të energjisë elektrike.

4.5 I licencuari do të informojë ERE-n duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës brenda një jave që kjo shkelje t'i bëhet e njohur të licencuarit.

4.6 I licencuari do t'u bindet vendimeve të marra nga ERE, përfshirë pagesën e gjobave të vendosura nga ERE, në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregulloret dhe rregullat e ERE-s, dhe kushtet e kësaj licence.

#### 5 AMENDAMENTI I LICENCËS

5.1 ERE mund të amendojë kushtet e licencës në rast se ato nuk përputhen me:

a) legjislacionin në fuqi dhe vendimet e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë që janë në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) vendimet e formës së prerë të gjykatave të Republikës së Shqipërisë.

5.2 Në çdo kohë i licencuari ose ERE mund të propozojnë amendamente të tjera për këto kushte licence, përveç atyre të specifikuara në paragrafin 5.1 duke i transmetuar një propozim me shkrim, së bashku me çdo dokument mbështetës, palës tjetër.

5.3 ERE do të marrë vendimin përfundimtar vetëm pasi të marrë në konsideratë interesat e konsumatorëve dhe të licencuarve të tjerë. Palët e interesuara do të informohen me shkrim për çdo amendament të propozuar. Nëse ERE dhe i licencuari arrijnë një marrëveshje për këto amendamente, kushtet e licencës do të amendohen. Nëse marrëveshja nuk arrihet, i licencuari mund të apelojë në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë.

#### 6. PEZULLIMI DHE HEQJA E LICENCËS

6.1 ERE mund ta pezullojë ose përfundojë licencën në përputhje me ligjin e sektorit të energjisë elektrike dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s kur:

a) i licencuari kërkon revokimin e licencës;

b) i licencuari shkel kushtet e licencës;

c) i licencuari shkel legjislacionin në fuqi;

d) i licencuari deklarohet i falimentuar dhe është i paafte të përmbushë detyrimet e kushteve të licencës;

e) i licencuari ka marre licencë duke mashtruar.

6.2 Nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose, nëse aksioneri që kontrollon interesat ndryshohet pa autorizimin e ERE-s, licenca bëhet nul (e pavlefshme) dhe anulohet dhe pasuesi i të licencuarit do të aplikojë për një licencë të re në përputhje me procedurat e ERE-s për dhënie licence.

#### 7. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE E DREJTA PËR APELIM

7.1 Çdo çështje e diskutueshme ose kërkesë mes të licencuarit dhe çdo përdoruesi të sistemit të transmetimit lidhur me aktivitetin dispeçerues ose kushtet e licencës do të zgjidhet sa më shumë që të jetë e mundur me mirëkuptim, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s.

7.2 Nëse zgjidhja nuk arrihet me mirëkuptim, atëherë ERE në bazë të peticionit të çdo personi që është palë në këtë mosmarrëveshje do ta zgjidhë mosmarrëveshjen dhe do të nxjerrë vendimin e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret dhe rregullat e saj.

7.3 I licencuari mund të apelojë kundër vendimeve të ERE-s në gjykatë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare

7.4 I licencuari duhet t'u bindet vendimeve të përkohshme të ERE-s në pritje të apelimit në gjykatë.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË ENERGISË ELEKTRIKE**

**LICENCË PËR SHPËRNDARJEN E ENERGISË ELEKTRIKE**

Licenca i jepet:

(Emri i plotë i të licencuarit)

Seria: \_\_\_\_\_

Numri i licencës: \_\_\_\_\_

Data e hyrjes në fuqi të këtij aneksi: \_\_\_\_\_

**ANEKSI A**  
**TERRITORI I AUTORIZUAR PËR AKTIVITETIN E LICENCUAR**

[Përshkrimi i territorit në të cilin i licencuari është i autorizuar të drejtojë aktivitetin e licencuar dhe harta e detajuar e zonës gjeografike dhe rrjetit shpërndarës]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

**LICENCË PËR SHPËRNDARJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Licenca i jepet:

(Emri i plotë i të licencuarit)

Seria: \_\_\_\_\_

Numri i licencës: \_\_\_\_\_

Data e hyrjes në fuqi të këtij aneksi: \_\_\_\_\_

**ANEKSI B**

Tarifat për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe faktori i humbjeve të energjisë

| Klasa e tensionit | Tarifa për shpërndarjen e energjisë elektrike | Faktori i humbjeve vjetore të energjisë |
|-------------------|-----------------------------------------------|-----------------------------------------|
| 0.4 kV            | lekë për kWh                                  | %                                       |
| 0.6 kV            | lekë për kWh                                  | %                                       |
| 10 kV             | lekë për kWh                                  | %                                       |
| 35 kV             | lekë për kWh                                  | %                                       |
| 110 kV            | lekë për kWh                                  | %                                       |

**VENDIM**

**Nr.37, datë 9.7.2004**

**PËR MIRATIMIN E LICENCËS PËR NDËRTIMIN, INSTALIMIN E CENTRALIT  
ELEKTRIK DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 13 pika 1 germa a dhe neni 15, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.7.2004, pasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Departamenti i Licencave dhe Monitorimit dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e licencës për ndërtimin, instalimin e centralit elektrik dhe prodhimin e energjisë elektrike (Licenca bashkëngjitur vendimit).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Pjetër Dema**

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË ENERGJISE ELEKTRIKE

**LICENCË PËR NDËRTIMIN, INSTALIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E CENTRALIT  
ELEKTRIK DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Seria: \_\_\_\_\_ Numri i licencës: \_\_\_\_\_

Data e hyrjes në fuqi : \_\_\_\_\_  
(Vendim i ERE-s, nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_)

Licenca i jepet : \_\_\_\_\_  
(Emri dhe adresa zyrtare)

Centrali : \_\_\_\_\_  
(Emërtimi, vendndodhja)

Kodi fiskal: \_\_\_\_\_

Certifikata e regjistrimit: \_\_\_\_\_  
[seria, numri, vendi i regjistrimit]

Bazuar në autoritetin që i është dhënë në pjesën e tretë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE) i jep këtë licencë për ndërtimin dhe instalimin e një centrali të ri për prodhimin e energjisë elektrike (Licenca), personit të lartpërmendur, i quajtur “I licencuari”, subjekt i kushteve të kësaj licence. Kjo licencë hyn në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë prej \_\_\_\_ vjetësh, në rast se nuk përfundohet ose pezullohet nga ERE në përputhje me kushtet e licencës të përfshira këtu.

\_\_\_\_\_  
[Kryetari]

[Vula e ERE]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

**KUSHTET E LICENCËS PËR NDËRTIMIN, INSTALIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E  
CENTRALIT ELEKTRIK DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Seria: \_\_\_\_\_

Numri i licencës: \_\_\_\_\_

I jepet: \_\_\_\_\_

(Emri i plotë i të licencuarit)

**1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1.1 ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur nga pjesa e tretë e ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, për të dhënë dhe për të deklaruar efektivitetin e kësaj licence.

1.2 Kjo licencë do të jetë në fuqi për një periudhë prej \_\_\_\_ vite/muaj për aktivitetin e ndërtimit dhe instalimit të një centrali elektrik dhe për një periudhë prej \_\_\_\_ vite/muaj për prodhimin e energjisë elektrike.

1.3 Nëse ndonjë kusht i licencës bëhet i pavlefshëm dhe anulohet, ky kusht do të hiqet nga kushtet e licencës dhe kushtet e mbetura të licencës do të vazhdojnë të jenë në fuqi dhe të kenë efekt të plotë.

1.4 Nuk do të bëhet asnjë transferim, tërësisht ose pjesërisht, i aseteve tek asnjë person, pa vendimin paraprak me shkrim të ERE-s.

1.5 ERE ka të drejtën ekskluzive për ta ndryshuar këte licencë duke përmbushur dispozitat e çdo Kodi Rrjeti, Kodi Shpërndarjeje, Kodi Matës ose Rregulla Tregu të miratuara nga ERE sipas legjislacionit në fuqi.

1.6 Në çdo kohë i licencuari do të mbajë një licencë për ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e centralit elektrik, si dhe prodhimin e energjisë elektrike.

1.7 Heqja e një prej lejeve apo autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente përbën kusht për heqjen e kësaj licence.

1.8 Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në licencë dhe anekse, kur përdoren, do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

“Data e përfundimit” do të thotë data në të cilën i licencuari do të ketë përfunduar ndërtimin e një pjese specifike të centralit dhe, në mënyrë më specifike, do të thotë data e treguar në aneksin A që i korrespondon pjesëve të centralit të renditura në aneksin A dhe do të përfshijë të dhënat e treguara në aneksin B.

“Elektricitet” do të thotë si energji elektrike, ashtu dhe kapacitet elektrik, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe.

“ERE” do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike ose enti rregullator pasues.

“Forcë madhore” do të thotë një akt ose ngjarje që përfshin aktet e natyrës ose politikës ose ngjarje sociale që ndodhin në vend, si tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmbytjet, shpërthimet vullkanike ose zjarret ose një akt lufte, konflikt i armatosur, rebelim, veprime terroriste ose ushtarake, që e pengojnë të licencuarin të kryejë detyrimet e tij sipas kësaj licence ose akte të tjera dhe ngjarje që janë (i) përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk krijohen për faj të të licencuarit; (ii) i licencuari ka qenë i paaftë t’i përballojë këto akte ose ngjarje nëpërmjet ushtrimit të zellit të duhur dhe përpjekjeve të arsyeshme, aftësive dhe kujdesit.

“Legjislacioni në fuqi” do të thotë ligjet e Republikës së Shqipërisë të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë dhe që janë në fuqi gjatë periudhës së kësaj licence.

“Licenca” do të thotë një licencë e dhënë nga ERE që autorizon të licencuarin të ndërtojë, instalojë, shfrytëzojë një central elektrik, si dhe të prodhojë energji elektrike.

“Licencë për furnizimin e energjisë elektrike me tarifa të rregulluara” do të thotë licencë e dhënë nga ERE që autorizon të licencuarin të sigurojë furnizim me energji elektrike për

konsumatorët brenda një zone gjeografike të caktuar me tarifa të rregulluara nga ERE.

“Tarifat e rregulluara” do të thotë një tarifë aktualisht në fuqi, e aprovuar nga ERE sipas legjislacionit në fuqi.

“I licencuar” do të thotë personi që mban këtë licencë për ndërtimin dhe instalimin e një centrali elektrik dhe prodhimin e energjisë elektrike, që përmendet në faqen e parë të kësaj licence.

“Person” do të thotë çdo person fizik ose juridik.

“Biznesi shoqërues” do të thotë çdo biznes tjetër që direkt ose indirekt, tërësisht ose pjesërisht:

1. është pronë e të licencuarit;
2. ka pronësi të licencuarin;
3. është në pronësi të një personi, i cili është pronë e të licencuarit.

“Transferim” do të thotë çdo shitje, dhënie me qira ose ndonjë disponim tjetër, i plotë ose i pjesshëm, i së drejtës për t’u angazhuar në aktivitetin e licencuar.

“Ndërsubvencionimet” do të thotë transferim fondesh ose ndarje kostosh brenda llogarive të të licencuarit ose mes bizneseve shoqëruese për mbështetje financiare të një aktiviteti ose biznesi me koston e një tjetri.

“Prodhim” do të thotë prodhimi i energjisë elektrike nëpërmjet transformimit të burimeve të ndryshme energjetike nga njësitë e prodhimit të të licencuarit.

“Furnizim me energji elektrike” do të thotë dërgimi ose shitja e energjisë elektrike te klienti.

“Central elektrik” do të thotë tërësia e gjithë sistemit të pajisjeve, përfshirë njësitë e prodhimit të dhëna në aneksin A, pajisjet sekondare të përfshira në të, ato që kryejnë furnizimin me lëndë djegëse, pajisjet shndërruese të tensionit të lartë dhe disa objekte jashtë zonës ku është vendosur ai (p.sh. ujësjellës, zona të depozitimit të mbetjeve teknologjike) etj. Asetet, të trupëzuara ose jo të trupëzuara, që zotërohen ose kontrollohen tërësisht ose pjesërisht, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj licence ose që blihen tërësisht ose pjesërisht në çdo kohë gjatë afatit të licencës nga i licencuari dhe përdoren për qëllimin e prodhimit të energjisë elektrike.

“Njësi prodhimi” do të thotë njësi individuale dhe/ose pajisjet kryesore të impiantit për të transformuar një formë të energjisë në energji elektrike, siç shpjegohet në mënyrë më të plotë në aneksin A.

“Sistem elektroenergjetik” do të thotë sistem i ndërlidhur që përbëhet nga centralet elektrike, linjat, nënstacionet dhe pajisjet për transmetimin ose shpërndarjen e energjisë elektrike te konsumatorët brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

“Shërbimet ndihmëse” do të thotë shërbimet e kërkuara për të ruajtur standarde të përcaktuara sigurie, qëndrueshmërie dhe cilësie të energjisë elektrike. Shërbimet ndihmëse përfshijnë: kompensimin reaktiv të energjisë, kontrollin fuqi-frekuencë, nivelet e tensionit, mirëmbajtjen dhe lëshimin e shpejtë të kapaciteteve rezervë dhe shërbime të tjera të këtij lloji.

“Operatori i sistemit të transmetimit (OST)” do të thotë personi i licencuar, përgjegjës për aktivitetet e transmetimit dhe dispeçerimit dhe për procesin e kontrollit të operimit të centraleve prodhuese elektrike dhe faciliteteve të tjera të industrisë së energjisë elektrike për të siguruar stabilitetin, qëndrueshmërinë, sigurinë dhe operimin eficient të sistemit elektroenergjetik.

“Rregulloret dhe rregullat” do të thotë standardet, kodet, rregulloret, urdhrat dhe rekomandime të tjera në fuqi të miratuara nga ERE.

1.9 Anekset e mëposhtme të kësaj licence janë përfshirë në licencë me referencë të veçantë dhe konsiderohen si pjesë përbërëse e saj:

Aneksi A: Përshkrim i centralit të energjisë elektrike përfshirë të gjitha aspektet e tjera të projektit, si hartimi i projektit, kontrata e ndërtimit, studimi i fizibilitetit për lidhjen e centralit me sistemin e energjisë elektrike.

Aneksi B: Afati kohor për ndërtimin dhe instalimin e centralit.

Aneksi C: Impiantet dhe njësitë prodhuese të energjisë elektrike.



## 2. PËR NDËRTIMIN DHE INSTALIMIN E CENTRALIT ELEKTRIK

2.1 I licencuari, gjatë afatit të licencës do të ketë të drejtën ekskluzive dhe detyrimin për të ndërtuar dhe instaluar centralin e përshkruar në aneksin A dhe për të ndërmarrë gjithë veprimet e nevojshme për përfundimin e projektit, në përputhje me afatin për ndërtimin dhe instalimin siç është përcaktuar në aneksin B.

2.2 I licencuari, pa miratimin me shkrim të ERE-s, nuk do të ndërtojë dhe instalojë një central që devijon në ndonjë mënyrë nga parametrat dhe standardet e centralit të përshkruara në aneksin A dhe në planet dhe materialet e tjera të paraqitura ERE-s si pjesë e aplikimit për këtë licencë. Kërkesa për një miratim të tillë do të përbëjë një kërkesë për amendimin e kësaj licence dhe do të bëhet sipas seksionit 6 të kushteve të kësaj licence.

## 3. KRYERJA E AKTIVITETIT TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

3.1 I licencuari autorizohet nga kjo licencë për të ushtruar aktivitetin e licencuar në centralele elektrike që përdorin njësitë prodhuese të specifikuara në aneksin C. I licencuari, në çdo kohë dhe në çdo aspekt të aktivitetit të tij të licencuar, do të prodhojë energji elektrike në përputhje me standardet e paraqitura në rregulloret dhe rregullat e miratuara nga ERE.

3.2 Nëse i licencuari është kompani vertikalisht e integruar që mban gjithashtu licenca për t'u angazhuar në aktivitetet e transmetimit dhe të shpërndarjes, tarifa e rregulluar e propozuar nga i licencuari duhet të përfshijë pagesa për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen. Pagesa për çdo aktivitet të licencuar dhe pagesa totale të vendosen të ndara në çdo tarifë të rregulluar të aprovuar nga ERE gjashtë muaj pas afatit të parashikuar në nenin 33 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike".

3.3 I licencuari do të njoftojë menjëherë ERE-n për çdo ndryshim në kapacitetin e secilit prej njësive prodhuese ose centralele elektrike të identifikuara në aneksin C që rrisin ose ulin kapacitetin prodhues të disponueshëm nga i licencuari në një mënyrë që mund të ndikojë shumë në shërbimin e konsumatorëve për një periudhë më të madhe se 30 ditë.

3.4 Çdo rritje e kapacitetit të disponueshëm, që kalon 10% të sasisë të kapacitetit të identifikuar në aneksin C, me përjashtim të periudhave të përkohshme që zgjasin më pak se dymbëdhjetë muaj, do të kërkojë një amendim të kësaj licence.

3.5 Me qëllim që të nxitet konkurrenca në tregun e energjisë elektrike, ERE mund të kufizojë, herë pas here, kapacitetin total prodhues të autorizuar nga kjo licencë.

3.6 Gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, të licencuarit i kërkohet të sigurojë jetën dhe shëndetin e , dhe pronat e tyre në përputhje me legjislacionin, rregulloret dhe rregullat e tjera në fuqi.

3.7 I licencuari nuk do të pengojë, parandalojë ose tentojë të pengojë të licencuarit e tjerë ose konkurrentët potencialë që të angazhohen ose të hyjnë në mënyrë të ligjshme në biznesin elektrik në Republikën e Shqipërisë;

3.8 I licencuari nuk do të angazhohet në ndërsubvencionime. Nëse i licencuari është plotësisht ose pjesërisht, një kompani vertikalisht e integruar e energjisë elektrike, do të ndajë llogaritë e tij financiare sipas aktiviteteve të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes brenda afatit të kërkuar nga legjislacioni në fuqi në mënyrë të mjaftueshme për të mundësuar që ERE të konkludojë se nuk ka ndërsubvencionime, aktivitete antikonkurruese ose diskriminuese.

3.8.1 I licencuari nuk do të angazhohet në asnjë formë aktiviteti monopol të ndaluar nga legjislacioni në fuqi ose rregulloret dhe rregullat e aprovuara nga ERE.

3.8.2 I licencuari do ta kryejë aktivitetin e licencuar në përputhje me parimet e efikasitetit ekonomik dhe objektivin për arritjen e kostove më të ulëta.

3.8.3 I licencuari nuk duhet të angazhohet në aktivitete të tjera, që pengojnë ose mund të pengojnë kryerjen e duhur të aktivitetit të licencuar. I licencuari do të informojë ERE-n para se të ndërmarrë ndonjë aktivitet, përveç aktivitetit të licencuar. ERE mund ta ndalojë të licencuarin të kryejë çdo aktivitet, përveç aktivitetit të licencuar, kur konstaton se interesat e konsumatorëve mund të dëmtohen.

3.9 I licencuari do të informojë ERE-n për ngritjen e çdo biznesi shoqëruar. ERE mund të imponojë kushte për ngritjen e biznesit shoqëruar, të nevojshme për të mbrojtur konsumatorët e Republikës së Shqipërisë.

3.9.1 I licencuari nuk do të bashkëpunojë në asnjë mënyrë më të licencuar të tjerë për përgatitjen dhe negocimin e çështjeve të ERE-s, që lidhen ose që ndikojnë në tarifat e energjisë elektrike ose në pagesat e tjera të konsumatorëve, ose të bashkëpunojë në ndonjë mënyrë lidhur me aktivitetin e licencuar në dëm të furnizuesve ekzistues ose potencialë ose të konsumatorëve, përveç kur i kërkohet shprehimisht nga rregulloret dhe rregullat e ERE-s.

#### 4. DETYRIMET E TË LICENCUARIT

4.1 I licencuari do të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe të gjitha vendimet e Qeverisë dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s jo në konflikt me legjislacionin në fuqi.

4.2 I licencuari do të mbajë regjistra llogarie dhe do të përgatisë bilance financiare, të cilat do të mbahen të ndara për aktivitetin e licencuar dhe çdo aktivitet tjetër (përfshirë aktivitete të tjera të licencuara) ku është angazhuar i licencuari, në përputhje me rregullat dhe procedurat e kontabilitetit të miratuara nga ERE dhe në përputhje me ligjin nr.7961, datë 19.1.1993 “Për kontabilitetin”, nenin 33 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe (standardet ndërkombëtare të kontabilitetit). I licencuari do t’i dorëzojë ERE-s bilancet financiare vjetore në datën 30 qershor të çdo viti.

4.3 Të licencuarit i kërkohet të përgatisë dhe t’i paraqesë ERE-s deri më 31 mars të çdo viti, një raport vjetor lidhur me operimet e tij gjatë vitit kalendarik të mëparshëm dhe që përmban sa më poshtë:

1. një përmbledhje dhe analizë të aktiviteteve të të licencuarit;
2. prodhimin e energjisë elektrike gjatë vitit;
3. cilësinë e prodhimit dhe detaje të çdo mase të marrë për përmirësimin e cilësisë së prodhimit;
4. çdo defekt të ndodhur gjatë vitit;
5. detaje mbi çdo ndryshim të bërë në asetet e prodhimit, përfshirë detaje të çdo elementi që është zgjeruar, nxjerrë jashtë përdorimit ose zëvendësuar gjatë vitit.

4.4 Nëse i licencuari parashikon një situatë emergjence siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi, i licencuari do të njoftojë pa vonesë ERE-n dhe ky njoftim do të përshkruajë çfarë masash do të marrë i licencuari për të parandaluar ose përmirësuar ndikimet e situatës emergjente në prodhimin e energjisë elektrike.

4.5 I licencuari do të ndajë shpenzimet e përbashkëta mes aktivitetit të tij të licencuar dhe aktiviteteve të tjera (përfshirë dhe ato të licencuara) mbi një bazë të arsyeshme, që të mos cenojë cilësinë e shërbimit për aktivitetet e licencuara, në përputhje me klauzolën 4.2. të kësaj licence. I licencuari do t’i paraqesë ERE-s dokumentacionin që tregon bazat për ndarjen e shpenzimeve të përbashkëta, si dhe rezultatet e arritura.

4.6 I licencuari do të njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të:

- a) adresës;
- b) statutit të të licencuarit;
- c) certifikatës së regjistrimit;
- d) kodit fiskal;
- e) menaxherit kryesor;
- f) strukturës së aseteve me mbi 10%.

4.7 Gjithë njoftimet zyrtare, aplikimet, peticionet, deklaratat ose korrespondenca tjetër me ERE-n, lidhur me detyrimet sipas kësaj licence, duhet të jetë me shkrim, duke caktuar respektivisht nga një zyrtar të autorizuar ose përfaqësues tjetër të të licencuarit ose të ERE-s. Këto dërgohen me korrier ose postë të regjistruar, duke kërkuar një verifikim të fletës së marrjes. Adresat e palëve duhet të vendosen mbi zarf. Të gjitha njoftimet ose korrespondenca tjetër do të konsiderohen se hyjnë në fuqi nga momenti i dorëzimit, ose nëse nuk janë dorëzuar për shkak të gabimit të dërguesit, nga momenti i prezantimit.

#### 5. PËRDORIMI I INFORMACIONIT

5.1 I licencuari do të sigurojë që çdo informacion i marrë nga të tjerë si rezultat i aktivitetit të tij të licencuar nuk do t’i jepet askujt, me përjashtim të rasteve kur:

- a) jepet pëlqimi paraprak me shkrim i personit me të cilin lidhet informacioni;
- b) informacioni është bërë publik;

c) të licencuarit i kërkohet ose i lejohej të përhapë informacionin për të përmbushur kushtet e kësaj licence sipas një urdhri të ERE-s ose çdo dispozite ligjore të aplikueshme.

5.2 I licencuari do të sigurojë që çdo biznes shoqërues nuk do të përdorë asnjë informacion në posedim të të licencuarit për të fituar një avantazh konkurrues të pajustificuar dhe do të sigurojë që nuk do të përhapë asnjë informacion të ndonjë person tjetër (përfshirë ata të një biznesi tjetër shoqërues) gjë që mund ta mundësojë këtë person të fitojë çdo lloj avantazhi komercial të pajustificuar.

5.3 I licencuari do të hartojë dhe do t'i paraqesë ERE-s procedurat për të siguruar respektimin e paragrafëve 5.1 dhe 5.2. Me kërkesën e ERE-s, i licencuari do të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për të ruajtur informacionin konfidencial në posedim të të licencuarit dhe për t'i dorëzuar ERE-s raporte lidhur me përmbushjen e detyrimeve të specifikuara në paragrafët 5.1 dhe 5.2.

5.4 Informacioni i dërguar ERE-s nga i licencuari do të konsiderohet publik me përjashtim të rasteve kur me kërkesë specifike të të licencuarit, ERE me vendim, përcakton që ky informacion është i natyrës pronësore dhe se përhapja e tij nuk i shërben interesit publik.

5.5 I licencuari do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të rritur efikasitetin operativ dhe ekonomike të aktivitetit të licencuar, me qëllim që të sigurojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të kryera në përfitim të konsumatorëve.

5.6 I licencuari do të zbatojë rregulloret dhe rregullat e aplikueshme të operatorit të sistemit transmetues të aprovuara nga ERE, përfshirë kryerjen e gjithë urdhrave operativ, instruksioneve ose udhëzimeve dhe paraqitjen e informacionit teknik dhe gjithë dokumentacionit tjetër të kërkuar.

## **6. DETYRIMET NDAJ OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT**

6.1 I licencuari do ta vendosë gjithë kapacitetin prodhues të njërive të tij prodhuese, në rast të integritetit në sistemin elektroenergjetik, në dispozicion të operatorit të sistemit të transmetimit, me qëllim që ky të arrijë koordinimin e ekuilibrit të bilanceve elektroenergjetike brenda sistemit elektroenergjetik.

6.2 I licencuari do të respektojë rregulloret dhe rregullat e operatorit të sistemit të transmetimit të aprovuara nga ERE, përfshirë kryerjen e gjithë urdhrave operativ, instruksioneve ose udhëzimeve dhe dorëzimin e informacionit teknik dhe gjithë dokumentacionit tjetër të kërkuar.

6.3 I licencuari do të sigurojë shërbime ndihmëse sa herë që do t'i kërkohet për ta bërë këtë nga operatori i sistemit të transmetimit në përputhje me rregulloret dhe rregullat e aprovuara nga ERE.

6.4 Kontratat për shitje të energjisë elektrike nga i licencuari do të regjistrohen tek operatori i sistemit transmetues vetëm kur aprovohen nga ERE.

6.5 Të gjitha kontratat për furnizim energjie (marrëveshjet për blerje energjie) ndërmjet të licencuarit dhe entiteteve të tjera duhet të përputhen me kontratat model të miratuara nga ERE.

## **7. RRITJA OSE ULJA E KAPACITETIT PRODHUES**

7.1 I licencuari do të informojë ERE-n dhe operatorin e sistemit të transmetimit mbi reduktimin e pjesshëm ose të plotë të kapacitetit prodhues, të paktën një vit para realizimit të tij duke paraqitur një shpjegim të detajuar për këtë qëllim. ERE mund ta përjashtojë të licencuarin nga ky detyrim, në rast se reduktimi i kapacitetit të prodhimit shkaktohet nga një forcë madhore.

7.2 Planifikimi, ndërtimi dhe futja në punë e kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike, si dhe instalime të tjera që lidhen me to do të kryhen nga i licencuari në përputhje me rregulloret dhe rregullat në fuqi të miratuara nga ERE.

7.3 Mosmarrëveshja mes të licencuarit dhe një konsumatori ose të licencuarit dhe një të licencuarit tjetër që ka të bëjë me një çështje brenda juridiksionit të ERE-s, që nuk mund të zgjidhet nëpërmjet negociatave të palëve, do të zgjidhet nga ERE, pasi të dëgjojë më parë palët, brenda qëllimit të autoritetit të ERE-s dhe në përputhje me rregulloret dhe rregullat e tij.

## **8. KONTROLLI MBI KRYERJEN E AKTIVITETIT TË LICENCUAR**

8.1 ERE do të monitorojë zbatimin e kushteve të licensimit nga i licencuari, do të shqyrtojë raportet e marra nga i licencuari dhe, në çdo kohë, mund të inspektojë regjistrimet e llogarive të të licencuarit dhe të kërkojë një auditim teknik dhe/ose kontabël të aktiviteteve të tij.

8.2 Përfaqësues të autorizuar të ERE-s kanë të drejtë të inspektojnë objektet e të licencuarit, pajisjet dhe dokumentet e tij për të verifikuar përputhjen e kryerjes së aktivitetit të licencuar me kushtet e licencës, si dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s. I licencuari do të sigurojë çdo ndihmë të kërkuar, të nevojshme për ERE-n gjatë këtij inspektimi.

8.3 Në bazë të ankesës së çdo pale të tretë ose në bazë të vetë propozimit të ERE-s, ky i fundit mund të nisë një hetim mbi zbatimin nga i licencuari të kushteve të licencës së tij ose të rregulloreve dhe rregullave të miratuara nga ERE.

8.4 I licencuari do të informojë ERE-n duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre kushteve të licencës brenda një jave nga momenti kur kjo shkelje bëhet e njohur për të licencuarin.

8.5 Nëse pas hetimit, ERE konkludon se i licencuari nuk i ka zbatuar kushtet e licencës, ERE mund të korrigjojë tarifat dhe kontratat e të licencuarit dhe/ose të marrë masa të tjera brenda qëllimit të autoritetit të tij për të mbrojtur interesat e konsumatorëve të energjisë elektrike.

8.6 I licencuari do t'u bindet vendimeve të marra nga ERE, përfshirë pagesën e gjobave të vendosura nga ERE, në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregulloret dhe rregullat e ERE-s dhe kushtet e kësaj licence.

## 9. ZGJATJA E AFATEVE TË LICENCËS

9.1 I licencuari mund të aplikojë me shkrim në ERE për zgjatjen e afateve të kësaj licence, duke paraqitur arsyet për zgjatjen e kërkuar.

9.2 ERE mund të zgjasë afatet, nëse sheh argumente bindëse, dhe kjo zgjatje është e vlefshme për periudhën kohore të përcaktuar nga ERE.

9.3 I licencuari do ta njoftojë ERE-n me shkrim, menjëherë dhe në çdo rast jo më vonë se 60 ditë para çdo date të përfundimit të vendosur në aneksin B, kur bëhet e dukshme për të licencuarin se mund të jetë i paaftë të plotësojë datën e përfundimit. Në një rast të tillë, i licencuari mund të aplikojë për një zgjatje të afateve të licencës sipas paragrafëve 3.1 dhe 3.2.

9.4 I licencuari do të plotësojë të gjitha detyrimet ligjore që lidhen me mjedisin dhe mbrojtjen e tij si rezultat i ndërtimit dhe instalimit të centralit elektrik dhe prodhimit të energjisë elektrike.

## 10. RAPORTIMI

10.1 Gjashtë muaj nga data që kjo licencë bëhet efektive dhe më pas në të njëjtën datë çdo gjashtë muaj, i licencuari do t'i paraqesë ERE-s një raport që përmbledh aktivitetet e tij gjatë gjashtë muajve të fundit lidhur me ndërtimin dhe instalimin e centralit.

10.2 Nëse i licencuari përjeton një ngjarje të forcës madhore gjatë afatit të caktuar për ndërtimin dhe instalimin e centralit elektrik dhe prodhimin e energjisë elektrike, do të njoftojë pa vonesë ERE-n duke kërkuar një zgjatje të këtij afati në përputhje me dispozitat e seksionit 3 të kësaj licence.

## 11. AMENDAMENTET E LICENCËS

11.1 ERE mund të amendojë kushtet e licencës në rast se nuk përputhen me:

- a) ligjet në fuqi, vendimet e Qeverisë ose çdo rregullore dhe rregull të ERE-s;
- b) vendimet e formës së prerë të gjykatave në Republikën e Shqipërisë.

11.2 Në çdo kohë, i licencuari ose ERE mund të propozojnë çdo amendament tjetër të kushteve të kësaj licence, përveç atyre të përcaktuara në paragrafin 6.1, duke i transmetuar palës tjetër një propozim me shkrim së bashku me çdo argument mbështetës.

## 12. HEQJA E LICENCËS

12.1 Në bazë të kërkesës me shkrim të të licencuarit, ERE mund ta heqë këtë licencë.

12.2 ERE mund ta heqë këtë licencë pas një njoftimi prej 60 ditësh, kur i licencuari dështon, për arsye që i atribuohen atij në përfundimin e ndërtimit të centralit ose të çdo fazë të projektit, siç është përcaktuar në aneksin B.

12.3 ERE mund ta heqë këtë licencë, kur i licencuari shkel legjislacionin në fuqi, çdo rregullore ose rregull të ERE-s ose kushtet e kësaj licence.

12.4 ERE mund ta heqë këtë licencë, kur i licencuari deklarohet i falimentuar ose kanë filluar procedurat e likuidimit sipas ligjit nr.8017, datë 25.10.1995 "Për procedurat e falimentimit".

12.5 Nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose aksionari që kontrollon interesat ndryshohet pa një autorizim të veçantë nga ERE, licenca bëhet e pavlefshme dhe e anulueshme dhe pasuesi i të licencuarit do të aplikojë për një licencë të re, në përputhje me procedurat e ERE-s për dhënien e licencave.

12.6 Heqja e licencës do të bëhet në përputhje me procedurat e heqjes së licencës të parashikuara në kapitullin IV të rregullores për procedurat e licencimit.

### 13. PAGESAT

13.1 I licencuari është i detyruar t'i paguajë ERE-s pagesën e licencës ose pagesa të tjera të aplikueshme sipas ligjit nr.9072, datë 22.5.2002 "Për sektorin e energjisë elektrike" ose ndonjë ligj tjetër.

### 14. E DREJTA PËR APEL

14.1 Vendimet e ERE-s lidhur me dhënien, amendimin, heqjen e kësaj licence ose lidhur me çdo gjobë ose pagesë të vlerësuar nga ERE, mund të apelohe në rrugë administrative ose në gjykatë.

## LICENCË PËR NDËRTIMIN DHE INSTALIMIN E CENTRALIT ELEKTRIK

Emri i plotë i të licencuarit

Seria: \_\_\_\_\_ Numri i licencës: \_\_\_\_\_

Data e hyrjes në fuqi të këtij aneksi: \_\_\_\_\_

### ANEKSI A

Listë të dhënash mbi ndërtimin dhe instalimin e centralit elektrik

|                                             |  |
|---------------------------------------------|--|
| Tipi dhe modeli i centralit                 |  |
| Vendndodhja e centralit                     |  |
| Fuqia e tij në MW                           |  |
| Numri i njësive gjeneruese                  |  |
| Sasia vjetore e energjisë që do të prodhojë |  |
| Skema elektrike principale e centralit      |  |

## LICENCË PËR NDËRTIMIN DHE INSTALIMIN E CENTRALIT ELEKTRIK

Emri i plotë i të licencuarit

Seria: \_\_\_\_\_ Numri i licencës: \_\_\_\_\_

Data e hyrjes në fuqi të këtij aneksi: \_\_\_\_\_

## ANEKSI B

Afati kohor për ndërtimin dhe instalimin e centralit

|                                   |  |
|-----------------------------------|--|
| Fazat e ndertimit të centralit    |  |
| Grafiku i parashikuar i punimeve  |  |
| Data e menduar për vënien në punë |  |

## REPUBLIKA E SHQIPËRISË ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TE ENERGIJË ELEKTRIKE

### LICENCË PËR PRODHIMIN E ENERGIJË ELEKTRIKE

Licenca i jepet:

(Emri i plotë i të licencuarit)

Seria: \_\_\_\_\_ Numri i licencës: \_\_\_\_\_

Data e hyrjes në fuqi të këtij aneksi: \_\_\_\_\_

## ANEKSI C

Lista e autorizuar e impianteve dhe njësive gjeneruese të energjisë elektrike

| Impianti | Numri i njësisë | Kapaciteti i instaluar | Data e vënies në shërbim |
|----------|-----------------|------------------------|--------------------------|
|          |                 |                        |                          |
|          |                 |                        |                          |
|          |                 |                        |                          |

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
  - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-eksponitës "Shqipëria Sot".

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

|                                                   |
|---------------------------------------------------|
| LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004 |
|---------------------------------------------------|

|     |                                      |      |
|-----|--------------------------------------|------|
| 1.  | KUSHTETUTA                           | 600  |
| 2.  | KODI I PROCEDURËS CIVILE             | 500  |
| 3.  | KODI I PROCEDURËS PENALE             | 600  |
| 4.  | KODI PENAL                           | 400  |
| 5.  | KODI I PUNËS                         | 500  |
| 6.  | KODI I FAMILJES                      | 450  |
| 7.  | KODI CIVIL                           | 1000 |
| 8.  | KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN | 900  |
| 9.  | KODI ZGJEDHOR                        | 355  |
| 10. | DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR   | 1500 |

|                           |
|---------------------------|
| PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI |
|---------------------------|

|     |                                                            |      |
|-----|------------------------------------------------------------|------|
| 11. | PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT       | 800  |
| 12. | PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK | 1000 |

|                |
|----------------|
| BOTIME TË REJA |
|----------------|

|     |                                               |     |
|-----|-----------------------------------------------|-----|
| 13. | KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE             | 500 |
| 14. | PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL | 600 |

DOLI NGA SHTYPI

|                                              |      |
|----------------------------------------------|------|
| PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE | 1500 |
| PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E DREJTËSISË           | 400  |

Doli nga shtypi më 6.9.2004

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 4500 copë | Formati: 60x88/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja Grafon  
Tiranë, 2004

Çmimi 200 lekë